


ARBEN KONDI RIKTHIM NE ÇAMERI



BIBLIOTEKA

854-94

K 87

KOSTURI

KONICA

DELVINAQI

KONISPOLI

FILATI

JANINA

GUMENICA

PARAMITHIA

MARGELICI

PARGA

FILIPJADHA

ARTA

PREVEZA

DETI I
JON

6591694
KBT

ARBEN KONDI

Rikthim në Çamëri

(Botimi i dytë)



“AUTORI”

Redaktor
BASHKIM KUÇUKU

Kopertina "ERI"

© E drejta e ribotimit
i njihet vetëm autorit

*Çamërisë dhe çamërve
kësaj toke, këtyre njerëzve martirë.*

*Të gjitha ndodhitë e këtij libri
janë ngjarje reale.*

PAK FJALË

Në fund të mijëvjeçarit të dytë si dhe në fillim të mijëvjeçarit të tretë, për historinë e mbarë njerëzimit, çështja kombëtare shqiptare shfaqet si një problem i rëndësishëm që domosdoshmërisht kërkon zgjidhje. Vallë çfarë udhe do t'i japë Atij këtë herë Perëndimi? Do të vazhdohet të ecet nëpër labirinthe e dështuara (pa brejtje ndërgjegje) të politikës së hershme europiane? Apo do të bëhet kalimi i nevojshëm, i llogjikshëm përmes kanaleve të diplomacisë amerikane, të cilat i inspiron mbarë globi, që prej ngricave të Siberisë, shkretëtirave të Tibetit e deri në tributë e thella të Afrikës?

Ndërkohë Kosova përjeton lirinë. Ndërkohë shqiptarët e Maqedonisë dhanë sinjalë të qarta për ardhmërinë e tyre. Kurse Çamëria mbetet ende plaga që rrjedh gjak në trup të kombit. Kjo, jo thjesht për faktin e njohur e tragjik të 200. 000 çamërve myslimanë, që u përzunë me dhunë prej vatrës së tyre amtare, por edhe të mijëra e mijëra çamërve të krishterë, të cilët edhe sot e kësaj dite, prej Filatit e deri në Prevezë kanë frikë të shprehen hapur qoftë edhe në gjuhën e tyre të mëmës, pasi grushti i egër i shtetit diktatorial nacionalist grek do të godiste mbi ta pa mëshirë.

Tek e fundit në cilat binarë do të hyjë problemi kombëtar shqiptar? Në ato të Europës së vjetër, (përfshijto Britaninë e madhe e ndonjë shtet tjetër) apo në ato të Amerikës së re? Po a nuk do të ishte më ideale për gjithë popujt e botës, që edhe vetë shinat e Europës të kalonin vetiu nëpër binarët amerikanë? Eksperiencia e pas Luftës së Dytë Botërore ka dëshmuar qartë se në ato binarë ecet në mënyrë më të shpejtë e më të sigurtë.

Autori

VITET GJASHTËDHJETË

Çamëria mitike, me peshën e një pllake të madhe guri ka rënduar anktshëm mbi gjoksën tim qysh në fëmijërinë e hershme. Është fjala për vitet '60, kur diktatori stalinist krijoi grupimin antiparti, antimarksist, antipopullor të kryesuar prej komandantit të flotës ushtarake shqiptare, kundëradmiralit Teme Sejko. Në tërësi, “ ky grupim i ri armiqësor” përbëhej prej atdhetarësh, luftëtarësh, intelektualësh të shquar çam, të cilët patën kontribuar ndjeshëm që gjatë viteve të luftës e po ashtu edhe në vitet e mëpastajshme. Natyrisht, familje të tilla si Sejkatët, Dematët, etj ishin me ndikim të njohur tek çamët e Konispolit e

fshatrave përreth tij e po ashtu tek çamët e ardhur prej kufijve kombëtarë, viktima të Genocidit tipik milosheviçian, të kryer në vitet 1944-1945 prej Napoleon Zervës e bashkpunëtorëve të tij të shumtë.

Në horizontin e mjegullt e të acartë shqiptar, pushkatimi, burgosja, internimi i elitës çame shfaqej vetëm si maja e ajsbergut. Një e shtata e së tërës dukej. Pjesa tjetër mbetej akull. E keqja më e madhe do vinte më pas. Një pjese aq të martirizuar e po aq edhe luftarake të kombit, po i kanosej një fatkeqësi e rëndë. Portreti i diktatorit sapo kish nisur të skicohej në marrëdhëniet me popullatën çame. Do të ndodhte si rëndom në strategjitë e tij vrastare. Për hir të fronit, Enver Hoxha nuk të falte. A nuk ishte sakrifikuar, a nuk ishte tradhëtuar për hir të pushtetit të tij të përgjakur qysh në Mukje Kosova? Lëre më pastaj Çamëria, çamërit që kurrë nuk patën ndjesi për të. Madje, në kulmin e tragjedisë çame, kur Zerva vriste e priste, Enver Hoxha, ky demon i kombit, sërish për hir të ruajtjes së pushtetit të tij, jo vetëm që nuk dërgoi formacione partizane për të mbrojtur nga masakrat popullsinë e pafajshme, (ju kërkuan tri brigada) por përkundrazi siç thotë edhe ballkanisti i shquar francez Zhorzh Kastelan arriti deri atje sa të mbështetej tek andartët grekë.¹

Por diktatori nuk do të mjaftohej kurrësesi vetëm me kokat çame. Duhej goditur ashpër mbarë popullata. Jehona e “tradhëtisë së madhe” njohu amplifikim të

¹ Zhorzh Kastelan: “Histori e Ballkanit” (Shekulli XIV-XX). Botime MÇM Tiranë. Faqe 491. Për herë të parë butuar nga “Fajard” Paris, më 1991.

shpejtë. Radiot, altoparlantët nëpër sheshe e rrugë zunë të buçisnin marramendshëm. Gazetat nëpër faqet e tyre të para flisnin e përfllisnin çdo ditë “tradhëtinë e madhe”. Një fortunë e tërë propagantistike u ngrit menjëherë.

Kështu, vit pas viti e pesëvjeçar pas pesëvjeçari e tërë popullata çame do të bëhej viktimë e një diskriminimi të rëndë. Nëpërmjet pinjollëve më servilë e më besnikë si fjala vjen Rita Marko, (anëtar i byrosë politike) Partia do të realizonte taktikën raciste të përçmimit. Praktikisht, çamërit do të trajtoheshin si qytetarë të dorës së dytë. Zezoja e thashethemnajës do të arrinte deri atje sa t’i cilësonte si të pabesë. Natyrisht që në këtë situatë, fillohelenët nisën të zgjoheshin. Opinioni i keq, mbytës u mëkua mjeshtërisht edhe prej dinakërisë së njohur greke. Ujku mjegull kërkon-thotë populli. Masakrave, krimeve të llahtarshme të zervistëve u duhej vënë kapaku medoemos.

Genocidi i ri po i hutonte, po i shokonte çamërit e mjerë. Politika komuniste pat njohur zenitin e saj. Natyrisht, pas gjithë kësaj diktatori nuk kish përse të mos ndihej i qetë e i kënaqur. Tek e fundit po ecte mirë e bukur në udhën e hapur prej miqve të tij të vjetër, andartëve kriminelë.

Më e tmerrshmja është se kësaj atmosfere kaq të rënduar nuk mund t’i shpëtonin as edhe të vegjlit. Dënimi i tyre do ishte pasojë e shkakut. Shpejt, ata do ndiheshin të përçmuar. Një pjesë shokësh do t’u kthenin kurrizin, do t’i braktisnin. Qëllonte që të mos i praninin nëpër lojra të ndryshme. Bile edhe i shanin. Këtë realitet në fëmijërinë time e kam ndjerë edhe vetë. Atëherë

familja ime jetonte në një lagje periferike të Tiranës, që paradoksalisht mbante emrin e heroit të popullit prej Filatit Ali Demi.

Bejte të tilla si “Çam i pabesë me thikë në brez” po shndërroheshin si refren në gojët e dashakeqëve dhe mendjelehtëve. Sikur u trondit diçka ajo krenaria e njohur e çamit të zgjuar e punëtor, që aq shumë pati luftuar e derdhur gjak në shekuj për lirinë e truallit, kombit të vet. Njerëzit u bënë të heshtur, të pandjerë. Gjëma e re, hallet e pasosura qaheshin kokë më kokë brenda familjes, brenda fisit.

Beharit, në mbrëmjet e ngrohta e të vona, pleqtë flokëbardhë nuk para dilnin më para portave të tyre të ulur në karriget me çiltera. Ndërsa, çitjanet e plakave leshragërsheta zunë të rralloheshin nëpër rrugicëzat e kalldrëmta të Tiranës. Madje, për turp e për dhimbje pati edhe nga ata që nuk e zunë më në gojë të qenurit çam.

Megjithatë, Çamëria asnjëherë nuk u ç’bë. Kurrën e kurrës nuk mund të ç’bëhet. Atje jeton ende një pjesë e ndjeshme e kombit shqiptar. Janë vëllezërit tanë të krishterë. Veç Prevezës, Paramithisë, Filipiadhës, Margëlliçit, Pargës, Gumenicës, Filatit gjenden edhe në Janinë, Konicë, Delvinaq, pas Gramozit, Kostur, Follorinë etj. Atje është gjuha shqipe. Patrikana Fanarite, historikisht mbetet e pafuqishme ndaj visarit më të çmuar të kombit shqiptar. Gjuha shqipe, si një ndër të folurat më të vjetra të njerëzimit kurrën e kurrës nuk u ç’bë. Pastaj janë edhe gërmadhat e shumta të fshatrave anë e mbanë Çamërisë. Shkrumb e hi vërtet, por me thëngjinj, që ndonëse heshturazi, ende e ruajnë

zjarrin brenda tyre. Atje janë edhe varret e prishura, janë kockat e gjyshërve, stërgjyshërve, katragjyshërve. Janë vet mijëvjeçarët. Janë edhe ullinj të shekullorë. Është deti madhështor. Mbi të gjitha është gjaku i derdhur për liri, si nga çamërit myslimanë e po ashtu edhe nga çamërit e krishterë. Po a mund të harrohet Spiro Çollaka, Vangjush Angjia, e sa e sa të tjerë? Gjaku nuk mund të bëhet kurrë ujë. E shumta ai mund të gjelbët nëpër damarët e reneгатëve, tradhëtarëve, të cilët historia e mbarë njerëzimi i dënon. Pra, Çamëria nuk është ç'bërë, nuk mund të ç'bëhet. Paçka se gjatë tërë shekullit të XX mbi shtat të saj u krijuan dhe u luajtën tragjeditë më të fundit greke. Paçka se është deklaruar e stër deklarohet se ajo tashmë është një çështje e mbyllur, një çështje që i përket vetëm të shkuarës. Po tek e fundit ç'janë 100 vjet, ç'është një shekull në historinë mijëra vjeçare të një treve, të një kombi? Kosova së fundi mbetet shembulli tipik për këtë.

Frymëmarrja, pulsimi jetik ndihet në atë pak Çamëri të mbetur prej Konferencës së Londrës (1913). Në skajin më jugor të Atdheut gjendet qyteti i vogël i Konispolit me mbi 10 fshatra përreth tij. Në Shalës, fshatin e bukur piktoresk të babait, por në mënyrë të veçantë në Markat, në fshatin e nënës, në fëmijërinë e hershme veja shpesh. Shkoja si gjatë pushimeve të gjata të verës e po ashtu edhe gjatë atyre të dimrit. Veçse këto të fundit më tërhiqnin më shumë. Sigurisht nga dëbora. Në Tiranë siç dihet ajo bie shumë rrallë. Apo nuk ngrinin edhe leqet për të zënë zogj tok me fëmijët e tezes. Në shtëpi ktheheshim të bërë ujë. Por teze

Shequa ndryshe nga fëmijët e saj, mua nuk më shante kurrë. Përkundrazi. Më vinte karshi vatrës dhe më ndërronte të tërin. Pastaj më ulte në prehër e më fliste me atë çamshen e saj të ëmbël.

-Po çish më bëre kështu more djalë i Kados? Më gjan se don të më turpërosh me time motër. Kërkon të fitoheç me zor. Apo s'paske vrarë edhe glurin? Po ku u gremise kështu more malukat?! Ëë... Ëë... Ku u gremise? Ç'na bëre more ç'na bëre? Eja tani shpejt e pije këtë kupë me klumësht. Eshtë e ngrohtë e të bën mirë. Pastaj kumbisu në anë të vatrës që të prehesh, të pushosh.

Tezja vazhdimisht “qortimet” i shoqëronte duke më ledhatuar flokët. Shumë herë më zinte gjumi mbi çitjanet e saj. Pasi më linte ta piqja mirë gjumin më merrte hopa, më mbulonte me një velenzë e më shpinte në dhomën e miqve ku edhe flija. Atje vazhdimisht bënte ngrohtë. Një mangall i madh, i verdhë i mbushur tërë prush do të gjendej në mes të dhomës së shtruar me qilima të bërë nga ajo vetë. Të keqen unë e kisha vetëm prej velenzave të trasha. Flokët e tyre të leshtë më cukisnin, më çponin. Sido që flija butë e qetë shihja vetëm ëndrra. Mali i Mëllezit mbi Markat më çfaqej i lartë, i bardhë, i lartë. E njëjta situatë do të më përsëritej edhe me Malin e Saraqindit, sa herë që do të flija në Shalës. Sërisht shihja ëndrra. Mbi Shalës, Dishati, më tej Verva, pastaj kufiri... Thika...

- Më poshtë as 500 metra është Koska, fshati i Muharrem Rushitit, - më thoshte përherë babi. – Atje nis Çamëria e përtej kufirit...

Në mëngjes çohesha shpejt, me natë siç thonë

çamërit, por edhe arbëreshët e Italisë. Zgjasja dorën prej dritares dhe bëja pak mënjane perden me tantellë. Më pëlqente të sodisja një pjesë të fshatit. Markati është krejtësisht i bardhë. Një copëz reje lart në qiell. Rrugët e kalldrëmta, avllitë e gurta të zbardhura dyfish prej gëlqeres dhe dëborës së bardhë. Prej strehëve dhe çative dëbora shkrin pikë-pikë. Vështrimi sërish shket mbi Mëllez. I madh, i bardhë i madh. Pas tij, tej është Çamëria... deri në Prevezë. Ëndrra ime. A do të mund ta shihja vallë?!

PORTË E FATIT APO E FERRIT

Si fundshekull e njëkohësisht edhe si fundmijëvjeçar, pra si dy herë i veçantë, Vitin e Ri 2000 vendosëm ta festonim familjarisht jashtë shtetit. Duke qenë se në Itali patëm qëndruar gati tre vjet do na pëlqente që pushimet e dimrit t'i kalonim atje. Veçanërisht në hapësirën arbëreshe të Kalabrisë, si në Shën Sofinë e Epirit apo në Shën Mitrin e famshëm, ku kishim aq shumë miq. Atje ndiheshim si në Atdhe. Arbëreshët, këta mërgimtarë shqiptarë 600-700 vjeçarë nëpër shtëpitë e tyre e po ashtu edhe nëpër qytete flasin gjuhën e vjetër, atë të kryetrimt të tyre dhe Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriot – Skënderbeut.

Mirëpo si për të gjithë shqiptarët edhe për ne marrja e një vize të huaj përbën një Odise të vërtetë. Ndoshta imazhet e anijeve mijra tonëshe të mbushura plot e përplot me të mjerë, të cilët para një dekade bllokuan ekranet e televizorëve të mbarë botës nuk janë shlyer ende prej ndërgjegjes ndërkombëtare. Sidoqoftë ambasadat perëndimore, tashmë ia kanë kthyer tërësisht kurrizin shqiptarëve. A thua se nuk ishin po këta ambasada, që “shqyen” dyer e dritare në vitin nëntëdhjetë për të ndjellur brenda mureve të tyren shqiptarët. Me pak fjalë, sot është më e lehtë të blesh një vizë në bregun e zi se sa ta marrësh atë nëpër ambasada . “La piovra” tashmë i ka shtrirë mirë tentakulat e saj në në Shqipëri. Ndërsa shqiptarëve, sikur mos t’ju mjaftonte diktatura më e egër komuniste në mbarë Europën Lindore, për fat të keq vazhdon t’ju përsëritet sërish rituali i njohur, i kobshëm i këngës së Qabesë... Veçse këtë herë, balada e dhembshme i përket kohëve tepër moderne, pragut të mijëvjeçarit të tretë.

Në mungesë të vizave italiane u detyruam të gjenim viza greke. Kështu në ditët e fundit të dhjetorit, unë, gruaja dhe djali u gjendëm në pikën kufitare të Kakavijës. Ime shoqe ka disa kushërinj në Athinë, Tripoli e gjetkë. Pastaj ajo me djalin shkonin për herë të parë në fqinjin jugor. Natyrisht, kureshtja bënte punën e saj. Ndërsa me mua ishte krejt ndryshe. Nëntë vjet më parë, ethet e eksodit të madh më patën përfshirë të tërin. Për tri-katër muaj pata punuar dhe jetuar në Pire. Ndërkohë Çamërinë e kisha vizituar disa herë. Pra, ëndrrën e fëmijërisë e pata përjetuar plotësisht. Çamërinë, tanimë e njihja që nga Jugu në Veri. Në

Prevezë kish emigruar para meje Çimi, një shoku im i fëmijërisë që nënën gjithashtu e kishte çame nga Margëllëçi. Kurse në Filat jetonte një kushëri i afërt i gruas.

Si për të njomur plagët e shumta Çamëria i shmanget djathtas Kakavijës dhe shtrihet buzëdetit Jon. Ndryshe nga vite më parë, kur në Kakavijë njerëzia ishte mizëlisi, këtë mëngjes erëftohtë, gjithçka është ndryshe. Mbizotëron qetësia. Vija e kufirit, bie në sy menjëherë. Si me thikë janë ndarë dy pjesë të së njëjtit shtat. Tej male, fusha, kodra, fshatra, qytete të shkëputura me dhunë prej trupit Amë. Gjithçka çfaqej e përhimtë. Në pikën tonë doganore kryem formalitetet e nevojshme. Ecnim drejt doganës së shtetit fqinj. Si pa kuptuar u zhytëm në trishtim. Përse na ndodhte kjo? Mos ndoshta për arsyen e thjeshtë se po lenim pas shpine Atdheun e këtij kufirit? Apo ngaqë me emrin e Kakavijës lidhen sa e sa njoftime mbi trajtimet shtazarake të shqiptarëve. E ndërsa ecnim nëpër tokën ndërmjetëse u bëmë dëshmitarë të një skene të rëndë: Prej doganës greke arrinin britma, ulërime. Ç'po ndodhte vallë? Kur ja tek u çfaq një polic trupmadh e trashalug, që kish vënë përpara me shqelma një djalosh imcak shqiptar. Ai ndoshta nuk i pat mbushur ende të gjashtëmbëdhjetat. Sikur të mos kënaqej prej shqelmave, polici grek nisi ta godiste viktimën e tij edhe me grushta. Djaloshi mundahej të mbrohej duke zënë kokën me duar. Veçse, polici, nuk ngopej. E godiste, e godiste pa mëshirë derisa e nxorri në territorin tonë. Ç'krim kishte kryer ai djalë që trajtohej si kafshë? Ndoshta kish tentuar të kalonte doganën me

vizë të parregullt? Mundesh, përderisa polici në fund i përplasi pasaportën, në fytyrë. Sidoqoftë dua të pyes: Cili ligj ndërkombëtar i justifikon veprimet e këtij polici barbar? Se mos është i pari dhe i fundit ky rast? Tashmë, qëndrime të tilla që arrijnë deri në vrasje janë bërë të zakonshme. Po shqiptarët e shkretë kush do t'i mbrojë vallë, kur edhe vetë shteti i tyre i ka lënë jetim?

-Pu, pu, pu, - ç' bëhet kështu more Beni - u shpreh vetiu Mirela?


-Ç'të bësh, - thashë unë duke e afruar pranë djalin.

-Sa të këqinj, qenkan këta policët grek babi, - tha Arbëri.

Ndeza nxitimthi, një cigare. Tymosa thellë. Veç nuk arrita ta pija të gjithë. Ndoreshim në prag të derës së doganës greke. Gjysma e cigares harkoi mbi asfalt. Vallë si duhet quajtur prej shqiptarëve Kakavija? Porta e fatit apo e ferrit?

Në ambientet e brendshme të doganës s'pipëtinte as miza. Heshtjen e varrit e prishinin zërat e egër të doganierëve grekë. Përçmimi sheshit. E megjithatë, shqiptarët nuk dëgjoheshin. Por ç'mund të bënin? Reagimi më i vogël, jo vetëm që mund t'ju prishte vizën apo t'ju griste edhe pasaportën, por mund të përsëriste fare lehtë skenën e përshkruar më lart. Barbarizmi në Kakavijë nuk kishte cak.

Po afronte radha jonë. Si unë po ashtu dhe ime shoqe kaluam pasaportat në sportel. Leja e kalimit të Arbërit që vendosur bashkë me pasaportën e gruas. Oficeri grek shfletoi pikërisht atë. Pastaj na hodhi një vështrim të rëndë. Por nuk foli. Veçse bëri shenjë me



kokë që të shkonim përpara. Madje nuk na kontrolloi as edhe paratë që kishim me vete. Siç dukej paraqitja jonë prej familjarësh ia imponoi këtë qëndrim. Gruaja zuri djalin nga dora dhe bëri përpara. Pas tyre unë. Sapo u gjendëm jashtë ndeza një tjetër cigare. Ndihesha diçka i lehtësuar, sado që nuk më shqitesh nga sytë rrahja e pamëshirshme e atij djaloshi imcak.

Premë biletat. Pasi u munduam më kot të lidheshim me telefon me prindërit u ngjitëm në urbanin e linjës Kakavijë-Janinë. Koinçidencën për në Athinë do ta kryenim në Janinë, në kryeqendrën e Epirit të lashtë. Sytë i treta thellë në tokën nënë e njëkohësisht të huaj. Dija se dhjetë kilometra më tutje gjendej Delvinaqi. Ndonëse më i vogël e në pozicion krejt të ndryshëm gjeografik, (është i ndërtuar në fushë) ai më kish sjellë gjithmonë ndër mend Delvinën tonë. Ja si e përcakton Delvinaqin përpara 350 vjetësh kronikani dhe historiani i njohur osman Evlija Çelebiu: “Qyteti i Delvinaqit bën pjesë në nën prefekturën e Pogonit me 400 shtëpi, 40-50 dyqane, 10 kisha dhe 3 hane. Banorët e tij janë të gjithë shqiptarë të krishterë. Qyteti i përket Kapidan Pashës. Paguam një taksë fikse... Udhëtuam gjashtë orë nga perëndimi i Delvinaqit dhe mbërritëm në Libohovë”.²⁾

Në autobus heshtje e plotë. Nga çasti në çast prisnim të na kontrollonin biletat si dhe pasaportat.

²⁾ Evlia Çelebiu: “Shqipëria 350 vjet më parë”. Shtëpia botuese “Horizonti” Tiranë, 2000.

.Verifikimi u bë shpejt dhe pa asnjë problem. Vura re, se ndryshe nga nëntë vjet më parë, polici i doganës nuk shoqërohej më prej rojeve kufitare. Më së fundi urbane u nis. Arbëri shprehu gëzimin fëmënor duke më shtrënguar dorën. Po kështu bëri edhe Mirela. Vështroja përtej dritares pranë. Qe një paradite e pangjyrë, me diell të zbehtë. Pas pak minutash, një tabelë anës rrugës në gjuhën greke shënonte: “Delvinaqi”. Por, autobusi nuk hynte në qytet. Vazhdonte rrugën djathtas.

Delvinaqi, ky qytet i vogël, në të cilin edhe sot e kësaj dite, prej të krishtërëve shqiptarë ende flitet gjuha shqipe, (natyrisht, jo nëpër ambiente shtetërore) nuk më erdhi ndërmend krejt rastësisht. Diku më tëhu tij, pra më afër Kakavijës, në vendin e quajtur Zhepe ka ndodhur një krim, vrasje që do të kish pasoja negative për historinë e Kombit tonë. Pikërisht në këtë vend, më 27 gusht 1923 prej andartëve grekë, stimuluar prej qeverisë së tyre u vra gjenerali Italian Telini, kryetar i komisionit të posaçëm ndërkombëtar për vendosjen e kufijve në terren, në mes shtetit shqiptar, grek dhe atij jugosllav.

Asnjëherë e tij, buruar prej njohjes së thellë të historisë dhe realitetit Ballkanik, ra ndesh me shovinizmin e egër megalist grek. Gjeneral Telini nuk iu nënshtrua presioneve dhe shantazheve të paprera helene. Derisa e vranë, ai punoi me ndërgjegjen e me disiplinën e një njeriu dhe ushtaraku të rrallë. Për rrjedhojë, truallit shqiptar nuk ju shqyen copëza të tjera etnike të tij, siç ishte rasti i mbi dhjetë fshatrave në hapësirën Devollite, etj.

Më pas në shenjë respekti e kujtimi për gjeneral

Telinin, shqiptarët ngritën një statujë në një nga sheshet kryesore të Tiranës. Përrurimi u bë në kohën e mbretit Zog, më rastin e 10 vjetorit të vrasjes. Por, gjeneral Telini do të vritej për së dyti. Këtë herë, krimi do të kryhej nga vetë shqiptarët. Në vitet e para të regjimit komunist, monumenti i ushtarakut Italian, që dha jetën për kombin tonë do të hiqej prej kryeqytetit. Kjo për faktin e thjeshtë se Enver Hoxha pati nisur të përgatiste terrenin për ngritjen e kultit të tij perandorak. Vallë, a nuk u mbush më pas jo vetëm Tirana, por e gjithë Shqipëria me bustet e monumentet e tij?

Për gjeneral Telinin do përmendja edhe një detaj familjar. Gjyshi im, për një periudhë kohe ka qenë shoqëruar i Telinit. Pas çlirimit, ai e pat porositur babanë që të vendoste një tufë me lule të freskëta tek monumenti. Për fat të keq shkoi ca me vonesë. Monumenti i gjeneralit ishte hequr. Babait i mbeti tufa me lule në dorë...

Udhëtimi vazhdonte. Si pasojë e rrugës përgjithësisht malore, autobusi bënte përpara ngadalë. Kohë pas kohe, ca me të majtë po ashtu dhe në të djathtë tonë çfaqeshin tabela treguese të fshatrave e qyteteve të ndryshme. Majtas "Konica", vendlindja dhe qyteti i feminisë së gjyshes time. Mbetej sipër, thuajse në një vijë të drejtë ajrore me Delvinën dhe Grebenenë. Qyteti i fundit tok me rrethinat e tij, sado që nuk i përket trevës Epirote por Jug-Perëndimit ekstrem të Mollosisë së Vjetër është i njohur si vendbanimi i fiseve ilire. Me emrin e qytetit të Grebenesë lidhet ngushtë një

figurë e shquar e atdhetarizmit shqiptar, që për çudi kalon shkarazi, thujse tangent në histografinë tonë. Veç kësaj, emri i Beqir Grebenesë edhe sot e kësaj dite, si i shumë atdhetarëve të tjerë shqiptarë, të cilët flijuan jetën për atdheun mbetet ende i mjegullt i papërcaktuar qartë. Me dëshirën për të hedhur pak dritë mbi këtë luftëtar, po i referohemi botimeve bashkëkohore greke. Një ndër historianët e sotëm më në zë të Greqisë, Vasil Kondis, (Vasil Kondi prej rrethit të Korçës) drejtor i Institutit të Studimeve Ballkanike të Selanikut, në librin e tij: "Greqia dhe Shqipëria në shekullin XX"³⁾, botuar në dy gjuhë shqip-greqisht në vitin 1997, për Beqir Grebenenë ndër të tjera shkruan sa vijon: "Beqir Grebeneja ishte prijës i njëjësive guerile shqiptare dhe u shkaktoi dëme të pallogaritshme grekërve... Ndaj munda t'i ofronte shërbime të shumta Shqipërisë në luftë kundër Greqisë".

Theksojmë se major Grebeneja kish qenë ndër luftëtarët më të shquar gjatë mbrojtjes së Janinës dhe Çamërisë në fund të vitit 1912 dhe në muajt e parë të 1913. Ai nuk ishte pajtuar kurrë me zgjerimin e mëtejshëm të kufijve të Greqisë në kurriz të Shqipërisë. Në marrëveshje edhe me Ismail Qemalin, Beqir Grebeneja në fund të vitit 1913 filloi të ngrinte shqiptarët për rimarjen e Çamërisë dhe të Kosovës. Por planet e tij u zbuluan. Në fillim të 1914-ës, ai u arrestua në Vlorë nga forcat ndërkombëtare. U dënua me vdekje. Nuk kaloi as edhe një muaj nga pushkatimi

³⁾ Vasil Kondi: "Greqia dhe Shqipëria në shekullin XX", botuar nga "Paratiritis", Selanik 1997.

i major Grebenesë, kur Jorgos Zografis, (ish ministër i jashtëm i Greqisë) shpalli në Gjirokastrë, Republikën Autonome të Epirit të Veriut (shkurt 1914)...

Me afrimin e mesditës dielli po fuqizohej lart në qiell. Tek përplaseshin nëpër xhamat e autobusit rrezet e tij të ngacmonin. Sikur bënte edhe ca ngrohtë. Si unë, po ashtu dhe gruaja hoqëm palltot e mëdha. Arbëri xhupin e trashë. Perden pranë e tërhoqa gjer në atë masë sa të mos më pengonte shikimin. Udhëtonim prej një ore. Janina ndihej gjithnjë më pranë. Dua të theksoj se Kryeqendra e Epirit apo e Shqipërisë së Jugut, gjithnjë më pat emocionuar. E njihja historinë e saj të përgjakur. Por, për të hyrë në Janinë duhen ende edhe disa minuta. Urbani e rriti shpejtësinë. Vrikthi na parakaloi një tjetër tabelë treguese. Mezi arrita ta lexoj: "Trikalla". Një nga qytetet më në zë të Thesalisë. Edhe në hapësirat rreth saj, prej mijëra vjetësh kanë jetuar shqiptarët, vllahët, çifutët, etj. Përpara na priste Janina, Kryeqendra e Epirit të lashtë.

JANINA. KRYEQENDRA E EPIRIT
(Shqipërisë së Jugut)

Stacioni i urbaneve të Janinës ka hapësirë të ngushtë. Më në fund, pas disa ecejakesh të mundimshme autobusi u parkua. Zbritëm menjëherë. Nisja për në Athinë kryhej pas dy orësh. Nxituam përdrejt kafesë së madhe të stacionit. Njerëz të shumtë. Mezi gjetëm një tavolinë të lirë në një kënd të lokalit. Një kafë ekspres e kishim të nevojshme. Kamarieri po vonohej. Më tërhoqi vëmendjen Arbëri. Dukej në siklet. Qe bërë prush në fytyrë. U shqetësova për një çast. Mos ndoshta na u sëmur? Vështrova Mirelën. Mes një buzëqeshje të lehtë më bëri shenjë që të shihja nga

pas. Ktheva kokën me kujdes. Përballë Arbërit, një çift i ri puthej pandërprerë. Nënqesha lehtë. Ja ç'e kish bërë të skuqej djalin tim. Është ende fëmijë. Nuk ka mbushur as njëmbëdhjetë vjeç.

Duke qenë se në murin pranë kishim një telefon, gruaja tentoi të lidhej me Tiranën. Më së fundi ia doli. I bëri të ditur nënës vendndodhjen tonë e se kur do të niseshim për në Athinë. Me gjyshen foli edhe Arbëri. I dhashë të fala edhe unë. Ndërkohë, kamarieri solli kafetë. Për Arbërin morëm një coca-cola. Kafeja tepër e rëndë. Për ta shtyrë, m'u desh ta shoqëroja me ujë. Ndeza një cigare. Sikur u qetësua diçka. Ndërsa ambienti mbetesh me ajër të ngarkuar. Atmosferë tipike ballkanase. Meqë kisha dy orë pa pirë duhan, ndeza sërish një tjetër. Ndjeja se në krah me shponin dy sy. Kurioziteti më shtyu të ktheja kokën djathtas. Buzët e holla të një plaku flokëbardhë artikuluan në shqip këto fjalë:

- Tymoske dendur more djalë!

-Ashtu është vërtetë, - thashë unë që mënjanova pakëz karrigen.

Tashmë, plakun, e kisha thujse përballë.

-Duhani bën dëm,- vazhdoi ai që shtoi.- Shqiptarë të Shqipërisë?

-Po, - u përgjigja unë dhe shtova aty për aty. - Po zotrote?

-Janinjot jam, -tha ai dhe pasi mori shkopin u ngrit.

Njatjetoi lehtë me kokë dhe nisi të largohej ngadalë cap-cup, cap-cup. Dora e tij, thujse shkau lehtë mbi flokët e Arbërit. Disa minuta më pas paguam

e dolëm. Si pa ndjerë pati kaluar plot një orë. Në sportelin më të afërt premë biletat e linjës Janinë-Athinë. U larguam nga stacioni maramendës. Jashtë, ajër i pastër. Mjegulla që pat lënë pas biseda e plakut janinjot ende nuk më ishte shpërndarë. Kur, përsëri një tjetër e papritur. Në krahun tjetër të rrugës, prapa kangjellave të zeza një godinë e bukur klasike. Gjimnazi “Zosimea”. Këtu kanë studiuar sa e sa figura të shquara të Rilindjes sonë Kombëtare. Midis tyre edhe tre vëllezërit Frashëri. Sido që ky institucion arsimor, produkt i politikës së kahershme osmane ka qenë një vatër nga ku reflektonte kultura helene në Epir nxorra aparatit dhe e fotografova. Madje, ne shenjë respekti ndaj kulturës gjithbotërore pozuan edhe familjarisht. Do mjaftonte shqipja e plakut janinjot si dhe gjimnazi “Zosimea” që historia të zgjohej brenda qenies time.

Janina, prej shekujsh njihet si Kryeqendra e Epirit. Këtë e ka pranuar në shkrimet e tij edhe Kapo D' Istria, Presidenti i parë i shtetit të pavarur grek, Në lashtësi Epiri, përbëhej prej tre fiseve kryesore, (Kaonët, Mollosët, Thesprotët) si dhe prej disa fiseve të tjera më të vegjël. Po ç'është në të vërtetë Epiri? Të parët që e shpjegojnë këtë janë dijetarët e vjetër e të mëdhenj helenë. Burimet më të hershme, vijnë nga Herodoti, babai i historisë. Në kryeveprën e tij: “Historia” – Libri i VIII, ku flitet mbi forcat greke që u bashkuan në Selaminë kundër persëve (viti 480 pr. kr.) thuhet: “Të gjithë ata që i dërguan këto forca, banojnë këtej Thesprotisë dhe lumit Aheron”. Pohohet, kështu

që Thesprotët janë fis jo helenë, fqinjë me Ambrakasit dhe Leukadët. Në këtë mënyrë, Herodoti bën të ditur se fiset helene mbaronin tek ishulli i Leukadës dhe tek qyteti i Ambrakisë – e vetmja koloni greke përgjatë bregdetit Epirot.

Edhe më qartë shprehet për fiset Epirote, historiani tjetër i shquar grek, Tuqiditi. Në kryeveprën e tij, (Lufta e Peloponezit, 432-404 para Krishtit) thuhet: “Kjo betejë ishte lufta më e madhe që përfshiu grekët si dhe një pjesë të fiseve barbare. Prej barbarëve ishin Kaonët, Thesprotët, Mollosët”. Po kështu, Tuqiditi, vë në dukje se Barbarët nuk ishin greqishtfolës”.

Idenë e Tuqiditit lidhur me “Barbarët” e përforcon më tej Straboni. Në librin e tij (Gjeografia VII) ai shprehet: “Kaonët, Thesprotët dhe Kesapët (një fis i vogël Epirot) shtrihen gjatë bregdetit të maleve Keraune (Himara e sotme) e deri në gjirin e Ambrakisë”. Ndërsa Skilaksi, gjeografi i njohur grek i shekullit IV pr. kr. Shkruan kështu: “Pas Mollosëve vjen Ambrakia. Pikërisht këtu fillon Greqia”...

Por Epiri, çfaqet gjatë të gjitha periudhave historike të njerëzimit. Për të kanë shkrojtur dijetarët më në zë romakë, bizantinë, osmanë, etj. Edhe këta si dhe dijetarët antikë helenë konfirmojnë faktin se kjo trevë nuk ka qenë asnjëherë tokë greke. Përsa i takon minoritetit helen që ka banuar këtu, argumenti shkencor shpjegon se kjo popullsi është koloniale aty, (si rasti i qytetit të Ambrakisë) ose është pjesë e shkëputur prej saj që gradualisht ka mundur të ngulitet (për arsye konflikti) më në thellësi të bregdetit. Rreth minoritetit

grek në Epir ka egzistuar edhe një mendim, i cili i sjell ata në këtë trevë në kohën e Ali Pashë Tepelenës për të punuar si argat në tokat e bejlerëve shqiptarë.

Përsa i përket mbishkrimeve Helene që çfaqen tek-tuk nëpër Epir, ato nuk janë veçse rrezatime të kulturës së atëhershme universale greke, që arriti edhe në brigjet e Siçilisë, Detit të Zi e deri në Spanjë. Ky fakt është më se normal, pasi i njëjti fenomen u përsërit më pas me kulturën romake, e cila rrezatoi edhe më gjerë. Po e njëjta gjë ndodh sot me gjuhën angleze, me kulturën amerikane.

Ndërkohë ka edhe studiues të njohur pro helenë, siç është rasti i akademikut francez Pukevil, (Konsull pranë Ali Pashë Tepelenës) që padashur e në mënyrë të pavetëdijshme ka zbuluar nëpër shënimet e tij etnicitetin thjesht shqiptar të Epirit. Ja çfarë thotë Pukëvili në shkrimet e tij mbajtur plot dyqind vjet më parë, kur vizitonte Epirin: “U kryqëzuam, ndërkohë, edhe me një grup shqiptarësh toskë, karakteri luftarak dhe i guximshëm i të cilëve më solli ndërmend atë ç`ka kemi treguar për maqedonasit e lashtë: Këta toskë duken se duan vetëm një Pirro tjetër, një Skënderbe tjetër për të ringjallur karakterin e tyre të lashtë luftarak”.⁴⁾

Nuk duam të ndalemi këtu tek përmendja e Skënderbeut, pasi dihet botërisht që për 25 vjet rrjesht ai u bë jo vetëm prijësi luftarak i shqiptarëve, por edhe kalorësi mbrojtës i krishtërimin ndaj rrezikut të

4) Pukëvil: “Në oborin e Vezirit të Janinës”, faqe 142, botuar në Tiranë prej “Horizontit”, 1999.

pushtimit osman. Nuk duam të qëndrojmë këtu as tek emëruesi i përbashkët që Pukëvili vë mes maqedonasve të lashtë të Lekës së Madh dhe Toskëve. Kjo, pasi edhe akademikëve mund t'ju shpëtojë ndonjë "lapsus". E papritura qëndron te fakti se si ka mundësi që Pukëvili, ky adhurues i flaktë i helenëve ju njeh shqiptarëve dhe jo grekërve, si prijës të tyre të natyrshëm Pirron e Madh të Epirit të Lashtë?!

Tani, për pak çaste le t'i referohemi edhe këndvështrimit shqiptar përsa i takon Epirit. Ja sesi shkruan plot njëqind vjet më parë Sami Frashëri, rilindasi ynë enciklopedist në kryeveprën e tij: Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet. "Që nga Vjosa e gjer në mëngët t'Ambrakisë (të Artesë) cop' e Jugës së Toskërisë së sotme, quhesh Epir (Ipëri, Hipëri a Sipëri)... Pas të thënit të shkronjëtove të Greqisë së vjetërë, Ilyrianëtë, si dhe Epiratëtë të cilitë s'ndryshonin nga ata, me ndonjë farë mëndyre, rroninë e ishinë si Shqiptarët e sotëmë, pa ndonjë ndryshim, edhe flisnimë gjuhënë që flasim na sot".

Ora shënonte 14 pa pesë minuta. Urban i Linjës Janinë-Athinë përgatitej të nisej. Pas një kontrolli të imët të policisë u ngjitëm lart. Sapo bënim të gjenim ndenjset tona u dëgjua një britmë e fortë që trembi edhe Arbërin.

-Pissu, pissu, - gërthiste një plakë e mbajtur, veshur me të zeza, si të moshuarat tona të Jugut.

Britmën e shoqëronte duke bërë me dorë nga fundi i autobusit. Të befasuar nuk po kuptonim se ç'po

ngjiste. Plaka qëndronte në këmbë në krye të autobusit, fare pranë derës, ku policia vazhdonte kontrollin. Fjalët e saj u përsëdytën me zë të edhe më të fortë. Për shkak të tronditjes, ndonëse marr vesh pak greqisht nuk po kuptoja ç'kërkonte të shprehte.

-Çfarë thotë? – pyeta një djalë të ri para meje, që me siguri duhej të ishte emigrant.

-E ka me ne shqiptarët, - tha djaloshi që sqaroi.

-Thotë se ne të gjithë duhet të rrimë në fund të urbanit e jo në fillim të tij.

-E përse?! – pyeta sërish.

-Si përse?! – përsëriti djaloshi duke më parë kësaj here në sy. - Sepse këta, ne shqiptarëve nuk na duan.

Nuk e zgjata më. Po ç'mund të thoja? Bashkatdhetari im, i tha të gjitha...

Ndjeva se tronditja po më kthehej në revoltë. Gruaja që e kuptoi këtë më shtyu lehtë përpara.

-Ç'kërkon të bësh? – më tha ngadalë. – Mos do të na kthesh nga kemi ardhur?

Në këtë kohë Arbëri i pati gjetur vendet tona. Pothuajse në fund të autobusit. Ndjeja se më qe ngritur tensioni. E gjithë fytyra më ishte përflakur. Përjetoja nevojën e domosdoshme të dilja jashtë e të pija një cigare. Por ish e pamundur. Instiktivisht vështrova orën. Ajo shënonte 14⁰⁰ pa një minutë. Pas pak, urbani duhej të nisej. Mirela ndonëse e tronditur mundohej të hiqesh e qetë. Arbëri nuk ndihej. Vështronte në drejtim të plakës. Ajo gjithashtu shikonte prej fundit të urbanit. Veçse këtë herë rrinte ulur. Në ndenjësjet pranë saj, pasagjerë grekë. Në kurriz të tyre dy rjeshta bosh,

pastaj fillonin shqiptarët. Pjesa dërmuese e tyre të rinj – emigrantë. Diferencimi në autobus ishte i plotë. Të gjithë shqiptarët, udhëtarë të dorës së dytë, ndonëse, biletat ishin paguar me të njëjtin çmim. Kisha një si shtrëngim në gjoks. Gruaja më ndiqte me bisht të syrit. Lirova ca gravatën. Sytë i hodha përtej dritares. Atë çast, urbani u lëkund pak, pastaj bëri përpara. Doli me vështirësi prej ngushticës së stacionit. Shpejt u gjend në udhët kryesore të Janinës. Ndonëse sytë i mbaja të mbërthyer përtej xhamave, s'mund të përqendrohesha kërrkund. Isha në tym. Kjo gjendje vazhdoi për disa minuta, derisa Mirela më ngacmoi me brryl e foli:

- Beni, atje tej duket liqeni!

Në tru, vetëtimthi më erdhi emri i Ali Pashë Tepelenës. Pastaj u skicua fytyra e tij, me atë mjekrën e bardhë, të gjatë, sa edhe vetë llulla që mbante madhërisht përpara. Veçse krenarinë e Tij prej vitësh, unë e shihja si të pamotivuar plotësisht. Madhështi e një tirani të egër, i cili ndonëse, pati mundësi të realizonte ëndrrën më sublime të një kombi, lirinë nuk e bëri atë. Një vlerësim i tillë nuk është aspak pasojë e trishtimit shpirtëror që po përjetoja. Jo. Tanimë, prej sa e sa kohësh, ndërgegjeja ime e pati pozicionuar brenda saj si figurën e Ali Pashës e po ashtu edhe të Mustafa Pashë Bushatit. Këndvështrimi im mbi ta është i gjerë. Fiton përmasat e kombit. Gjykoj se mirëkuptimi, bashkimi i këtyre dy burrave të fuqishëm do të sillte në realitet vetë bashkimin e kombit tonë. Në duart e tyre qëndronte fati i mbi dy milionë

shqiptarëve. Aliu dhe Bushatliu do të mund ta nxirrnin Shqipërinë përgjatë Adriatikut dhe përgjatë Jonit pararojë të lirisë së Ballkanit. Më këtë rast, ata, do të kishin patjetër mbështetjen e fuqishme të Europës. Do të ndodhte njësoj si në kohën e Gjergj Kastriotit. Dhe atëherë forcës së bashkuar të shqiptarëve prej Tivari, Toplice, Kosove, Vranje, Shkupi, Manastiri, Follorine, Kosturi, Janine, Preveze, Arte, etj, nuk do të mund t'i bënte ballë Sulltani. Ndërsa përsa i takon fqinjëve të Veriut e të Jugut në fund të shekullit XVIII dhe në vitet e para të shekullit të XIX, ata jo vetëm që nuk kishin thonj për të gërvishur, por as edhe nuk u ndihej zëri. Ende bënë gjumin e ariut. Por, dy pashallarët e plotfuqishëm shqiptarë, për hir të interesave të tyre vetjake e humbën shansin e madh. Egoizmi i marrë u vu mbi interesat e kombit. Papërgjegjshmëria e tyre rëndoi shumë mbi fatin e shqiptarëve. Për këtë arsye edhe ata, thuajse i lanë mënjanë botës së tyre e gati-gati i harruan fare.

Liçeni çfaqej hera herës mes së blertës së tij qetësuese. Me siguri frynte pak erë përderisa sipërfaqja i dallgëzonte lehtë. Çast pas çasti liçeni po humbiste. Po shkrihej njësh me horizontin gri, që për sfond prej mijëra vjetësh mbanë Micikelin e lashtë. Arbërit i mbeti mendja që nuk mundi ta shihte mirë gjolin e Ali Pashait. Por ish e pamundur. Autobusi e rriti së tepërmi shpejtësinë. Papritur mbi faqen e një muri të gjatë e të shtrirë, syri më kapi nxitimthi një parrullë të shkruar në gjuhën shqipe: “Mos i përzeni shqiptarët emigrantë! Ata janë vëllezërit tanë”.

Liçeni u riçfaq për herë të fundit. Sikur donte të

na përshëndeste. Por çfarë ndriu, çfarë shkëlqen ashtu mbi sipërfaqen e tij?! Një dallgë e kaltërt? Një rreze e brishtë dielli? Apo mos ndoshta ishte një zë i largët, jehonë e kushtrimit të të parëve. Në luftën për mbrojtjen e Janinës qenë derdhur lumenj të pafund gjaku. Prej babait, dija se në Bezhan të Janinës, qe plagosur edhe gjyshi im.

Mbrojtja e Janinës, tetor 1912 – mars 1913 është ndër humbjet më të dhimbshme, më të hidhura që kanë pësuar ndonjëherë shqiptarët në historinë e tyre mijra vjeçare. Rënia e Janinës si kryeqendër e Epirit shënon njëkohësisht edhe rënien e Çamërisë si pjesë përbërëse e tij. Kjo disfatë bashkë me humbjen e Kosovës (fatkeqësisht bekuar edhe prej fuqive të mëdha) shënon përgjysmimin e Shqipërisë. Gjashtë muaj rrjesht rezistuan janinjotët, konicjotët, pas gramoziotët, çamërit, leberit, etj, tok me ta me ta edhe garnizonet turke. Më tej ishte e pamundur. Ushtria greke ish përqendruar e tëra ne Epir. Komandën e saj e pat marrë në dorë vetë Kostandini – **princi trashëgimtar i Fronit të Greqisë, Ndërkaq, mbrojtësit gjendeshin çdo ditë më të dërmuar. Ndihma që çoi qeveria e porsa formuar e Ismail Qemalit ishte e pamjaftueshme. Përsa i takon kosovarëve ata, përlesheshin për jetë a vdekje me forcat serbo-sllave.**

Situata politiko-ushtarake pat ndryshuar krejtësisht. Ishte në disfavor të shqiptarëve. Nuk qe më si 35 vjet më parë, kur Lidhja Shqiptare e Prizrenit për Jugun, me në krye Abdyl Frashërin e mbrojtë denjësisht Epirin. Mungonte, gjithashtu edhe personaliteti determinativ i çamit Abedin Pashë Dino,

atëherë anëtar i Kryesisë së Lidhjes për Jugun e më pas edhe ministër i jashtëm i Portës. Ndërkohë Perandoria Osmane hiqte shpirt. Më së fundi kishte rënë edhe Bezhani i konsideruar si fortesa e Janinës. Grekët arritën fitore të dyfishtë. Patën mundur si shqiptarët po ashtu edhe turqit. Ja se si e përshkruan luftëtari dhe studjuesi i njohur çam Ibrahim Daut Hoxha tragjedinë: “Më 7 mars 1913, armata Kryqtare Athinë-Fanaritë e prirë nga Kostandini, hyri në Janinë... U dorëzuan 550 oficerë dhe 22000 ushtarë... Prej tyre 7000 ishin të plagosur e të sëmurë... kurse 5000 të tjerë të cilët nuk pranuan të dorëzoheshin u bashkuan me armatën turke të perëndimit. 4000 të tjerë mbetën dëshmorë...”⁵⁾ Përsa u takon luftëtarëve çamë duhet thënë se ata sërish treguan heroizëm të rrallë në mbrojtje të trojeve kombëtare. Në ditën e dorëzimit të Janinës, rreth 250 prej tyre gjendeshin ende në pozicione tek një mal pranë. Ushtarët grekë shkuan atje me mendimin se do t'i zenin të gjallë. Me t'u afruar forcat e para greke, çamërit hapën zjarr njëherësh e thujse i asgjësuan të tërë pushtuesit. Pas kësaj, grekët shumëfishuan menjëherë forcat e tyre. Çamërit nuk u dhanë. Luftuan për orë të tëra deri në pikën e fundit të gjakut. U bënë theror për kombin.

⁵⁾ Ibrahim D. Hoxha: “Çamëria dhe Janina në vitet 1912-1922” botuar prej SH.B. Hasan Tahsini, Tiranë 1996.

ARTA. SKAJI I EPIRIT

Mes trishtimit lamë pas Janinën. Në kërkim të dremitjes, Mirela, mbështeti kokën në pjesën e sipërme të ndenjësës. Arbëri, që ndjente gjendjen time shpirtërore më kërkoi sytë. Më buzëqeshi plot dritë. Ula pak kokën dhe e putha në flokë. Ai u brinjas tek unë. Sërish e putha lehtë. Si për të larguar monotoninë i hodha një sy urbanit. I ndarë në dy pjesë. Prej shoferit dhe këtej grekë. Hapësira ndarëse prej ndenjësesh bosh si kufi në mes. Ndërsa, nga mbimesi e në fund shqiptarët. Të heshtur të dy palët, të pafjalë. Për çudi, pasagjerët nuk flisnin as mes shoqi-shoqit.

Për dreq edhe peisazhi jasht krejt monoton. I

tëri shkëmbor, i ftohtë. Gjithë kthesa. Me gryka të shumta. Pa hapësirë, pa horizont. Kujtova në çast, se në xhepin e djathtë të xhaketës kisha gazetën “Koha jonë”. E pata blerë në mëngjes në të dalë të Tepelenës. Doja ta mirrja për ta lexuar por nuk munda. Arbëri u ankua. Me sa dukesh flinte. Nuk lëviza më. S`më mbetej gje tjetër veçse të mbyllja dhe vetë sytë. Ndoshta mund të dremitja. Por kisha vetëm një merak. Mos flija rëndë. Qytetin e Artës nuk do të dëshiroja ta kaloja pa e parë sërish. Siç e kam thënë më parë, gjatë vizitave që nëntë vjet të shkuara bëja prej Pireut në Çamëri, tok me Çimin shokun e ngushtë të fëminisë, më pati rastisur të shkoja edhe në Artë. Qyteti më kishte pëlqyer shumë. Jo thjesht se është qyteti më skajor i Epirit, por edhe pasi është tërësisht i bardhë.

Më zgjuan zërat e fqinjëve. Si nëpër të arrita të kapja këtë shprehje: “Në këtë qytet, në çdo tre banorë dy flasin shqip. Një pjesë dërrmuese e vendasve janë shqiptarë”. Gjumi më paskish zënë vërtetë. Hodha sytë përtej dritares. Isha me fat. Posa kishim hyrë në periferi të qytetit.

-Arta Mirela, - I fola gruas që hapi sytë menjëherë.

U zgjua dhe Arbëri. Jo larg nesh, mbi Lumin Aheron, si një ylber i madh u çfaq ura e gurtë ndërtuar prej Ali Pashë Tepelenës.

-Sa e bukur qenka babi, - u shpreh Arbëri.

-Si ndërtim, si formë, - tha Mirela, - është e njëjtë me Urën e Beratit përmbi Osum. Veçse pak më e madhe.

Por unë, nuk e kisha mendjen te dialogu i tyre.

Këtej urës, mes lagjes përdhese banuar prej shqiptarëve autoktonë kërkoja një shtëpizë të vogël rrethuar me avlli, me një oborr të gjatë përbrenda. Atje me Çimin, unë pata punuar një ditë. Ishte e shtunë, fund jave. Ndonëse ditë pushimi, për të fituar ndonjë dhrahmi Çimi shkonte e punonte nga Preveza në Artë. Në njërën prej këtyre të shtunave qëlloi ndodhia që po tregoj tani:

Pra, në atë shtëpizë përdhese, Çimi duhej të bënte pusetat e shkarkimeve të ujrave përgjatë oborrit. Meqë u ndodha tek ai duhesh medoemos ta ndihmoja. Theksoj qysh në fillim, se sa hyra në atë shtëpi të thjeshtë ku kuptohej se bëhej një jetë modeste u ndjeva si në Shqipëri. Solla ndër mend Pirenë, nivelin e tij të jetesës. Krejt ndryshe me Epirin. Në fakt, Epiri i Jugut është pjesa më e prapambetur e Greqisë. Është habi të themi se atje nuk ka fare linjë hekurudhore. Thashë se në atë shtëpi e ndjeja veten njësoj si në Shqipëri, si në fshatrat tona të Jugut. Më saktë sikur ndodhesh nëpër fshatrat çame. Fundet e shtëpive, si tek ne të lyera me gëlqere. Po kështu edhe fundet e avllisë së gjatë. Ndërsa rrugicëza, prej portës së jashtme deri në prag të shtëpisë me gurë, me plloça.

Puna na shkonte mbarë. Hera-herës, për t'ju hedhur një sy pusetave dilte e zonja e shtëpisë. Ajo ishte një grua me moshë mbi mesatare. Mbante të lidhur në kokë një shami të badhë të pastërt si dëborë. I shoqi, një burrë i gjatë shihej me të rrallë tek dera e shtëpisë. Si pa u ndjerë afroi edhe koha e pushimit, dreka. Duhej të hanim. Përkohësisht lamë punën. I thashë Çimit që t'i kërkonte pak ujë gruas. Ai i foli në greqisht. Ajo na vështroi si me dhembshuri dhe shpejt hyri në shtëpi.

Pas disa sekondash dolli. Në njëren dorë mbante gotën, në tjetrën një kanë të mbuluar me një cohë të bardhë, që përqark ishte punuar me grep:

-Pini more djelm, se u lodhët, - foli në shqip

Pas lodhjes së natyrshme që të dhuron puna, kjo e folur ishte një befasim i këndshëm për ne. E vështrova vëmendshëm.

-Moj nanë, juve shqiptare jini?

-Po, more bir, - u përgjigj gruaja dhe shtoi. –

Gluhën tuaj kemi.

-Si ka mundësi, - pyeti Çimi?

-Edhe ne shqiptarë jemi, - përsëriti ajo.

Unë, vetëm dëgjoja.

-Në Prevezë, - vazhdoi Çimi, - unë kam disa muaj që jetoj. Dhe e di që ka shumë shqiptarë. Por, që të kishte edhe në Artë, këtë tani, po e mësoj.

-Ka, more djalë ka. Shumë ka... - u shpreh gruaja.

Kishim vërtetë etje. Ujin e mbaruam menjëherë. Çimi falënderoi. I dha gruas si kanën edhe gotën. Pastaj bëmë për nga fundi i oborrit ku kishim edhe bukën. Na kishte marrë uria. Kur ende nuk patëm bërë as edhe dy tri hapa, e zonja e shtëpisë foli përsëri në shqip:

-Ku veni?

-Të hamë bukë, - tha Çimi.

-Bukë do hamë tok,- tha gruaja.

Qëndruam. Këtë herë, fola, unë:

-Zonjë, faleminderit. Por ne ushqimin e kemi me vete.

-Ç'ish thua ashtu more djalë,- reagoi, e prekur ajo. – Im shoq dhe djali po ju presin. Sufraja u ka

shtuar.

Vështruam në sy shoku-shokun. Ç'të bënim? E zonja e shtëpisë nuk na la të flisnim më. Eci përpara. E ndoqëm pas. Në derë të shtëpisë patën dalë i shoqi dhe djali. Kur u afruam i zoti i shtëpisë tha:

-Urdhëroni, urdhëroni. Sufrai është gati.

Ndërsa djali, më i ri nga ne në moshë bëri mënjanë për të na liruar udhën. Ai na buzëqeshi miqësisht. Më bëri përshtypje se gjatë drekës së thjeshtë por të ngrohtë, nuk foli asnjë fjalë shqip. Mos ndoshta nuk e dinte gjuhën tonë? Apo nuk e fliste mirë? Veçse edhe në Greqisht nuk u shpreh asnjëherë. Hante në heshtje. Pa fjalë.

Sidoqoftë kujtimet nuk më ndihmuan për të gjetur shtëpinë e vogël mikpritëse. Fshihej mes shoqeve të tjera përdhese në atë lagje periferike të Artës. Kishim arritur në qendër të qytetit të bardhë. Këtu menjëherë të tërheq vëmendjen kalaja. Ajo nuk është aq e madhe si fjala vjen e Gjirokastrës apo e Tepelenës. Nuk ngrihet mbi shtat të një mali apo mbi majën e një kodre të madhe. Të kujtonte pak a shumë kalanë e Elbasanit, veçse nuk ishte tërësisht fushore. Përqarkte në mes të qytetit ca si bokërima të lëna mbas dore. Sidoqoftë, kalaja e Artës mbetet një monument i rrallë kulture. Vallë kush e ka ndërtuar. Ndoshta si urën e madhe Ali Pashë Tepelena? Apo i takon principatave të hershme shqiptare? Princi mesjetar Gjini Bue Shpata, gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIV, qytetin e Artës e pat shpallur si kryeqendër të principatës. Ky princ shqiptar

qe shquar aq shumë në luftë kundër hegjemonizmit sllavo-grek.

Kjo është njëra faqe e medaljes që lidhet me kalanë e këtij qyteti. Ana tjetër e saj, lidhet me tragjedinë çame. Farë pranë saj, në një pikë dominuese për qendrën e qytetit lartohet monumenti i Napoleon Zervës. Shtatorja ushtarake kërcënon qartë. Mbi pedestal mbart dinamizëm. Madje jo vetëm kaq. Në se do përqendroheshim më tepër në të, atëherë figura vrastare krijon idenë se nga çasti në çast do të vihet në lëvizje. Vështrimi energjik e kushtrimdhënës forcohet ndjeshëm prej dorës së djathtë të shtrirë përpara që fton në sulm për drejt Jugut të Shqipërisë.

Përse vallë gjatë këtij shekulli të fundit, grekërit mbeten vazhdimisht në gatishmëri të lartë ushtarake? Përse kjo armiqësi fatale, paçka se ndonjëherë, çfaqet edhe përmes buzëqeshjeve e shtrëngimit të duarve. Realiteti i vjetër historik i vendos ata poshtë Epirit, përtej gjirit të Ambrakisë. Gjithashtu, gjatë periudhës mesjetare e tëhu raporti etnik mes shqiptarëve e grekëve është në favor të shqiptarëve. Gjithsej 650 mijë banorë. Prej tyre mbi 550 mijë shqiptarë, 60-70 mijë grekë e të tjerë vllah, çifutë... Ky raport ndryshon paksa në favor të minoritetit grek vetëm pas vitit 1913, kur fuqitë e mëdha përgjysmuan padrejtësisht Shqipërinë duke i hequr dhunshëm prej trupit Kosovën, Iliridën, (në perëndim të Maqedonisë) jugun e Epirit që përfshin brenda tij edhe vetë Çamërinë. Pas kësaj nis kalvari i tmerreve për shqiptarët e Epirit të Jugut. Të parët e pësojnë çamët. Qindra mijëra prej tyre duke mos e duruar dot zgjedhën ikin drejt Shqipërisë. Pasi dështon

tentativa e okupimit të Shqipërisë së Jugut nëpërmjet krijimit të Republikës autonome të Vorio-Epirit (1914-'18), shteti grek nis të zbatojë politikën famëkeqe të shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve prej trojeve të tyre etnike. Vlen të përmendet këtu shkëmbimi i detyruar i çamëve myslimanë me grekët e Anadollit (vite 1923-'26). Por nuk duhet ta pësonin vetëm çamërit, po të gjithë shqiptarët e tjerë në qytetin e Follorinës, Kosturit, pas Gramozit. Plot 35 mijë prej tyre përzihen dhunshëm. Ju grabitën gjithashtu shtëpitë si dhe pronat, të cilat ose shtetëzohen ose ju shpërndahen arbitrarisht ardhacakëve grekë të Anadollit.

Kjo lloj odiseje, por me ritme më të zbutura do të vazhdojë deri në fund të luftës së dytë botërore, kur çamërve do t'ju bjerë mbi kokë gjëma tragjike e Napoleon Zervës. Mijëra çam u vranë e u prenë në vitet 1944-1945. 25 mijë të tjerë u përzunë me pahir për në Shqipëri. Ndërkohë që minoritarëve grekë në Shqipëri nuk ju prek as edhe qinja e flokut.

Me gjithë këto krime tipike Milosheviçiane, shovinistët e tërbuar grekë ende nuk gjejnë qetësi. Si çakejt janë të etur për gjak. Mezi po durojnë të vënë nën thonj, nën kthetra edhe Shqipërinë e Jugut ose Veriun e Epirit. Vazhdon t'i tërbojë keqas e i bën të vuajnë në heshtje, raporti etnik mes shqiptarëve dhe grekëve i cili nuk ka pësuar ndryshim thelbësor edhe pas masakrave të fundit e të njohura të Napoleon Zervës. Grekërit përsëri mbeten minoritet në Epir. Kjo jo vetëm përse i përket Shqipërisë së Jugut, (Veriut të Epirit) por edhe për vetë Greqinë veri-perëndimore

(Epiri i Jugut). Tek e fundit çamërit ortodoksë kanë mbetur atje që prej Filatit e deri në Prevezë. Qytetin e Artës e lëmë pa përmendur, pasi për të pak folëm më lart. Pastaj në truallin e tyre etnikë mbeten edhe shqiptarët e Follorinës, Kosturit, Pas Gramozit, Konicës, Delvinaqit, Janinës, etj. Gjaku nuk bëhet ujë. Po të tjetërsohet në formulë, ai sërish nuk bëhet ujë, por veçse qelbet brenda damarëve të renegatëve të Kombit. Që prej 170 vjetësh, shteti grek aspiron jo vetëm Epirin por edhe Maqedoninë, Thrakën, vetë Stambollin. Tok me të mbarë hapësirën bizantine. E ç'është më e rënda, më e keqja kjo lloj marrëzie e madhështisë, ju mëkohet fëmijëve porsa ulen në bangat e shkollës.

Fjala e urtë popullore thotë: "Grekëve edhe kur ofrojnë dhurata nuk duhet t'u besosh". Ndërkohë që për ne shqiptarët me shtet të dobët, imazhi i Kalit të Trojës riçfaqet sërish. Në pranverën e përgjakur të 1997 a nuk u tentua uzurpimi i Vorio-Epirit? Madje diku u ngrit edhe flamuri grek. Por ishte kërcënimi amerikan dhe ai turk që i preu hovin andartëve të rinj. Ndërkohë që në vitin 2000, në vjeshtë të tij tentohet përsëri. Veçse këtë herë taktikat kanë ndryshuar. Në Himarë nuk kërcitën dhëmbët, por nëpërmjet zgjedhjeve ftohet të veprojë Uliksi, dinakëria e tij.

Ndërkohë në Tiranë, shtetarët shqiptarë i servilosen kryegjeneralit të Asfalisë së veshur me veladon, fort lumturisë së tij Janullatosit, që veç të tjerave arriti të hedhë baltë edhe mbi Nolin e Madh.

Greqia është aq e rrezikshme sa gjatë gjithë shtetësisë së saj (170 vjeçare) vetëm i ka zgjeruar

kufijtë e saj. Për të faktikuar këtë le t'i hedhim një sy hartës së shtetit grek.⁶⁾

Në vitin 1832 ajo fiton pavarësinë. Shteti i ri shtrihet në kufijtë e tij natyralë. Ne veri kufizon me Gjirin e Artës. Përfshin Peloponezin, Sterea Ellada, Eubenë dhe ishujt Ciklade. Sipërfaqja 50.000 km². Në vitin 1864 nis zgjerimi fillestar. Përfiton një sërë ishujsh përgjatë Jonit, mes të cilëve Korfuzin dhe Leukadet. Në vitin 1882 pas Kongresit të Berlinit i jepet Thesalia dhe ishujt mbi Eube. Dështon në gjallërimin e Epirit si pasojë e qëndresës së shqiptarëve me në krye "Lidhjen Shqiptare të Prizrenit" si dhe ndikimin e ndjeshëm të Abdyl Frashërit e Abedin Pashë Dinos (Ministër i Jashtëm i Perandorisë). Më 1913, pas rënies së Perandorisë Osmane dhe përkrahjes së fuqive europiane shkëput thela të majme. Në veri fiton një pjesë të Maqedonisë dhe Epirin e jugut. Merr edhe Kretën. Po kështu edhe ca ishuj të rëndësishëm, përgjatë gjysmës perëndimore të bregdetit turk. Në vitin 1923 përfshin Brenda kufijve edhe Thrakën Lindore. Ndërsa në vitin 1946 merr ishujt DODAKANEZË që i kish patur ITALIA. Arrin kështu një shtrirje gjeografike prej 110.000 km², mbi dyfishin e tokës së saj reale.

⁶⁾ Harta politike greke, botues "ΕΚΔΟΣΗ" 1997.

NGA AMBRAKIA NË PATRA

Fundi i Epirit dhe fillimi i Greqisë së vërtetë nis me qytetin e Ambrakisë dhe rrethinat, me atë që grekët e quajnë: “ ΣΤΕΡΕΑ ΕΛΛΑΔΑ”. Është vërtet e çuditshme! Këtu gjithçka tjetërsohet. E ujditur si me dorë, natyra mrekullohet. Bregdeti krijon menjëherë një si ballkon fantastik mbi Jon. Deti shpalos një bukuri të rrallë. Sikur loz me kaltërsinë e tij. Edhe i tejdukshëm edhe i blertë. Prej mijëra vjetësh, valët e tij, si dora e një skulptori ka trupëzuar aq bukur shkëmbinj të shumtë. Më tej, si pasojë e mpleksjes me rrezet e diellit, që porsa ka nisur të perëndojë praron sipërfaqen. Në largësitë e kaltërta nis të shndërrohet në blu. Ndërsa

dielli i etur mezi pret tretjen e disa minutave për t'u zhytur fuqishëm thellësive. Pasagjerët janë mbërthyer pas xhamave të dritares. Përjetojmë një ëndërr. Antikja shpalos këtu nuancat e para.

-Mrekulli... - isha shprehur vetiu.

-Jo më kot bota e adhuron prej shekujsh Greqinë – tha Mirela.

-Me të vërtetë qenka shumë e bukur, - tha edhe Arbëri.

-Është ende fillimi, - thashë unë. – Kur të arrijmë në Patra e të hipim në traget do të jetë edhe më bukur.

-Mendo Athinën – vazhdoi Mirela.

-Do ta shohim edhe Akropolin babi, - pyeti Arbëri.

-Patjetër.

Jo më kot thuhet se bukuria zbut shpirtrat. Nuk di sesi u shkëputa prej kënaqësisë që falte peisazhi i mahnitshëm, kur padashur kapa këtë detaj të veçantë. Nga mbi mesi i urbanit hasa vështrimin e një vajze të re greke. Shikonte plot kërshëri profilin simpatik të një shqiptari emigrant. Në çastin që kuptoi se dikush po e ndiqte e preu menjëherë shikimin. Ktheu përpara. M'u duk se ish përsququr lehtë në fytyrë, paçka se u hoq indiferente. Qe pikërisht ky detaj, i cili më shtyu të vështroj në anën tjetër të udhës. Po ç'të shihje?! Nga ana e detit mrekullia, ndërsa këtej, përgjatë murit mbrojtës të rrugës, parrulla të shumta. U bëra kurioz të kuptoja se ç'shkruhej në to. Megjithëse nuk është e thjeshtë të lexosh në gjuhën greke, arrita të kapja përmbajtjen e disave prej tyre. Befasia që e madhe. Në mes ishte Kosova. Lufta. Apo nuk dukej e zhdukej si

refren nëpër këto kthesa drapri dhe çekani, symbol i komunizmit. Ngjitur me të PKG, PKG... Ç' bëhet kështu thashë me vete?! Ende qenka gjallë ndikimi komunist në Greqi?! Shyqyr i qoftë zotit që ne në Shqipëri kemi shpëtuar prej tij!

Parrullat ishin nga më të ndryshmet: NATO-RACIZËM; NATO-FASHIZËM; KLINTON-HITLER; BLER-HITLER; USA-FASHIZËM; AMERIKAN-JANKI; LEVINSKI-LEVINSKI... etj. Kosova rezononte ende në Greqi. Nuk di, por më erdhi ca për të qeshur. Ndoshta ngaqë m'u kujtua mentaliteti komunist i Shqipërisë, gjatë kohës së Enver Hoxhës. Pikërisht kështu përçmohej atëherë Amerika. Por në rastin e grekëve çudia është vërtetë e madhe. Kjo jo thjeshtë për faktin e thënë shpesh se gjoja Greqia paska prodhuar Perëndimin. Në këtë mes ka diçka akoma më të thellë. Pas luftës së dytë botërore, shteti grek shpëtoi prej Perandorisë Komuniste vetëm në sajë të Perëndimit e mbi të gjitha sepse u mbështet fuqishëm prej SHBA dhe Anglisë. Plani Marshall e vuri atë në binarët e duhur.

Por ja që edhe pas mbi një gjysmë shekulli, me rastin e luftës së Kosovës, Greqia i ktheu shpinën Perëndimit dhe hedh sytë siç ka bërë shpesh herë drejt stepave të ftohtë. Greqia e sheh luftën e NATO-s kundër Serbisë, jo si një kundërpërgjigje ndaj shtypjes serbe në Kosovë, por si një goditje ndaj vëllezërve ortodoksë të Beogradit. Sigurisht edhe si forcim të shqiptarëve me gen pro perëndimor. Politika agresive shpejt merr edhe nuanca kriminale. Viktima të saj bëhen diplomatët anglezë, italianë, etj... Në mes të Athinës kryen atentate... Duhet thënë se atë ç'ka bëri Serbia në

Kosovë, Greqia e ka bërë prej vitesh në Çameri e gjetkë.

Por në fakt, ne cilën anë janë grekët? Në cilin krah anojnë ata? I përkasin Lindjes apo Perëndimit? Paçka se bashkë me Turqinë janë vendet e vetme ballkanike që marrin pjesë në NATO. Mos ndoshta marrëzia e madhështisë Megalaideiste e ka vendosur Greqinë krejt rastësisht në Perëndim?! Pse urrehet kaq shumë Amerika prej grekërve? Përse gjithë kjo xhelozi? Apo mos shpresohet se një ditë do të rikthejë sërisht Perandorinë Bizantine? Sidoqoftë qëndrimi i saj gjatë luftës së Kosovës tregoi hapur se Greqia ende nuk i përket Perëndimit. I takon më shumë të shkuarës sesa të ardhmes.

Parrullat ANTI-NATO; ANTI-USA, etj, mbetën pas bashkë me paradoksin e tyre të madh. Për një çast u çfaq qyteti i Ambrakisë, (e vetmja koloni helene në gji) që gjatë faqes së një kodre a mali të ulët, ka formën e një patkoi. Në skelën e saj gjendej e ankoruar anija jonë “Aulona” (Vlora). E braktisur, e lënë pas dore, ajo ngjasonte me një relike të stërmadhe, dëshmi e eksodit të dhimbshëm të shqiptarëve, në të hyrë të viteve '90.

Tashmë ishte errësuar plotësisht. Ndihehim sa të kënaqur po aq dhe të lodhur. Në çastin kur Greqia turistike niste të shpaloste visaret e saj pllakosi nata. Do të donim që dita të zgjaste më shumë. Por ishte e pamundur. Natyra ka ligjet e saj. Stina e dimrit me ditët e shkurtra e netët e gjata sapo kish filluar. Sidoqoftë ambienti me kondicioner i urbanit jepte

ngrohtësi. Brenda sërish pati pllakosur heshtja. Shoferi kishte ndezur vetëm dritat e vogla e të zbehta. Sikur i ftonte pasagjerët të pushonin, të flinin. Deri në qytetin e madh e të bukur të Patrës kishim udhë të gjatë për të bërë. Befas, mugëtira e heshtjes u gërvish prej një gërhime të zgjatur e të rëndë. Arbëri çamarok u gjend menjëherë në këmbë. Kureshtja fëminore e shtynte të mësonte se cili prej pasagjerëve ia kishte marrë me gërnëtë. Një gjë kuptohej fare lehtë. Muzika vinte prej pjesës së grekëve.

-Plaka, - tha Arbëri, që për të mos ia plasur së qeshuri zuri gojën me dorën e vogël.

-Mistrec, - e qortoi jo aq seriozisht Mirela.

Edhe ajo uli kokën. Mesa dukej nuk donte të binte në sy që e kapi gazi. Për një çast gërhima u ndërpre. Vura re se plaka që u pat britur shqiptarëve në Janinë, lëvizi në ndenjësën e saj. Mesa duket nuk po bënte rehat. Deri në Patra mbetej goxha kohë. Duhej të flija medoemos.

Zgjimin na e bëri Arbëri që briti:

-O ma, o ba trageti, deti...!

Shoferi lajmëroi se duhet të përgatiteshim për të zbritur. Autobusi do ngjitej në traget. U rregulluam shpejt e shpejt. Arbërin e mbërthyem mirë deri në grykë. Pas pak u gjendëm në tokë. Ftohtë. Pashë orën. Mesnatë. Vura përpara Mirelën që mbante fort nga dora Arbërin. Mes vorbullës së pasagjerëve të shumtë hymë në traget. Pa bërë mirë as 10 metra brenda tij, për çudi plaka e Janinës zuri nga krahu Mirelën. Ajo jo vetëm u befasua, por edhe u tremb pak. I foli në shqip.

-Çfarë do? Unë jam shqiptare e jo greke.

Unë ndiqja vëmendshëm skenën e papritur. Arbëri po ashtu. Ndërkohë plaka u shpreh gjithashtu në shqip.

-Po edhe unë moj bijë shqiptare jam.

Befasimi ishte i madh. Sytë e Mirelës shprehnin habi e mëri bashkë. Ndërkohë vazhdonte të shtrëngonte fort dorën e Arbërit. Instiktivisht tentoi të tërhiqte krahun prej dorës së plakës.

-Lëre, lëre, - ndërhyra unë që shtova. – Po pse moj nëne nga jeni ju?

-Nga Konica, - ishte përgjigja e saj.

Mbeta. Diku nga faqet e para të librit kam thënë se edhe gjyshja ime (nëna e babait) ka lindur dhe jetuar në Konicë. Pas copëtimit të Shqipërisë në vitin 1913, kur shteti grek nisi të përzërë shqiptarët me dhunë prej vatrave të tyre, familja e saj erdhi e u vendos në Delvinë, tek dajallarët. Duke qenë se familja e saj ka qenë fis i njohur në Konicë dhe duke parë moshën e shkuar të plakës vendosa ta pyesja. Por plaka nuk ia zuri fillin muhabetit. Na mori për refugjatë, për emigrantë që jetonim e punonim, në Konicë. Madje u mburr se në shtëpi të saj mbante dhe një grua prej Shqipërisë të cilën e ndihmonte shumë. Por kur unë e sqarova mirë heshti menjëherë. Madje sytë e vegjël e të zgjuar iu picëruan edhe më.

Duke u ngjitur nëpër shkallët e tragetit kjo situatë u kapërcye. Veçse plaka nuk ia lëshonte më krahun Mirelës. Ku më mirë se tek familjarë si ne ajo do të gjente mbështetje? Ishte mesnatë. E vetme. Seç i çuquriste pa ndërprerë sime shoqeje. Madje për një çast e bëri edhe të qeshte. Ndërkohë që mua më brente

anashkalimi i bisedës për fisin e gjyshes sime. Diçka më thonte se e njihte. Vendosa që ta rihap përsëri bisedën. Por plaka nuk i shqitej për asnjë sekondë Mirelës. I fliste, i fliste dhe vetëm i fliste. Ndonëse frynte erë e bënte ftohtë qëndruam jashtë në tavernë. Tej, qyteti i Patrës xixëllonte. Arbëri shihte i magjepsur. E tërhiqte së tepërmi zhurmimi i thellë i detit. I veshur bukur dhe trashë rrinte mes nesh si arush i vogël.

-Moj nëne. Nuk të mësuam as emrin, - ngacmova unë.

-Leonora, Leonora Berati më thonë. Mbjaj akoma mbiembrin e burrit, - vazhdoi ajo. – Ka qenë doktor me nam. Nuk rron më mavria. E donte e gjithë njerëzia. Si këtej, ashtu edhe andej nga Shqipëria.

-Po ku po vete kështu vetëm? – e pyeti Mirela.

-Vete në Athinë, tek djali, - u përgjigj ajo. – Bën punë të madhe atje. Është avokat.

E folura e saj afrohej më shumë me dialektin korçar. E pastër, lozonjare. Po pse vallë ishte sjellë ashtu ndaj shqiptarëve në stacionin e Janinës? Lozte politikën me policët grekë. Ishte tepër e zgjuar, dinake dhe hiqej më greke se vetë grekërit. Por qëndrimi i saj kishte një arsye të thellë edhe justifikohesh.

Shqiptarët ortodoksë si dhe arvanitasit, tërë jetën e tyre kanë qenë viktima të një diktature të egër nacionaliste. Atyre, kurrë dhe asnjëherë nuk ju është njohur e drejta e të qenurit shqiptar. Krejt ndryshe ka ndodhur me minoritarët e paktë grekë në Shqipëri. Ata gjithnjë janë arsimuar në gjuhën e tyre kombëtare. Kanë shtypin, gazetat e tyre. Gjuhën e nënës e përdorin pa asnjë lloj problemi si nëpër rrugët e Dropullit e po ashtu

edhe në mes të Tiranës. Ndërsa për shqiptarët autoktonë në Shqipëri, përdorimi i gjuhës së nënës përbën një sakrilegj të vërtetë. Lëre më pastaj të mendojmë që të kenë edhe ata radio, libra, gazetat e tyre. Diktatura nacionaliste greke të këput zverkun si të zogut për idera të tilla. Greqia nuk fal as edhe bashkë kombasit e saj kur gabojnë në këto drejtime. Pak kohë më parë a nuk u dënua me gjyq, me 18 muaj burg një shkrimtar helen i cili pati kurajon të shkruante se në vendin e tij, veç gjuhës greke ka egzistuar dhe përdoret edhe gjuha shqipe, vllahe, etj. Presioni shoven rritet më tej ndaj shqiptarëve autoktonë të Epirit, sa herë që propaganda greke anatemon ndonjë rast kundërligjor të shqiptarëve të sotëm emigrantë.

Plaka na doli vërtetë hokatare e madhe. Me shakarat e saj e shkuli së qeshuri Mirelën. Kur u nis trageti, mes humorit të saj ajo bëri shenjën e kryqit. Veçse ajo e bërë ish sa për të thënë. Mes shikimit të saj plaka e zgjuar la të kuptonte se atë veprim e pat kryer nga halli. Përsëri seç foli dhe sërish tok me Mirelën qeshën me të madhe.

-Moj nëne, -ndërhyra unë. Qëparë të pyeta për Kushajt apo Sherretët e Konicës. Nuk më the ke dëgjuar për ta apo jo.

Mimika e saj aq hokatare u frenua. Nuk fliste e qeshte më. Pyetja sërish nuk i pëlqeu. Megjithatë zuri të fliste. Mesa duket plaka koniciote po hapej.

-Kam dëgjuar, kam dëgjuar për ta. Fisi i tyre kish emër. Por patën fatin e çamërve...

Pas kësaj heshti. Një cep të shamisë së zezë që i pat shkarë e ngriti sërish mbi ballë. Lëvizi dorën në

atë mënyrë si për të thënë, kohë të vjetra, të shkuara ato. Nuk e trazova më. Nxorra nga xhepi paketën. I afrova një cigare edhe asaj. Por nuk e mori duke thënë se nuk tymoste. Me zor e ndeza vetë për shkak të erës së fortë. Fola ashtu kot.

-Mirela, kujdes djalin. Mos ia lësho dorën.

Bëra përpara për t'u gjendur sa më në krye të tragetit. Qyteti i bukur i Patrës flakëronte i tëri. Pas pak minutash, trageti u ancorua përgjatë bregut ku zinte fill edhe qyteti. Nisëm të zbrisnim. I pari Arbëri e Mirela pas tij. Prapa saj plaka që për çudi ia kish hequr dorën. Urbani priste jashtë. Shoferi sinjalizoi përmes burisë. Nxituam. Plaka sikur u distancua pak prej nesh. Në autobus u ngjit e para. Pas saj edhe ne. U ul në ndenjësën e saj rëndë-rëndë.

-Nëne, - i foli Mirela duke i vënë dorën mbi sup. – Do të llafosemi përsëri kur të zbresim në Athinë.

Ajo nuk reagoi. Ndërkohë në urban behu një burrë me uniformë ushtarake, por jo polic. Për habinë më të madhe, plaka ulëriti prapë.

-Pissu, alvanos, pissu...

Mbetëm të shokuar. Gruas s'i ngeli pikë gjaku në fytyrë. U zverdh e tëra. Bile u tremb. Veç këtë çast e kapërcyem shpejt. Tek ecnim për në fund të autobusit, Arbëri shpërtheu në një të qeshur.

-Ua, - u shpreh edhe Mirela! – Plakë e çmendur.

-Nuk është e çmendur, – thashë unë. – Përkundrazi është e mençur. Ruan veten. Ka frikë. Mosha i ka afruar një eksperiencë të hidhur. Shqiptarët vazhdimisht kanë vuajtur dhe vuajnë ende në fqinjën e jugut.

ATHINA. PIREU

Sërish u bë shkas marrëzia e plakës koniciote, që bregdetin e gjatë e tepër piktoresk të Peloponezit, prej Patrës në Korinth ta kalonim pa emocion. Flinte duke gërhitur. Më ra në sy, që tashmë po bëhej e bezdisshme edhe për vetë pasagjerët grekë. Madje vajza e re pas saj, e cila në të hyrë të Gjirit të Ambrakisë pat shprehur kërshtëri ndaj fqinjit tonë simpatik e shtyn pak në sup. Plaka e ndërpreu pak gërhimën. Bëri një gjysmë rrotullimi në vend dhe muzikë... Të gjithë e shihnin me mëri por ç' mund të bënin. Iu drejtova gruas dhe djalit.

-Pak më vonë do të kalojmë mbi urën e Kanalit

të Korinthit.

-Atë kanal in e madh, - u shpreh kurioz Arbëri.

-Po, - thashë unë.

-Sa keq, - foli Mirela. - Është errësirë e madhe e nuk duket gjë.

-Edhe unë nuk shoh asgjë babi, - u ankua Arbëri.

Si ato arushët e bukur të vitrinave majën e hundës e mbështeti mbi xham. Krijoi një fashë të lehtë avulli. Por më kot mendohej. Terri i thellë e pengonte së tepërmi. Mesa dukej, Kanali i Korinthit, kjo kryevepër ndërtimore e njerëzimit pati kaluar pa u vënë re.

-Arbër, Arbër, - fola unë. – Mos u mendo më, shpirt i babit. Kanali me siguri ka mbetur pas.

-I, i, i... - u shpreh ai.

-Mos u mërzit, - thashë unë. - Kur të shkojmë në Tripoli, tek Ledi do ta shohim pa diskutim.

Athina, kryeqyteti i famshëm sikur po bëhej më i ndjeshëm. Në të dy krahët e autostradës dritat po dendësoheshin. Autobusi e rriti më tej shpejtësinë. Mesa kuptohej udhëtimit tonë po i vinte fundi. Vetën e ndjemë si të lehtësuar. Veç, entuziazmi u fashit shpejt. Një tabelë treguese kaloi vrikthi. Me gërma e numra të mëdha shkruhej: “Athina-80 km”. Qenkemi akoma larg mendova. Për të mbërritur në Athinë u dashka të paktën edhe një orë. Megjithkëtë afrimi i qytetit të madh ndihej minutë pas minuti. Shpejt autostrada u zgjerua nga 4 në 6 korsi. Dendësimi i automjeteve bëri që shoferi të ngadalsonte përsëri shpejtësinë. Ja tek u duk edhe postoblloku i parë. Korsitë e autostradës u bënë mbi 10. Për të paguar kalimin na u desh të prisnim ca.

Por ç'të shihje. Nëpër mure të betonit të sërish avazi i njohur i parullave Anti NATO, Anti Amerikë, Anti Klinton. Veçse këtë herë fjalët shoqëroheshin edhe me karikatura të ndyra. Bill Klinton bënte dashuri me Monika Levinskin. Po kështu, nëpër mure qenë vizatuar edhe simbole të ndryshme serbe si ato të tre gishtave. S_{vc} të mëdha etj. Një hartë e shëmtuar e Kosovës i qe bashkëngjitur Jugosllavisë së mbetur. Mirela me preku me brryl.

-I pe? – më pyeti.

-Po – i thashë dhe shtova. – E pabesueshme!

Gjithë kjo histeri antiamerikane, kur është pikërisht ky shtet që i ka nxjerrë në dritë.

-Të pabesë, - vazhdoi Mirela. – Pastaj kanë frikë që mos t'iu ndërkombëtarizohet edhe çështja e Çamërisë.

-Ashtu është, - pohova unë. – Genocidi i ushtruar ndaj çamërve në vitet 1944-1945 është identik me atë të Milosheviçit në Kosovë.

Pasi kish paguar taksën e udhëtimit nëpër autostradë, shoferi pat nisur përsëri urbanin. Afrimi i metropolit të madh sa vinte e bëhej edhe më i ndjeshëm. Natën vonë, kalimi përgjatë bregdetit athinjtë përbën një mrekulli të vërtetë. Të duket sikur jeton në ëndërr, në përrallë. Një realitet i ri, krejtësisht i panjohur. Ndoshta paksa i ankthshëm, i frikshëm. Vallë ku po hynim? Mes mbretërisë së Hadit apo në vendin e sirenave marramendëse.

Gjendeshim në një botë të argjendte. Drita, drita, drita gjithkund. Në krah të majtë rrinte një lumë i tërë automjetesh. Djathtas, në det, tragete, anije,

motoskafë të vegjël, etj. Posa merr një kthesë të fortë gjithçka të duket sikur përmbysset. Tashmë lumi i pafund i automjeteve rrjedh në krah të djathtë. Ndërsa tragetet, anijet, skafet e vegjël kanë kaluar në krah të majtë. Drita e hënës me luspa-luspa praron detin. Kurse lart, mes yjesh, si një fron i artë perëndish Akropoli.

Siç ndodh përherë, mrekullitë o zgjasin pak o humbin shpejt. Si pa kuptuar, si pa u ndjerë një pjesë e rivierës athinjote u tret. Më së fundi autobusi që parkuar në stacionin e madh të Athinës. Zëmë të zbrisnim me radhë. Në fillim grekët. Pastaj ne. Ulërit po deshe. Në Greqi diskriminimi nuk është më një rastësi. Ai është shndërruar përfundimisht në një realitet. Një çast tej dritareve vura re plakën . Edhe ajo na pa me bisht të syrit. Kishim vendosur për të mos u afruar më. Veçse këtë herë ajo iku vjedhurazi. Humbi në terrin e saj. Ndërkohë dëgjuam të na flisnin në emër tjetër. Ishte Flutura me Shyqon. Dy miqtë tanë të vjetër, që jetonin e punonin prej kohësh në Athinë. U ndjemë ca ngushtë. Kush e di sa kishin që na prisnin. Autobusi pat ardhur me vonesë. Për ne po sakrifikohehin. Vallë do të kishim rast t'ua shpërblenim mirësinë me mirësi. Ku ta dish. Zoti është i madh në qiell. U përqafluam dhe u përshëndetën me mall.

Duke qënë se e nesërmja, ishte jo vetëm ditë pushimi por edhe me diell vendosëm të vizitonim Akropolin. Arritëm shpejt pasi shkuam me makinë. Mijëra njerëz. Të bardhë e të zi. Bjondë e të verdhë. Merre me mend, për t'u ngjitur deri lart, duhej

me doemos të viheshe në radhë. Prej disa shkëmbinjeve në krah të djathtë, dukej në pëllëmbë të dorës jo vetëm Athina, por edhe Pireu me detin. Mbi shkëmbinj, me shpinë nga Athina bëme ca fotografi. Për të dalë të tre së bashku, i kërkuam ndihmë një çifti të ri të panjohur shqiptarësh. Ata nuk ngurruan. Na fotografuan menjëherë. U takuam edhe me bashkatdhetarë të njohur si rasti i poetit të talentuar Visar Zhiti. Nuk mund të linim pa vizituar edhe amfiteatrot e vjetër, ku për herë të parë ishin lojtur tragjetitë e Eskilit, Sofokliut, Euripidit, etj. Tepër të bukur, emocional. Natyrisht pozuam edhe aty pranë. Më së fundi pasi u vumë në radhë u gjendëm poshtë Akropolit. Madhështor. I erdhëm përçark. Shihnim të mahnitur bukuritë e tij. Fotografuam nëpër pika të ndryshme. Pastaj vizituam muzeun. Këtu, më mirë se në sa e sa filma dokumentarë, libra apo revista grekërit e vjetër kanë bërë të njohur plotësisht vetveten. Arti i tyre edhe sot e kësaj dite mbetet i paarritshëm. Një pasuri vërtetë e rrallë, e paçmuashme për mbarë njerëzimin.

Kishim dalë prej muzeut e menduam të bënim sërish fotografi. Për të dalë të tre tok iu lutëm një mesoburri aty pranë. I fola italisht. Zotëria në fjalë reagoi po në këtë gjuhë. Veçse ishte grek, pasi e tërë familja e tij, gruaja dhe dy vajzat ju gjendën menjëherë pranë. E vogla që me sa dukej ishte në moshën e Arbërit, gëzonte e lumturonte e tëra duke thënë:

-“Papa kseris polikali italika. – Babai di shumë mirë italisht”.

Pas pozimit i falënderuam e në largim e sipër i përshëndetëm miqësisht. Po kështu reagoi edhe greku.

Ndërsa gruaja dhe vajzat na shihnin me plot admirim.

-Po sikur ta dinin se jemi shqiptarë, kështu do të reagonin, - tha me zë të ulët Mirela?

-Jo,- thashë unë. – Kaq shpejt e harrove plakën?

Ecëm më tej. Po a fronte mesdita. Dielli qe ngritur në Zenith. Pashë orën. 12 pa 12 minuta. Megjithëse fund dhjetori bënte ca vapë. Si unë, e po ashtu edhe ime shoqe zbërthyem palltot e mëdha. Ndërsa Arbëri kish hequr xhupin e trashë dhe e mbante me kujdes në parakrah. Kur nga pas shpinës sonë, vajza e vogël sërish.

-“Papa kseris polikali italika – Babai di italisht shumë mirë”.

Kthym kokën prapa. E vogla na vinte nga pas. Ndërsa pjesa tjetër e familjes qëndronte tri katër metra larg. Na buzëqeshën përsëri. Madje këtë herë na përshëndetën edhe me dorë.

-Çiao,çiao – bëmë ne që ishim të detyruar të vazhdonim lojën.

-Çiao,çiao,- pasuan ata në korr.

-Papa kseris polikali italika, papa kseris polikali italika, - përsëriste e vogla.

-Nxitojmë ca, - tha Mirela. – Me sa shihet, këta qenkan të marrosur pas italianëve. Nuk t’u shqitkan kollaj.

-Me ngadalë, - thashë unë.

Vumë re se grekërit tashmë na qëndronin në krah. Greku seç më tha, por unë duke qenë se nuk e mora vesh buzëqesha formalisht. Ndërkohë Mirela u mënjanua pakëz djathtas. Grekët, që më së fundi e kapën mos predispozicionin tanë për afrim ngadalësuan

çapin. Kurse e vogla pranë babait këndonte:

-Papa kseris polikali italika, papa kseris polikali italika...

Disa minuta më pas pandehëm se i patëm humbur. Kur, ata sërish na u gjendën në krah, gjatë kohës që po zbritnim shkallët për të dalë jashtë rrethinës së Akropolit. Miqësia e tyre e tepruar vinte erë servilizëm. E vogla si gjithnjë me avazin e saj të zakonshëm. Por këtë herë, tok me të qëndronte edhe motra me t'ëmën. I ati në fund. Na buzëqeshën përsëri. Ne gjithashtu.

-E çuditshme, - tha ime shoqe. – Shumë të ngjitur qenkan.

-Edhe ekstraterrestë të ishim, - tha Arbëri, - nuk do bënin kështu.

Tek pa se vajza e vogël po ia bënte me dorë, u bë prush në fytyrë. Mirela që e kapi këtë detaj nuk e mbajti dot gazin. Pastaj për të mos lënë shteg hatërmbetjes, përshëndeti.

-Çiao, çiao!

-Çiao, çiao – bën ata.

Pireun, nuk do ta lija kurrë pa e riparë. Plot 9 vjet të shkuara pata punuar e jetuar aty për 4 muaj si emigrant. Kujtoj se aq shumë isha lodhur e munduar, sa që kur u ktheva në shtëpi nuk më njohu as kunata. Shkova burrë 82 kg., u ktheva si fëmi 64 kg. Pastaj i kisha dhënë gruas dhe djalit fjalën se do t'i shpija patjetër si në vendin ku punoja, po ashtu edhe ku flija. Gjithashtu dëshiroja të takoja edhe Xha Spiron, njeriun

që më ndihmoi me gjithë shpirt. Ndonëse, unë qëndrova për pak muaj aty, mirësinë e tij, nuk mund ta harroj kurrë. Spiron nuk e mbaj asnjëherë mend të më shihte shtrembër e lëre më pastaj të më hante hakun apo të më keqtrajtonte. Krejt ndryshe ishte Andoni, sipërmarrësi i punës së tij, të cilin nuk dua ta përmend më.

Kujtoj mirë, se për të shkuar nga stacioni i autobusave, fare pranë sheshit “Omonja” për në Pire, duhej të mirrja urbanin me numër 52. Ato muaj, unë pata banuar në lagjen e Nikjes. Autobusi qëndronte përsëri tek lulishtja. U ulëm për pak minuta atje. Ndeza një cigare. Menjëherë më ra në sy një fakt i njohur. Në njërin prej këndeve të lulishtes, afrikanët e zi, bënë ende tregëti të vogël. Shisnin plaçka të ndryshme. Nëntë vjet më parë, tek këta edhe unë pata blerë një xhup të zi.

-E sheh këtë kinkalери, - i thashë Mirelës.

-Po, - u përgjigj ajo.

-Këtej të telefonoja gjithnjë.

Mirela mbështeti kokën pa u ndjerë mbi supin tim. Arbëri, na dëgjonte.

-Ndërsa tek ai dyqani përballë, kam blerë biçikletën e djalit, si dhe plakun plastik të vitit të ri.

-Vërtetë babi, - u entuziazmuva Arbëri.

-Po, - thashë unë.

Ai m'u fut mes gjunjëve dhe më puthi. Si piva cigaren, u ngrita. Morëm rrugën drejt shtëpisë ku pata fjetur. Ndodhej në pjesën kodrinore të Nikias. Zumë t'i ngjiteshim të përpjetës.

-Ua, - si qenka këtu! – shprehu habinë Mirela

dhe shtoi: - Njësoj si në ato filmat e Parisir mesjetar, ku luan Zhan Mareja.

-Gjithnjë kam pasur idenë – theksova unë, - se kjo pjesë ishte më e vobektë e gjithë Pireut.

-E pra, - tha Mirela dhe vazhdoi. – Se deri tani Pireu, më ka pëlqyer shumë. Megjithëse ti ke thënë, se pjesa më e bukur e tij është përgjatë detit.

-Arritëm, - foli unë dhe bëra me dorë. – Ja këtu kam jetuar.

-Po kjo qenka bodrum, more babi, jo shtëpi – u shpreh Arbëri.

-E tmerrshme, - tha Mirela si e trembur. – Eja të ikim shpejt.

Nënqesha vetiu. Mirela eci përpara. Djalin e mbante nga dora. Pak më poshtë, pasi e kishte mbledhur veten diçka, ngadalësoi hapin. Më futi krahun dhe foli:

-Kam nevojë të pi një kafe, po jo këtu pranë. Atje te lulishtja ku u ulëm në fillim.

Pas pirjes së kafesë, në qendër të Nikias morëm një taksì. Nuk do mund të largohesha pa parë edhe njëherë vendin ku kisha punuar. Po si mund ta harroja Xha Spiron, atë plak të mirë grek. Atëherë, ai ndërtonte një qendër të re mjeksore për djemtë e tij. Në atë zonë të pasur të Piresë, Xha Spiron e nderonin të gjithë: “I ka me djersë e me gjak Spiroja”, - thonin.

Taksisti ishte një meso burrë me mustaqe. Dukej i rëndë. Vendi ku pata punuar nuk mbante më shumë se një çerek ore me makinë. Shpejt u gjendëm në rrugën e madhe. Premë djathtas tek një e përtpjetë e gurtë. Qëndruam në krye të saj. Punishtja e vogël e mermerit

funksiononte ende.

- Ja tek është, - i tregova gruas dhe djalit.

Zbritëm të tre. Shoferit i thashë të priste. Derisa piva një cigare i rashë vërdallë asaj punishteje të vogël. Pasi krijoi një hark nervoz në ajër, fundi i cigares u përplas mbi asfalt. Këtu pata kaluar kohën më të vështirë të jetës sime prej emigranti në Greqi. Sa herë i kisha përgjakur gishtërinjtë. Por, se mos isha i vetëm! Në Greqi punonin e vazhdojnë të punojnë qindra mijra shqiptarë. Emigrimi mbetet një plagë që ende rrjedh gjak.

- Në punishte, - fola, - nuk njoha njeri. Të gjithë ishin të rinj. Hymë sërish në taksi. I bëra shenjë shoferit që të zbriste andej nga kishte ardhur. Nuk e pata të vështirë të gjeja qendrën mjeksore të Spiros. Por për fat të keq, ai nuk ndodhej në shtëpi. Sa ters! Si mund ta takoja? Më ra ndër mend, se aty pranë gjendej dyqani i vjetër i të birit. Fatmirësisht ai ishte atje. U njatjetuam. Nuk kuptova se a më mbante mend apo jo. Tek e fundit ç'ëndësi kishte kjo. Unë interesohesha për babanë e tij. Andaj edhe e pyeta. Më tha se mbahej ende mirë, sado që moshë bënte të sajën. U gëzova.

-Po ku është? – e pyeta sërish.

-Tani babai, më shumë rri në fshat se këtu, - u përgjigj ai.

Sinqerisht më erdhi keq. Kështu, nuk do të kisha mundësi për ta takuar. Në dyqanin fqinj bleva një buqetë me lule. Në shenjë respekti për xha Spiron ia lashë të birit. Iu bë qejfi. E përshëndeta dhe u largova.

-Në Athinë, - i thashë shoferit sa hyra në makinë.

-Ku ishte? – pyeti Mirela.

-Në fshat, - iu përgjigja. - Me pushime.

Arbëri s'po fliste. Rrinte në ndenjësën e parë të makinës. Kurioziteti e kish mbërthyer të tërin. Nëpërmjet pasqyrës vura re, se mimika e shoferit nuk kish më atë shprehjen e rëndë. Diçka e mundonte. Seç donte të thoshte. Por duke parë gjendjen tonë pa humor, ngurronte. Më së fundi foli:

-Edhe unë, jam shqiptar. Nga ata të vjetrit. Arvanitasit. Gjyshja ime nuk dinte greqisht. Fliste vetëm shqip.

-Ashtu,- fola unë që u shtrëngova të buzëqesh.

-Po, - pohoi ai.

-Përse edhe në Pire ka arvanitas? – pyeta unë dhe shtova: - Di që ata jetojnë në Athinë, në lagjen Pllaka.

-Ashtu është, - tha shoferi. – Po arvanitasit banojnë kudo nëpër Greqi. Unë p.sh. jetoj në Thiva, tetëdhjetë kilometra larg Athinës.

Pastaj si për të krijuar një ambient edhe më të ngrohtë, mustaqexhiu u mundua të fliste ca shqip. Por, jo. Nuk arrinte të shprehej dot. Sidiqoftë, disa fjalë, si : Bukë, ujë, kripë, etj, i tha mirë.

NË TRIPOLI

Për ta përjetuar më me qetësi mrekullinë që të fal bregdeti helen, menduam që rrugën nga Athina për në Tripoli, ku punonte e jetonte Ledi, kushërira e parë e Mirelës, ta bënim jo me urban, por me tren. Pastaj, përse të mos krijonim edhe një farë variacioni në mënyrën e të udhëtuarit tonë. Apo nuk na patën bezdisur paksa autobuzët. Lëvizja me tren do e pasuronte më tej udhëtimin, ndonëse mund të humbisnim diçka në kohë. Trenat i pëlqente shumë edhe Arbëri. Dëshira për të udhëtuar me to, i pat mbetur qysh prej emigrimit tonë në Itali. Të shtunave e të dielave, ne vizitonim shpesh qytete të ndryshme

turistike. Po a mund të harrohet vallë Napoli, Roma, Firencia, Venecia, etj?

Kështu që, në orën nëntë e gjysmë të para dites, gjendeshim në stacionin hekurudhor të Athinës. Deri këtu na shoqëroi Shyqo, miku ynë, të cilin e falënderojmë nga zemra, për mikpritjen që na afroi. Treni, nisej në orën dhjetë. Jo vetëm Arbëri por edhe ne, u habitëm diçka. Ai ishte tepër i vogël. Me dy vagona gjithsej. Krejt ndryshe, jo vetëm nga trenat e Italisë, që shquhen për shpejtësi të madhe, por edhe nga ata të Shqipërisë, të cilët nuk udhëtonin pa pesë vagona të paktën. Treni për në Tripoli të sillte ndërmend trenat lokalë të Italisë. Veç kësaj pasagjerët ishin të paktë. Një djalosh pranë nesh, i cili siç mësuam ishte emigrant moldav. Një çift pleqsh të mbajtur. Një grua me dy fëmijë. Në fund të vagonit disa shkollarë, ndoshta gjimnazistë, që flisnin e qeshnin me zë të lartë.

Bregdeti athinjot nisi të çfaqë magjinë e saj. Deri në kanalën e Korinthit e njëjta rrugë. Veçse kësaj here nuk udhëtonim natën, por ditën dhe me tren. Harmoninë e kaltërt të detit, që hera-herës bëhej blu papritur e cënuan një numër i madh rezervuaresh të përmasave të ndryshme. Me siguri ndonjë rafineri nafte. U çudita pak pse dija që Greqia, ndryshe nga vendi ynë nuk është e pasur as me burime nafte, as me minerale. Atë e mban bregdeti, turizmi.

Kalimi i ngadaltë përmbi kanal të Korinthit e gëzonte së tepërmi Arbërin. Të gjithë pasagjerët po e shihnin me nge. Ndërkohë që, në fund të tij lundronte qetë një anije. Ishte vërtetë diçka madhështore. Një shkëmb i madh i prerë në mes si prej dy thikash

gjigante. Gjatësia kilometroshe. Thellësia mbi njëqind metra. Gjerësia afro 40-50 këmbë. Arbëri, nuk po i shqitej dritares. Si zakonisht, majën e hundës së bukur e pati mbështetur mbi xham. Çifti i pleqve e ndiqnin buzagaz.

Diçka më vonë, Korintheta bashkë me detin, humbën. Kishim hyrë në Peloponez. Qyteti i Tripolit ndodhet thuajse në qendër të këtij gadishulli apo ishulli të njohur. Ndërkohë, peisazhi qe tjetërsuar. Të kaltërtën blunë e detit e kish zënë e blerta e gjelbërta. Plantacione të tëra agrumesh vinin radhë-radhë. Ndërsa shpejtësia e trenit sa vinte pakësohej. Terreni po bëhej gjithnjë e më malor. Ngadalë-ngadalë, udhëtimi po e humbiste gjallërinë e tij. Po bëhej monoton. Male të pa fund, ku më të rrallë si kurora vigane çfaqeshin kala të vjetra e madhështore.

Si një kal i gërdallë, treni gulçonte pa prerë. Kam konstatuar dhe tjetër herë se sistemi hekurudhor i Greqisë, ndryshe nga ai automobilistik është i prapambetur. Mbi të gjitha si dhe në Shqipëri, trenave iu mungon shpejtësia. Për të mos përmendur pastaj, zona të tëra si fjala vjen Epiri i Jugut, Eubeja, Kreta që nuk kanë të shtruar as edhe një kilometër udhë të hekurit.

Më së fundi arritëm në Tripoli. Nga stacioni i trenit, qyteti sado që krejt fushor m'u duk njësoj si pjesa kodrinore e Nikjes. Shtëpi të vogla, të vjetra që ndaheshin prej stacionit nga një rrugë me qarkullim të dendur automjetesh. Morëm në telefon Ledin, vajzën e dajës së Mirelës. Ajo erdhi menjëherë. Direkt nga puna. Veshur e tëra në të bardha, e hequr, ca simpatike.

Mendoni. Ledi, një ish studente e jurisprudencës në Shqipëri, zotëruese e disa gjuhëve të huaja, pat ardhur në këtë qytet të largët për t'u bërë kuzhinierë. Ledi, tok me të shoqin e saj Benin do t'i konsideroja, simbolin më tipik të sakrifikimit, vetmohimit të të riut intelektual shqiptar. Po ç'të bësh? Si jam shprehur edhe diku më lart, për fat të keq, ata nuk janë as të parët dhe as të fundit. Apo nuk bënte dy punë të ndryshme Ledi? Pra, realisht punonte me dy turne.

Sidoqoftë, fluturonte e tëra nga gëzimi. Në taksi, Arbërin e vuri në gjunjë dhe e puthte, e puthte me mall. Nuk di pse m'u dhimbs Ledi. Ndoshta nga që e kisha vlerësuar gjithnjë si vajzë të mprehtë, të zgjuar. Mbas pak minutash, arritëm në shtëpinë e saj. Dua të theksoj këtu, se qyteti i Tripolit, ndryshe nga periferia tanimë që tjetërsuar. Një qytet tipik grek që s'i kalonte të njëzet mijë banorët. Me rrugë e rrugica të drejta, ndërtesa me tri katër kate e të reja. Me rastin e vitit të ri qendrën e patën sajuar keq. Të gjitha pemët i kishin fashuar me të bardha, sikur të ishin ushtarë të plagosur, të sapo kthyer nga beteja. Ishte 30 dhjetor. Të nesërmen vonë, nata e vitit të ri. 1 janari i vitit 2000 që në prag.

-Leli, - iu drejtua gruas Ledi. – Sa t'iu përgatis drekën, ju freskohuni ca e, në se dëshironi bëni edhe dush. Mua do të më falni sepse më duhet të kthehem përsëri në punë. Mos u mërzitni se do i telefonoj Benit që të kthehet shpejt.

I shoqi i Ledit erdhi vërtet shpejt. Në mbrëmje na mirëseardhën edhe prindërit e tij. Po kështu edhe i vëllai Tani, një inxhinier emigrant. Kështu që u krijua një ambient jo thjesht krushnor, por mbi të gjitha

miqësor. Prindërit e Benit gjithashtu janë intelektualë. Bisedat qenë nga më të ndryshmet. Dhe jo më kot populli thotë, se gjuha vete atje ku dhembti therr. Puna, mbilodhja, trajtimi, marrdhëniet e sforcuara me vendasit, Atdheun u bënë temat kryesore të tavolinës. Ndonëse dy vëllezërit qenë përshtatur kënaqshëm në Tripoli, shpirtërisht nuk ndjeheshin të qetë. Beni ankohej gjithnjë prej pronarit të tij.

-Lëre pastaj, - tha ai, - është dhe arvanitas. Por nuk pranon ta pohojë prejardhjen e tij.

-Apo nuk kanë edhe monumentin e Kollokotronit këtu, - foli vëllai Tani që shtoi. - Mesa di unë edhe Kollokotroni ka qenë arvanitas

-Është e vërtetë, - ndërhyri Jorgo, babai i tyre. - Por çështja qëndron se këtu, nuk na duan ne shqiptarëve.

-Madje, na urrejnë, - ndërhyri Ledi që tashmë ishte kthyer nga puna. - Dhe kjo, sepse ne jemi jo vetëm më të zgjuar, por edhe më të ditur se këta.

Diskutimet u ndezën. Kryetëmë mbeteshin marrdhëniet mes grekërve dhe shqiptarëve. U prek egoizmi, shovinizmi i tyre. Megalidea. Çamëria e përgjakur. Pretendimet ndaj Shqipërisë së Jugut ose Epirit të Veriut. U bënë komente nga më të ndryshmet. Më fanatiku mbetej Tani. Ai deklaroi hapur se duhet patur kujdes për Shqipërinë e Jugut. Grekët janë të rrezikshëm. Nuk tërhiqen lehtë pa realizimin e pikësnyimeve të tyre.

-Vërtet që duhet patur kujdes, - u shpreh Jorgua që vazhdoi më tej. - Një punë të madhe antishqiptare për helenizimin e Jugut bën edhe kisha. Janullatusi

është dhëpër. Ne jemi vetë të besimit ortodoks. Por vënia në krye të kishës sonë të një prifti grek nuk është aspak e drejtë. Nuk është normale. Janullatusi po dëmton rëndë. Autoqefalia e kishës sonë ka marrë fund. Nuk kuptoj përse nuk e largojnë?! A thua nuk mund të gjendet dot një klerik shqiptar që mund ta zëvendësojë. Prej vitesh më ka shqetësuar ky fakt. Duhet nxituar që nesër të mos bëhet vonë. Jam i vjetër në moshë. Kam frikë se në Jugun tonë rrezikohet të përsëritet historia e “Autonomisë së Vorio Epirit”. Pastaj janë edhe shkollat greke. Ato po mbijnë si këpurdhat mbas shiut, jo vetëm në ato pak zona minoritare, por edhe më tej. Shteti Grek kështu ka vepruar në shekuj. Kisha dhe shkolla greke ia kanë bërë dhe synojnë përsëri t’ia bëjnë gropën Shqipërisë. Ja përse jam i shqetësuar unë.

Fjalët e Jorgos na e patën prerë gjuhën të gjithëve. Ai kishte folur hapët, troç. I vuri mirë pikat mbi i ...

-Ashtu është Jorgo. Ke plotësisht të drejtë, - ndërhyri e shoqja e tij Vasilika. -Janullatusi po i bën dëm të madh kishës sonë. Helmin e tij nuk e kupton dot gjithë njerëzia. Mirë e the: Ç’e duam. Ta heqim e të vëmë një kryepriest shqiptar...

-Nuk është kaq e thjeshtë kjo mama – tha Tani. –Jua thashë një herë. Grekët janë shumë të rrezikshëm. Provo ta heqësh Janullatusin, kur do të shohësh që brenda pak ditëve të gjithë shqiptarët që punojnë këtu në Greqi do t’i kthejnë mbrapsht në Shqipëri. Dhe kjo nuk është aq e lehtë. Ne, shqiptarëve na ka zënë halli i madh. Varfëria është e ligë. Me grekët na ka zënë rrota bishtin.

-Po edhe të na zënë frymën nuk duhet t’i lejojmë,

- foli përsëri Ledi.

Pasoi një heshtje e shkurtër, ku fjollat e tymit të cigareve u përplasën në tavanin e bardhë. Arbëri që ish bërë i tëri sy e veshë, dukej i përhumbur. Ishte përskuqur ca në fytyrë. Biseda u kthye te arvanitasit. Beni përmendi prap pronarin e tij. Këmbëngulte në origjininën e tij shqiptare paçka se nuk çfaqej. Bile shtoi se dinte dhe një çikë në shqip.

-Kështu mendoj edhe unë, - tha Jorgo. – Pasi sa herë shkëmbehem me babanë e tij, ai gjithmonë më përshëndet shqip.

-Unë s`e kam aq të qartë këtë punën e arvanitasve, - foli Tani. – Po dua të them diçka që më ka ndodhur në Athinë, kur kam vizituar muzeun e Marko Boçarit. Cic eroni u paraqit si pinjoll i fisit të tij. Tip nipi, a stërnipi si i bie. Ai nuk e përmendi asnjë herë gjatë shpjegimit fjalën arvanitas. Ulte e ngrinte se Marko Boçari kishte luftuar aq shumë për Greqinë. Ulte e ngrinte se është një hero i saj.

-Po ndonjë fotokopje të fjalorit shqip-frëngjisht të Boçarit, a e pe të ekspozuar në muze? – pyeta unë.

-Jo ç`ne, - u përgjigj ai. – Ende kam të fiksuar në mendje stilografin, unazën e tij. Por ndonjë fjalor shqip-frëngjisht nuk pashë.

-Marko Boçari, - thashë unë, - këtë fjalor e pati shkruar në ishullin e Korfuzit, pas ngulmimit të mikut të tij, francezit Pukëvil, që në ato vite shërbente si konsull pranë Ali Pashë Tepelenës.

-Interesante kjo, - tha Jorgo.

-Posi, - thashë unë dhe vazhdova. – Origjinali i këtij fjalori ruhet edhe sot e kësaj dite si dokument i

rrallë, në Bibliotekën Kombëtare të Parisit. Ai është shkruar në dy gjuhë. Në shqip dhe në frëngjisht. Boçari e njihnte frëngjishten pasi kishte qenë pjesëmarrës i një garnizoni shqiptarësh, të cilët patën luftuar në Francë. Veç dua të them se Marko Boçari nuk ka qenë arvanitas. Ai ishte thjesht shqiptar i besimit ortodoks nga krahina e Sulit, që faktikisht ishte Malësia e Çamërisë. Kurse Kollokotroni, Mijauli, Andruçi, Bubulina, e të tjerë komandantë të shquar të luftës për pavarësinë e Greqisë, me të vërtetë janë arvanitas njësoj si edhe *arbëreshët* e Italisë, që gjithashtu janë shpërngulur prej Shqipërisë dhe Epirit si para dhe pas periudhës së Skënderbeut.

-Deri në Kallamata, poshtë Spartës së njohur, pra gati në fund të Peloponezit, ka fshatra arvanitase që flasin ende shqip, - tha Beni, i shoqi i Ledit.

-Kurse unë kam lexuar – tha Ledi, - se ata në Greqi janë mbi 200.000 vetë.

-Tamam, - tha Tani. – Vetëm Athina ka aq shumë arvanitas.

Mesa duket duhet të ishte përgatitur darka, përderisa u ftuam të uleshim në tryezë. Kaloi, Arbëri, Mirela, e pas tyre unë. U ulën gjithashtu edhe prindërit e Benit, tok me të vëllanë. Ledi qëndroi pranë kushërirës së parë.

-Atëherë gëzuar e mirë se na erdhët, - uroi Jorgua që ishte ngritur në këmbë.

-Gëzuar, gëzuar, - thamë të gjithë.

Hareja e asaj darke të këndshme pasqyrohej aq bukur mes të qeshurave të shpeshta që thyheshin, reflektoheshin nëpër qelqet e gotave apo rakojaeve.

NATA E VITIT TË RI

Të nesërmen në mëngjes, rreth orës dhjetë, Tani na pati ftuar për një kafe tek vendi ku punonte, që ndodhej prapa monumentit të Kollokotronit. Miqësia, vëllamëria e tij luftarake me Ali Farmaqin, një tjetër arvaniats i Greqisë, por i besimit musliman është më se e njohur. Këta kapedanë të mëdhenj luftuan përkrah njëri-tjetrit kundër osmanëve, në fortësën e Mesalongjit më 1808. Kollokotroni dhe Ali Farmaqi synonin një shtet shqiptaro-grek, ku të respektoheshin me rigorozitet të gjitha të drejtat e të dy kombësive.

Ngaqë në lokal kishte shumë njerëz, ne u ulëm jashtë, Unë, Beni, Elidoni (i vëllai i Ledit) dhe Arbëri.

Gratë nuk erdhën pasi do përgatiteshin për natën e vitit të ri. Do shkonim në një lokal, jashtë qytetit të Tripolit. Për të na përshëndetur, erdhi edhe Mirela, e shoqja e Tanit, e cila punonte si banakiere në të njëjtin lokal. Kafetë na i solli vetë Tani. Arbëri mori një limonatë. Kafeja seç kishte një aromë të veçantë. Po më shijonte së tepërmi. E shoqërova më një cigare. Monumenti madhështor i Kollokotronit, sa i Skënderbeut në Tiranë, më bënte të mendoja për arvanitasit. Ja ndonjë fakt rreth jetës së tyre:

Në numrin e 25 janar-shkurtit 1993, arvanitasit Kristo Papadhopulli, i ka dërguar një letër revistës Besa, organ i Lidhjes Arvanitase të Greqisë, ku mes të tjerash shkruan. “Jam edhe unë si shumë të tjerë arvanitas. Ndjej dëshirën të shpreh thjesht krenarinë për rrënjët dhe prejardhjen time. Sot, arvanitasit nuk egzistojnë në historinë zyrtare greke. Për mua, kjo do të thotë se ne nuk kemi dhënë për këtë vend. Dikush më shtyn të them se nuk jam arvanitas. Të mohoj origjinën shqiptare. Të harroj Kollokotronin, Bubulimën e shumë të tjerë që kanë çliruar Greqinë”...

Studiuesi kosovar Shkëlzen Raça, në librin e tij “Marrëdhëniet shqiptaro-greke, 1829-1881” faqe 36, ndër të tjera thekson: “Në dy betejat e njohura të Naplios dhe të Monenvasmës flota e hidriotëve dhe Speciotëve, i shkaktoi humbje të mëdha marinës luftarake osmane. Për guximin e madh në betejat e sipërpërmendura, dallohet Bubulina, e cila ju dha shembull bashkatdhetarëve të saj arvanitas se si duhet luftuar. Tradicionalisht të lidhur me detin, hidriotët dhe speciotët e filluan konfliktin me Portën me 175 anije,

që esencialisht përbënin boshtin qendror të rezistencës në viset ujore të Greqisë”... Në faqen 38, zoti Raça, na jep një tjetër të dhënë interesante. Ja, si shprehet ai: “...Gjatë periudhës së fundit të fazës së parë të revolucionit grek dhe deri në vitin 1829, shumë shqiptarë të besimit mysliman, që jo rastësisht u gjendën në Greqi morën pjesë aktive në kryengritje. Kështu gjatë betejave të ndryshme u dallua Mustafa Gega, i cili luftoi krah për krah me Andrucin dhe mori pjesë në mbrojtjen e Akropolit. Në lufta shquhen edhe shqiptarë të tjerë si Avdi Gega, Bajram Lapi, Osman Shumani, etj...

Por, avantasit nuk njihen vetëm si luftëtarë të zot. Tok me pushkën, ata, kanë ditur të përdorin edhe penën. Këtu nuk duam të përmendim vetëm intelektualët e sotëm arvanitasit, të cilët janë mbledhur e punojnë rreth “Lidhjes arvanitase të Greqisë”. (Me këtë rast, i bëjmë homazh të ndjerit Aristidh Kolia, ish kryetar i Lidhjes që ndërroi jetë në muajt e fundit të vitit 2000). Dëshirojmë të përqendrohemi tek arvanitasi i madh Anastas Kullurjoti prej Salaminës, i cili botoi edhe gazetën prestigjioze “Zëri i Shqipërisë” (29.9. 1879 - 23.8.1880, Athinë). Pa dyshim, ai është njëri nga burrat e rrallë të diasporës që do të luftonte krahpërkrah me rilindasit e tyre për propagandimin dhe mbrojtjen e kauzës kombëtare, gjatë periudhës së lavdishme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Anastas Kullurjoti ishte ai që pati guximin të thotë të vërtetën dhe t`u bënte apel subjekteve zyrtare greke, për mirëkuptim ndaj fqinjëve dhe luftës së tyre të drejtë për çlirim kombëtar”.

Arvanitasit, janë edhe nikoqirë të mirë. Ja, si i përshkuan ata në vitin 1935 shkrimtari Dhimitër Cango: “Në Lutraki, pranë Korinthit, ka shumë shqiptarë. Ata, janë më të mirët banorë të qytetit, si nga pikëpamja e gjendjes materiale, ashtu edhe shoqërore... Pritjet e tyre bujare, nuk ndryshojnë aspak, nga ato të shqiptarëve të jugut. Cigare, gliko (reçel me ujë të ftohtë), raki ose konjak dhe në fund kafeja tradicionale... Ata më thanë se janë abër, jo grekër dhe, se në shtëpinë e tyre flasin vetëm shqipen”.

...Por, sa janë këta shqiptarë në Greqi, - vazhdon shkrimtari Dhimitër Cango. Përgjigjen e kësaj pyetje, e jep duke iu referuar librit “Çështja Shqiptare”, e botuar në Paris më 1920: Kolonitë shqiptare janë të shumta në Greqi. Pa llogaritur krahinat që iu shkëputën Shqipërisë pas luftës Ballkanike, elementi shqiptar përbën një të shtatën e gjithë popullsisë Greke.

Lokali ku do ta kalonim natën e vitit të ri ishte i madh e me një parking të madh që mbante shumë makina. Quhej “Oas”. Vendi ynë që caktuar në njërin prej katër cepave të tij. Më pëlqente ky kënd. E shihja si një llozhë, nga ku do të përcillja këndshëm ndrimin e viteve, shekujve, mijvjeçarëve. Në të vërtetë do të përjetonim diçka të veçantë. Ishim gjithsej nëntë vetë: Jorgo, Vasilika, Ledi, Beni, Tani me të shoqen (Mirelën), unë, Mirela dhe Arbëri.

Ora 22 e tridhjetë minuta. Po afronte, çasti i shënuar. Mbeteshin vetëm 90 minuta sa një ndeshje

futbolli. Lokali qe plot me njerëz të moshave të ndryshme. Mbizotëronin të rinjtë. Më pak të moshuar. Vogëlushët si ata kecërit çamarokë, nuk zinin vend në karrige. Ata njerëz, më shumë qenë të mbajtur se sa të bukur. E natyrisht, kjo vlente edhe për femrat. Mes tyre, gratë tona binin në sy. Po përse atëherë grekët, njësoj si edhe spanjollët kanë emër për hijeshi. Mos ndoshta, ky opinion iu përket mesdhetarëve-bregdetasve! Kurse Tripoli ndodhet mes malesh, pothuajse në zemër të Peloponezitet. Mundet që kjo arsye të jetë e mjaftueshme për të justifikuar, në përgjithësi, fytyrat provinciale të gazmorëve.

Më bëri përshtypje së tepërmi edhe një tjetër fakt. Orkestra. Muzikantët. Loznin e këndonin vetëm muzikë greke. Asnjë melodi apo këngë e huaj. Vërtetë për t'u habitur. Në realitet, ne shqiptarët jemi më kozmopolitë, më properëndimorë se grekërit. Ose, thënë ndryshe, grekërit janë shumë nacionalistë. Lëri pastaj vallet. Të gjitha popullore. Njësoj si ne shqiptarët, që në kohën e Enver Hoxhës ia merrnim dhe ia kthenim popullorçe. Sado që buzuqet mbeten origjinalë, me kalimin e kohës edhe ato, sikur po bëheshin monotone.

-More Beni, - më foli Jorgua aty pranë. – Grekët, si valle të tyre kombëtare kanë “Çamikon” që në realitet është thjesht valle çame!

-Veçse ne, - tha Vasilika, - e hedhim shumë më bukur. Asnjëri prej grekërve deri tani, nuk e ka realizuar dot kërcimin mbi bark.

-Ai detaj kërkon profesionalizëm të lartë, - u shpreh Beni që shtoi. – Pastaj nuk është vetëm kjo valle

që grekërit kanë marrë nga ne. Është dhe fustanella. Faik Konica në një shkrim të tij e argumenton bukur këtë të vërtetë.

-Këtë e kam dëgjuar edhe unë,- u shpreh Elidoni, vëllai i Ledit që me hijeshinë e tij, pat tërhequr vëmendjen e grekërve.

Minutë pas minute, koha tretej. Çasti emocional sa vinte bëhej edhe më i prekshëm. Arbëri nuk po i ndahej Jorgos. Qenë bërë miq e shokë të ngushtë. Hante me qejf. Ushqimi qe i mirë.

-Të bëjmë gati shishen e shampanjës, - tha Tani.
- Pas dy minutash hyn viti i ri.

-Sa qejf, babi, - u shpreh Arbëri dhe sytë e bukur i ndrinë plot shkëlqim.

Jorgua e përkëdheli lehtë në flokë. Befas, dritat u fikën. Ngado shpërthyen britma gëzimi. Pati edhe ndonjë fërshëllimë. Dritat u ndezën. Tani hapi shishen e shampanjës. Ajo shkumbëzoi duke u derdhur mbi tavolinë. Gotat u mbushën nga pak. Si me urdhër të gjithë ishin ngritur në këmbë. Kurse Arbëri kërcente në vend nga gëzimi.

-Gëzuar, gëzuar, gëzuar...

S'ka gjë më të bukur se sa kur njerëzit gëzojnë. Sikur bëhen më të mirë, më të bukur. Lumturia zbut shpirtrat. Zemrës i fal horizont të paanë. Afron njerëzit. Vura re se nga tavolina fqinje, na ndiqte një djalë i ri me syze. Madje jo vetëm që përshëndeti, por bëri edhe me gotë gëzuar. Në këtë mënyre reagoi edhe unë.

Ndërkaq, atmosfera e lokalit ishte elektrizuar. Altoparlantët gati-gati çirreshin. Këngëtarja e grupit muzikor, më kot përpiqej të krijonte emocion. Ishin

boshatisur disa tavolina. Mbi to kërcenin si fëmijët e po ashtu të rinjtë, të dashruarit. Muzika, gjithashtu kishte ndryshuar. Lozej një pjesë e huaj me plot ritëm. Për të vallzuar u ngritëm edhe ne. Jorgo me Vasilikën, unë me Mirelën, Beni me Ledin dhe Tani me Mirelën tjetër. Në tavolinë mbetën vetëm Elidoni me Arbërin. Pas disa minutash i bëra shenjë Elidonit që të afrohej. Qesh dirsur ca. Lash Mirelën të vazhdonte me kushëririn e saj dhe eca drejt tavolinës. Atje ishin kthyer Jorgo me Vasilikën. Arbëri poqi gotën me mua dhe Jorgon dhe tha gëzuar. Piu një gllënkë verë të cilën e shoqëroi me pak mish. Unë ndeza një cigare. Në tavolinë u kthye dhe Mirela. Ndërsa Elidoni kërcente me një greke.

-Beni, - më foli gruaja. – Fqinji grek seç kërkon të thotë!

Ktheva prej tij. Djaloshi me syze të holla që më pat përshëndetur pak më parë, tha:

-Më quajnë Kosta.

-Arben, - thashë unë.

I dhamë dorën njëri-tjetrit. Kërkova të fliste ngadalë, se ndryshe nuk mund ta kuptoja mirë. Më tha se kishte studjuar për histori. Më pëlqeu kjo. Gjeta një njeri, me të cilin mund të shkëmbeja ndonjë mendim.

-Gëzuar, - thashë unë.

-Gëzuar, - tha ai që gotën e takoi edhe me të Mirelës.

Shpejt vura re se greku i ri e njihte historinë në përgjithësi. Ajo ç'ka më bëri më shumë përshtypje tek ai ishte kënvështrimi i veçantë. Marrëdhëniet e vjetra greko-shqiptare iu bëri një interpretim realist. Iu

referua më krenari të përmbajtur dijetarëve të antikitetit helen. Trajtoi më gjerë rezistencën e përbashkët në shekuj shqiptaro-greke, kundër Perandorisë Osmane. Përmendi edhe kryengritjet e Epirit në vitin 1481, të cilat i pati udhëhequr Gjon Kastrioti, i biri i Skënderbeut. Historiani i ri grek foli edhe për Ali Pashë Tepelenën. Vlerësoi si serioz kontributin e arvanitasve gjatë revolucionit për pavarësinë e Greqisë. Tha se ata ende flasin shqip. Madje përmendi edhe Çamërinë. Këtu e uli ca zërin. Ngriti sytë e hodhi vështrimin rreth e qark. Por njerëzit ishin të pavëmendshëm. Ata argëtoheshin. Pastaj festa i pati trullosur diçka. Në fund të fjalës, Kosta zuri me gojë edhe bashkëpunimin e komunistëve shqiptarë me ata grekë.

Gjykimi i tij më tërhoqi. M'u duk i qetë, ndonëse i ftohtë. Larg nacionalizmit shoven. Natyrisht, diçka thashë edhe unë. Fola për heronjtë e lashtësisë greke. Përmenda kulturën, letërsinë e famshme helene. Si mund të rrija pa kujtuar Homerin? Kostës i bëhej qejf, i ndrinin sytë. Përmenda edhe disa shkrimtarë bashkëkohorë grekë, si nobelistët Seferisin, Kafazisin, Recosinin, Kazanzaqin e të tjerë. Po ashtu fola edhe për interpretimin e figurës së Uliksit (Odisesë) nga aktori i famshëm kosovar Bekim Femi. Kosta shtoi se partnerja e tij në rolin e Penelopës ka qenë aktorja e madhe greke Irena Papas. Gjithashtu, thashë diçka edhe për sportin, për futbollistët shqiptarë që lozin në kampionatin grek. Historiani i ri u shpreh se nuk para ishte tifoz, megjithkëtë Strakoshën dhe Bledar Kolën i njihte. I ofrova një cigare por nuk e pinte. E ndeza vetë.

Festa pat arritur pikun e saj. Viti i ri 2000 si foshnje sapo pat nisur të belbëzonte. Kërcimtarët e tavolinave qenë shumuar. Sigurisht që në këtë situatë të pazakontë, njëkohësisht të pranueshme ndikonte edhe të pirët. Kërcimi përmbi tavolina, shpejt u shndrrua në një garë. Në këtë çfaqje u bënë protagoniste edhe Ledi me Mirelën., të shoqen e Tanit. Tavolinën nxitimthi ua përgatiti Elidoni. Shqiptaret tashmë, qenë bërë dy solistet kryesore. Dashur pa dashur duartrokitjeve tona pasionante iu bashkuan edhe disa tavolina fqinje. Ndërsa tavolina e Kostës, historianit të ri grek, si edhe ne gjendesh më këmbë. Ledi me Mirelën kërcenin aq bukur sikur të ishin valltare profesioniste. Kështu, pa u ndjerë, mes këngëve e valleve po shkohej drejt agimit të parë të vitit të ri 2000.

SËRISH NË ATHINË

I vetmi merak që më mbeti, gjatë vizitës së paharruar në Tripoli që Sparta. Nuk m'u krijua mundësia të vizitoja rrënojat e qytetit të famshëm helen, që aq shumë pati rivalizuar dhe luftuar me Athinën antike. Sparta ndodhet në Jug të Tripolit rreth 1 orë larg me urban. Më pranë ka qytetin e Kallamatës me afro 50.000 banorë, i dyti për nga madhësia në Peloponez pas Patrës.

Këtë herë udhëtimin për në Athinë e bëmë me autobus. Do të ishte një marrëzi e vërtetë, nëse do të riktheheshim sërish me tren. Mendo, as Arbëri nuk u ndie që aq shumë i pëlqen këto lloj udhëtimesh. Në

këtë mënyrë shmangëm monotoninë e përjetuar pak ditë më parë, si dhe shpresonim në krijimin e ndonjë variacioni të ri turistik që do të mund të na krijonte autostrada. Por fatkeqësisht qemë zhgënjyer. Përfitimi konsistoi vetëm në kohë. Shpejtësia e udhëtimit qe e madhe.

Është e çuditshme. Peloponezi sado që laget gjithandej nga deti shquhet për terrenin e tij malor, alpin. Riviera e tij mbetet malore. Pikërisht kjo lloj larmie natyrore, kjo mpleksje mahnitëse e relievit është arsyeja që shtyu emigrantët e parë shqiptarë, (arvanitasit e sotëm) ta quajnë atë me fjalën “More”, e cila shpjegon bukurinë e veçantë të këtij vendi.

Në Athinë arritëm në muzg. Prej stacionit i telefonova Skënder Balanit, një kushëriri të afërt të Mirelës, me profesion inxhinier, por që këtu punon në një punishte të madhe mermeri. Sado që jetonte prej 8 vitesh tok me familjen në Athinë, unë me të isha takuar verën e shkuar. Bashkë me të vëllanë e tij Idrizin, më patën bërë një vizitë në shtëpinë e re që porsa e kisha ndërtuar pranë kopshtit botanik. Skënderi është djalë i mençur, i pa fjalë. Kujtoj se rreth konceptit të Atdheut patëm edhe një debat të vogël në Athinë. Skënderi është partizan i idesë, se Atdheu fillon nga ekonomia. Ndërsa unë mendoj ndryshe. Them se ai fillon tek zemra. Vallë cili ka të drejtë në këtë jetë kaq të vështirë, kaq të rëndë?

Në shtëpinë e Skënderit qëlloi të na shpinte sërisht një taksist arvanitas. Ai fliste shumë pak shqip. I thashë Skënderit ta pyeste nëse e njihte Aristidh Koljën, emrin e të cilit pashë të përgohej edhe nëpër udhët e Athinës. Shoferi jo vetëm që e njihte, por përmendi edhe

mbrojtjen mbresëlënëse që Kolja i pat bërë Kosovës nëpër stacione të ndryshme televizive greke. Arvanitasi u shpreh me admirim për të. Moza e shoqja e Skënderit na priti buzagaz. Ata kanë dy djem të edukuar, shumë të mirë. Në shkollë janë të shkëlqyer. Me ta Arbëri u miqësua menjëherë. Apo nuk na çuan qysh në mbrëmjen e parë në “Gudis”, një kënd modern lodrash i vendosur në katet e poshtme të një gradaçele në mes të Athinës. U kënaqën jo vetëm fëmijët por edhe ne. Darkuam atje. Ishte me të vërtetë këndshëm. Madje, për shkak të ajrit të kondicionuar bënte vapë. Fëmijët u lehtësuan ca. Loznin vetëm me kanatjere.

Kur u kthyem në shtëpi njohëm edhe vëllanë e Mozës, që bashkjetonte me një emigrante ukrainase. Ajo ishte një vajzë e gjatë, bjonde, e sjellshme. Më pas erdhi edhe Bashkimi baxhanaku i vëllait të Skënderit. Këmbën e majtë e kishte të dëmtuar rëndë në punë. Çalonte ndjeshëm. Më erdhi keq për të. Bashkimi ishte një tip babaxhani, me një humor të theksuar. Tregonte natyrshëm batuta të rralla. E bëri akoma më të këndshëm ambjentin. Po kënaqeshim. Po çlodheshim. Moza qeshte vazhdimisht. Ndërsa Skënderi si gjithnjë fliste pak. Po kalonim me të vërtetë një mbrëmje të rrallë. Ora si pa u ndjerë pat lënë pas mesnatën. Kuptohej se ata të gjithë ishin të kënaqur me jetën që bënin. Jetonin prej 10 vjetësh aty. Qenë ambjentuar. Banonin nëpër apartamente komode, punonin të tërë. Më vinte mirë për këtë.

-Mua do të më falni, - tha Skënderi. – Më duhet të shtrihem. Nesër në mëngjes ngrihem shumë shpejt.

-Patjetër Skënder, - u shpreh Mirela. – Bile më

vjen keq që të mbajtëm kaq gjatë.

Mes humorit e mirëkuptimit të heshtur u ngritëm të gjithë. U përshëndetëm me radhë. Kur u përqaftuam, Bashkimi më tha se nesër në mëngjes do të vinte përsëri. Meqë vazhdonte të ishte me raport, paraditen do na e kushtonte neve. Me veturën e tij do shëtisnim nga të mundej.

-Ndërsa nesër në darkë – tha, - jeni të lutur të na urdhëroni. – Gruas do i bëhet qejfi shumë. Ajo i ka njohur prindërit tuaj dhe ruan respekt për ta.

-Faleminderit, faleminderit, - përsëriti Mirela.

-Natën e mirë, natën e mirë.

-Mirupafshim, - tha Bashkimi.

Dera u mbyll. Kur u kthyem në kuzhinë, vura re se Arbërin dhe djalin e vogël të Skënderit e pati zënë gjumi. Moza përgatiti shtretërit shpejt e shpejt. Ishim vërtetë të kënaqur, veçse të lodhur. Gjumi na zuri menjëherë.

Të dalurit me Bashkimin do të mbetet si një ndër kujtimet më të bukura të vizitës sonë dy javore në Greqi. Na çoi në një pjesë të panjohur e krejtësisht të re të bregdetit athinjot. Na u dha rasti të shihnim atë lagje të Athinës që njihet me emrin e Varkizës. Pikërisht këtu, në fund të luftës së 2-të Botërore është nënshkruar armëpushimi mes EAM dhe EDA-sit, që shënon edhe fillimin e fundit të luftës civile mes forcave ushtarake të majta e të djathta greke. Duhet të përmend këtu, pozicionet e kundërta të tyre ndaj çështjes çame. EAMI njihet për një qëndrim më të kujdesshëm ndaj çamërve.

Ndërsa nacionalizmi shoven i EDAS polli edhe vetë Napoleon Zervën.

Të dalurit me Bashkimin do ta sillnim ndër mend edhe për një fakt tjetër interesant. Ai na shoqëroi tek një vilë e madhe, e bukur e ndërtuar në formën e një vapori të ngritur buzë detit nga njëri prej njerëzve më të pasur të Greqisë. Në të punonte si roje vëllai i madh i Bashkimit. Ai na gostiti me kafe Turke si në Shqipëri.

Në pragmuzg u kthyem në shtëpi. Liza, e shoqja e Bashkimit më ka lënë mbresë të veçantë. Megjithëse paksa e sëmurë, ajo bëri ç'ishte e mundur për të na kënaqur. Kaluam sërish një mbrëmje të paharruar. Fotot qenë të shumta. Veç dua të përmend këtu edhe një fakt paksa komik. Arbëri nuk u afrua me vajzën e Bashkimit. Lozte vetëm me djemtë e Skënderit. Kjo, sepse çunat loznin vetëm me çuna kurse gocat vetëm me goca...

Në mbrëmje vonë, Skënderi na shoqëroi edhe tek disa kushërinj të tjerë të Mirelës, të cilët nuk i kisha njohur më parë. Dija vetëm se gjatë kohës së diktaturës në Shqipëri patën vuajtur. Qenë 10 fëmijë. Tani që të gjithë punojnë e jetojnë si emigrantë në Greqi. Fqinj me Skënderin ishin 4 prej tyre, 2 motra dhe 2 vëllezër. Më shumë mes tyre më tërhoqi vëmendjen Ylli si dhe motra e madhe. Ai punonte prej vitesh në këtë zonë si furrëtar. Ylli vetëm buzëqeshte. Kur i thashë se për në Shqipëri do të ktheheshim nëpërmjet Çamërisë këmbënguli që të ktheheshim edhe në Filat ku prej vitesh punonte e jetonte familjarisht Agroni, i vëllai i tyre më i madh. Ne thamë se do të shkonim edhe atje. Ylli pa bërë zë nxorri celularin e u lidh menjëherë në

telefon me të vëllanë. Me Agronin foli edhe Mirela. Na ftoi për zemërsisht. Ne i dhamë fjalën se do të venim. Na dha në çast numrin e telefonit. Vendosi se do të dilte për të na pritur në Gumenicë.

Kur u ngritëm për të ikur, ata na përcollën deri jashtë që të gjithë. Para se të ndaheshim, edhe ne i ftuam që në rastin më të parë të ardhjes në Shqipëri, të vinin edhe tek ne në Tiranë. Shtëpia jonë gjendet lehtë. Ajo ndodhet fare pranë kopshtit botanik.

Nesër sërish do të ishim për udhë të gjatë. Çamëria na priste.

RIKTHIM NË ÇAMËRI

Udhëtimi nga Athina në Gumenicë niste herët në mëngjes. Në stacion shkuam gjysëm ore përpara. Bashkimi sërish na u gjend pranë. Makina e tij qe shndërruar në taksi. Na shoqëroi deri te salla e biletarisë. Para sporteleve njerëz të shumtë. Biletashitseve dukej se ende nuk u kishte dalë gjumi. Sportelistes tonë, një grua thatime me pamje fodulle ju hap goja para meje. Ish aq e pakulturuar, saqë harroi të vinte dorën përpara. Fryma e saj e rëndë më rrënqethi mishtë. Vetvetiu bëra një hap prapa. Pa dashur i shkela majën e këpucës një mesogruaje, e cila qëndronte në radhë pas meje.

-Pardon, - i thashë unë duke kërkuar ndjesë.

Gruaja kreu një lëvizje të lehtë të kokës pa reaguuar fare në fytyrë. Mos ndoshta e pata lënduar keqas në majat e gishtrinjve? Mimika e saj shrehte më tepër indiferencë sesa dhembje. Ishte tepër e mbajtur, ndonëse tek të pesëdhjetat. Sy me ngjyrë të papërcaktuar, ose më saktë një mpleksje mes së kaltrës dhe së blertës. Për mos thënë të ftohta qenë pa shprehje. Kur u ktheva për të ikur, pasi mora biletat i buzëqesha miqësisht. Gruaja reagoi e përmbajtur.

Dola. Bashkimi, Mirela dhe Arbëri, ndodheshin pranë urbanit. Atë e patën vënë në mes një numër i konsiderueshëm pasagjerësh. Shumica e tyre të moshuar. Si të përhumbur, si të dërrmuar. Ç'farë ndikonte në gjendjen e tyre?! Mosha, pagjumësia apo diçka tjetër. Nuk e di pse m'u krujua ideja se ata me siguri ishin shqiptarë, ose thënë më saktë ishin çamër të krishterë. Vallë, ku do zbrisnin? Në Gumenicë, apo anembanë Çamërisë?! Ndërkohë, Bashkimi, foli:

-Mua, do të më falni. Më duhet të shoqëroj Lizën për në punë. Paraqitet në orën shtatë. Orarit nuk ke ç'i bën.

-Ashtu është, Bashkim, - thashë unë dhe e përqafova.

E falënderuam përsëri. Na pat nderuar së tepërmi. Nuk do t'ia harronim kurrë. I kujtova që kur të vinte në Tiranë të kthehesh tek ne patjetër. Buzëqeshi lehtë. Iku. Tanimë që zbardhur plotësisht. Dritat rrinin më kot ndezur. Shikova orën. Pa shtatë minuta shtatë. Shoferi hapi dyert. Njerëzit zunë të hipnin në urban, që thuajse u mbush i tëri. Kësaj radhe ndenjëset tona

qëlluan në mes, jo në fund të urbanit si nga Janina në Athinë. Autobusi u nis. Sytë e Arbërit ndrinë. Po i drejtoheshim Çamërisë. Mjaftonte kjo që emocioni të shndërrohej në ankth.

Kanali i Korinthit nuk kish se si mos të zgjonte sërish kërshtëri. Arbëri u shpreh me zë të lartë:

-Y... y y o babi! Në fund të kanalit po kalojnë dy anije të mëdha.

-Sa bukur, - tha Mirela.

Arbëri që ulur tok me një grua të moshuar, e cila kërshtërinë e tij e përcolli me dashamirësi. Madje i përkëdheli flokët. Mirela i buzëqeshi njerëzisht. Gruaja reagoi gjithashtu. Ndërkaq, para ndenjësës së saj ishte ulur grua me pamje të rëndë, së cilës në stacionin e Athinës i pata shkelur pa dashur majën e këpucës. Qëndronte në heshtje. E vetme.

Kur Kanali i Korinthit mbeti mbrapa, urbani u përgjum sërish. Apo nuk ishte një ditë e bukur me diell, që të shtynte të dremisje menjëherë. Deri në Patra, ku do të ngjiteshim në traget kishte goxha udhë. Arbëri mezi që priste të arrinte. Por jo vetëm për të, për të gjithë kalimi me traget përbënte një variacion të këndshëm.

Më së fundi arritëm. Këtë herë do udhëtonim ditën dhe jo natën. Ky fakt sikur e zhvlerësonte kërshtërinë tonë. Tek e fundit mungonte nata, dritat, hëna, yjet, romantika e tyre. Me sa dukej këtë ndjesi e përjetonte dhe Arbëri që i pati rënë entuziazmi. Apo nuk frynte një erë e fortë, që i prishte lehtas flokët.

Grave ju mbetën duart mbi kokë. Më kot mundoheshin të mbronin flokët. Ato plekseshin dhe shplekseshin pa pushim.

Pas tragetit me ndonjë përjashtim të rrallë, siç ish rasti i tabelës që tregonte drejtimin për në Mesalogji, ku tok me historinë greke ngrinin kokën edhe kapidanët shqiptarë rruga u bë tepër monotone. Mirela, anoi kokën për të dremitur. Për çudi, gjumi sikur kaploi edhe Arbërin, që ditën nuk para flë. Ndërsa unë mendoja në heshtje.

Kur u ndie afrimi i gjirit të Ambrakisë, buzë një liqeni të vogël, afërsisht sa i Janinës, shoferi vendosi të bënte një pushim. E pritëm me kënaqësi këtë ndalesë. Sa vura këmbën ndeza një cigare. Një kafene e rëndomtë dy katëshe na priste. Arbërin e tërhoqi një lisharëse fëmijësh aty pranë. Mirela e tërhoqi e shqetësuar. Në italisht i tha të mos largohet prej nesh. E folura e saj tërhoqi vëmendjen e të tjerëve. Sytë e mi u kryqëzuan me sytë e kaltërt në të blertë të gruas së rëndë. Për të kaluar në “tualet” hymë brenda në lokal. Dolëm jashtë. Dielli ngrohte mirë. U ulëm dhe porositëm nga një kafe. Arbëri kërkoi një hamburger. Porosia u bë në italisht. Pranë nesh, sytë e “veçantë” na ndiqnin me kujdes.

-Nuk di përse, por që në autobus s'më kanë pëlqyer ata sy, - u shpreh Mirela.

-Vërtet, - thashë unë. – Se si të ndjekin?!

Kafetë dhe hamburgeri, nuk vonuan. Arbëri dukej me oreks. Ndeza prapë një cigare.

-Në Greqi kafetë bëhen shumë të rënda, - tha Mirela e bezdisur prej kërshtërisë së tepruar të gruas

përballë.

Arbëri kërkoi një sprait. Edhe ai vetë, porosinë e bëri në italisht. Kamariert prej të qeshurës i shkuan buzët vesh më vesh. Gruaja e rëndë, më vështroi përsëri. Kur erdhi kamariert me spraitin e Arbërit paguam. Pasagjerët tek-tuk zunë të ngjiteshin në autobus. U ngritën. Zumë të ecejakeshim. Shoferi ende nuk po sinjalizonte me bori. Arbëri kërkoi ta shpinim te lisharsja. E lëkundnim me radhë. Njëherë unë, një herë Mirela. Kënaqësinë djalit ia ndërpreu boria. Lajmërimi për t'u kthyer në urban u bë. Pushimi pat mbaruar.

Pranë derës rastisëm me gruan e rëndë. Për xhentesë, pasi bëra të ngjiteshin në fillim Mirela dhe Arbëri, i lashë udhë të lirë "tipit" në fjalë. Për çudi, tek ngjitej ajo më foli në frëngjisht. Me shprehje euforike në mimikë. Ndonëse nuk e njoh këtë gjuhë, kuptova se, ajo nuk shprehej lirshëm. Po të bëja një krahasim, frëngjishtja e saj përngjante me greqishten time. Me gjithë këtë i lashë të kuptonte se mund të komunikonte me time shoqe. Mirela është lauruar në gjuhën frënge.

Ashtu u bë. Në shkëmbimin e fjalëve të para, gruaja e rëndë u tjetërsua menjëherë. Euforia fillestare ju ç'bë. U vu në vështirësi. Biseda e tyre ish bërë publike. Natyrisht, frëngjishtja e Mirelës është cilësore. Kurse ajo çalonte. Këtë fakt e kapën edhe pasagjerët e tjerë. Gruja që përsququr në fytyrë. Sikur ju zbeh ca autoriteti. Heshti për pak. Dhe jo vetëm kaq. Qëndrimi i saj ndaj nesh ndryshoi tërësisht. U bë e afërt, dashamirëse. Shprehte haptaz respekt, sado që Mirela

i kish thënë se ne ishim shqiptarë që patëm kaluar festën e vitit të ri nëpër Greqi.

-Ndërsa unë - tha gruaja, - jam punonjëse e Asfalisë. Në Gumenicë kam edhe prindërit.

Biseda me gruan tërhoqi vëmendjen në urban. Patjetër duhet ta njihnin. Gumenica është një qytet i vogël. I kalon apo nuk i kalon të dhjetëmijë banorët. Ndërkaq Mirela më pëshpëriti në shqip që të tregohesha i kujdesshëm.

-Se mos flet e diskuton me të për Çamërinë. Nuk kemi nge të përfundojmë sonte në Asfali, në polici

...

Peisazhin piktoresk të gjirit të Ambraskës e kaluam në heshtje. Vaporit Aulona (Vlora) i lënë pas dore, i vjetëruar mbetej ankoruar në një cep të portit. Qyteti i Artës, priste e përcillte me monumentin e Napoleon Zervës, që me dorën shtrirë drejt Shqipërisë kërcënonte paprerë. Ndërkohë, punonjësja e Asfalisë qe rigjallëruar. Fliste e fliste pa pushim me fqinjët e saj. Përmendte Alvaninë, Vorio-Epirin. Ndërsa Arbëri më shihte në sy me dëshirën për të më thënë diçka. Por, nuk po shprehej as në shqip dhe as në italisht. Siç dukej kishte kuptuar pozicionin e fqinjës së tij. Për ta lehtësuar nga ajo gjendje i lashë të kuptonte se patëm hyrë pikërisht në Çamëri. I shkëlqyen sytë menjëherë. Qe bërë një me xhamin e dritares. Unë, ndiqja me vëmendje çdo tabelë treguese që na parakalonin nxitimthi. "Filipjadha" lexova vrikthi.

-Arbër, - fola vetiu...

Ndjeja se po emocionohesha. Zura të lëvizja në ndenjësën time. Nuk po më zinte vendi vend. Arbëri

më kërkonte sytë. Mirela gjithashtu, ishte bërë vesh e sy. Sapo patëm lënë mënjanë Filipjadhën, në krahun e Arbërit mes kodrave me ullinj, vura re gërmadhat e para të fshatrave çame. Emocionet po më ktheheshin në dridhma. Zemra më rrihte fort. Cilat ishin ato rrënoja? Të Lurës, Strevjas, Ganzhës. Në Lurë, në tetor të 1912, çamërit, patën treguar trimëri të madhe. Jo vetëm që u rezistuan për disa ditë grekërve, por i shpartalluan keqas, duke iu kujtuar 1897.

Më erdhën ndërmend gërmadhat e fshatrave kosovare. Krimi kudo ka të njëjtën vulë – shkatërrimin. Dy muaj më parë, tok me Mirelën kisha qenë në Kosovë. Me librin “Krimi i fundshekullit” mora pjesë në panairin e parë të librit shqip në Prishtinë. Vizitua edhe Drenicën, Prekazin e lavdishëm të Adem Jasharit. Me predha tankesh e goditën shtëpinë e Jasharajve barbarët serb. E njëjta gjë kishte ndodhur njëqind vjet më parë edhe me Filipjadhën. Shtëpinë e atdhetarit të shquar çam Fuat Bej Frashëri, shovinistët grekë e patën djegur duke e goditur me predha. Atë e pat ngritur prapë i biri, Qemali që në Luftën e Dytë Botërore, si pasojë e njohjes së gjuhës gjermane shpëtoi nga vrasja në ishujt grekë mijëra çamë të internuar.

Në të dalë të Filipjadhës, pikërisht atje ku rruga krijon një degëzim të dyfishtë, duke marrë njëra për në Prevezë (18 km) tjetra për në Gumenicë e Filat, autobusi ndaloi. Zbriti një çift i ri dhe u ngjitën dy të vobektë, (nënë e bir) me siguri emigrantë. Gruas që mbante në dorë një bohçe të vogël i bëri vend punonjësja e Asfalisë. Ndërsa i biri, një djalosh i ri tek të njëzetat u ul në vendin e lirë para nesh. Ndoshta

ishin me dokumente të parregullta përderisa qenë aq të heshtur, te trembur. Punonjësa e Asfalisë hapi menjëherë bisedë me gruan në krah. Paçkah se hiqej dashmirëse, përçmimin nuk mundi ta fshihte krejtësisht. U ngjesh aq shumë pas dritares sa që kish rrezik të thyente xhamin. Nuk arrita të kuptoja se ç'farë i thoshte. Veçse profili i gruas së vobektë kish marrë ngjyrën e limonit. Djaloshi para nesh nuk dëgjohej. Një çast unë i fola në shqip. Ai, ndonëse kreu një lëvizje të befte të qafës nuk reagoi. Vazhdimisht heshte.

Tej në horizont, në një kodër që zhytej në thellësitë e detit u ravijëzua qyteti i bukur i Pargës, vendlindja e rilindëses së shquar Dora D'Istria (Elena Gjika). Nënë e bir kërkuan të zbrisnin. Në këtë mënyrë, i erdhi fundi edhe torturës së tyre. Ndërkohë, punonjësja e Asfalisë u kthye nga ne dhe i foli Mirelës me atë frëngjishten e saj çapra çupri.

-Ai, është qyteti i Pargës. Duhet ta vizitoni medoemos. Është një mrekulli e vërtetë.

Mirela i buzëqeshi nga halli dhe ktheu kokën majtas. Përtej dritares Parga, perla e Çamërisë që për nga bukuria ia shkon edhe Sarandës. Në horizontin e mjegullt, të përhimtë çfaqej si në tablotë e piktorit të talentuar himarjot Vangjel Gjikondi. Sa gjak çam patën derdhur kriminelët e Napoleon Zervës nëpër shkallët e qytetit të thepisur. Pargën do ta vizitonim paqjetër.

Po i afrohem Margëllëçit, ose përndryshe po hynim në Çamërinë Qëndrore. Rrënojat, gërmadhat e vendbanimeve çame në këtë zonë shumoheshin. Në këtë zonë, m'u riçfaqën imazhet e fshatrave të rrënuara kosovare. Kudo, krimi pret me të njëjtin teh. Pas lë

gërmadha dhe gjak. Ja, disa shifra mbi masakrat e andartëve grek në Çamëri (1944-1945). Të vrarë rreth 4000 burra, gra, fëmijë e pleq. Si pasojë e torturave, lodhjeve të pafundme, vdiqën afro 3000 të tjerë. Për të mos përmendur këtu, grabitjen e bagëtisë së imët, të trashë etj, etj.

Gumenica po bëhej gjithnjë më e afërt. Befas, u çfaq një tjetër tabelë treguese. Në të shkruhej “Grekohori”. Bëhet fjalë për fshatin e madh të Grikohorit, që njihet si një qendër e shquar e atdhetarizmit çam. Grekërit nuk u mjaftuan vetëm me krimet, masakrat që bënë në Çamëri. Ata ndryshuan rrënjësisht toponomastikën çame. Emrat shqiptarë i shndërruan në grekë, etj, etj.

-Grikohori, fshati i Xha Bidos, - foli me zë të ulët Mirela.

-Arbër, - fola unë që nuk m’u durua dot më. – Tabela që porsa kaloi mban emrin e fshatit të Fatjonit dhe Alenit, dy shokëve të tu të ngushtë.

-E pashë, e pashë, - u përgjigj po në shqip Arbëri.

-Më ka lënë porosi gruaja e Xha Bidos – vazhdoi Mirela, - që ti marr një grusht dhe nga toka e Gumenicës.

-Do ta marrim patjetër, mami, - tha Arbëri.

E folura, sikur na e lehtësoi diçka shpirtin. Pikërisht në këtë çast pasoi një e papritur e këndëshme. Dy ndenjese para nesh, një fqinji ynë flokëbardhë na foli në shqip.

-Kah Shqipëria jeni ju?

-Po, - u përgjigja unë dhe pyeta aty për aty. – Po

zotrote?

-U jam prej këtyre anëve, - u përgjigj plaku. –
Banoj në Gumenicë.

-Po emrin si e keni, - vazhdova unë?

-Taso, më thonë, - u përgjigj ai. Tërë kohën kam
qënë modhistër (rrobaqepës).

-E ç'fëmil keni? – ngava bisedë në dialektin çam
unë.

-Kam katër djelm. Të gjithë me fëmil.

Por Xha Tasua nuk do të flistë gjatë. Papritur,
tregimi i tij u ndërpre nga ndërhyrja nervoze e oficeres
së Asfalisë.

-Qirje Taso kseris polikali alvanika! – tha ajo.
(Zoti Taso ditke shumë mirë shqip!)

-Ne, ne, - pohoi plaku shkurt.

Vura re një detaj të dhimbshëm. E shoqja e xha
Tasos në krah e godiste të shoqin në brinjë në brryl.
Trembej. Dukej tepër i shqetësuar. I lënduar xha Taso
qëndroi. Ndërsa oficerja e Asfalisë, megjithëse
mundohej të hiqej e qetë e pati humbur toruan. Si tip
impulsive që ishte nuk po i zinin vend duart. Në mënyrë
instiktive, gishtërinjtë i mplekste, i shtrëngonte fort me
njëri-tjetrin. Atmosfera e autobusit sikur qe ngatërruar.
Nëpërmjet pasqyrës sytë e shoferit lëviznin të shqetësuar.
Heshtja u prish prej një të qeshure cinike që vinte pas
nesh. Ktheva kokën. Një plak i thatë, faqe parruar me
tri-katër dhëmbë çatall në gojë. Qenia e tij, nuk më pat
tërhequr aspak vëmendjen më parë. Diç tha në greqisht.
Në ligjëratën e tij përmendi tre herë turki, turki, turki...

-Ky - i thashë Mirelës, - me siguri do të jetë
ndonjë prej atyre refugjatëve të vjetër grekë, që ne vitet

1923-1926, pas luftës së Mustafa Qemalit, prej Anadollit i prunë në Çamëri. Aherë i shkëmbyen me një pjesë të çamërve myslimanë, të cilët i detyruan të venin në Turqi.

-Shëët – bëri Mirela. – Nuk e sheh se po na ndjek me bisht të syrit spiunia.

-Takëmi i këtyre – vazhdova unë duke bërë me kokë nga plaku, - si dhe andartët zervistë shfrytëzojnë edhe sot e kësaj dite pronat, shtëpitë e çamërve.

Kur hymë në Gumenicë, tej në horizont ngriheshin male të lartë. Punonjësja e Asfalisë e kthyer nga ne foli:

-Ja malet e Shqipërisë...

-Mirë që nuk tha ja tek është Vorio-Epiri – i fola Mirelës duke u munduar të shihja sa më mirë.

-Ç' tha yt shoq, ç' tha? – pyeti gjithë kërshtëri ajo.

-Thotë – ja ktheu buzë gaz Mirela, - se ju jeni tepër e mbajtur.

-Oh – bëri e vetëkënaqur oficerja e Asfalisë – unë kam djalin 28 vjeç.

Mirela e komplimentoi edhe një herë. Xha Tasoja sa u ngrit. Në dorë mbante një çantë të vogël. Përshëndeti me dorën e lirë dhe foli përsëri në shqip.

-Mirupafshim!

-Mirupafshim, mirupafshim, - thamë ne të tre në një gojë.

Kur zbritëm në stacionin e Gumenicës, oficerja e Asfalisë na përshëndeti po ashtu. Tek na dha dorën, para se të largohej, na rekomandoi të mos linim pa vizituar edhe Korfuzin.

-Është me të vërtetë një ishull i bukur!

NË GUMENICË

Në Gumenicë, në një nga qendrat më të rëndësishme (të Thesprotisë së hershme), vija për herë të dytë. Për herë të parë kam qenë me Çimin. Si edhe Janina, Gumenica është kryesisht qytet i ri. Shtrihet përgjatë bregdetit, përballë këndit fundor të ishullit të Korfuzit. Për nga madhësia dhe rëndësia në Epirin e Jugut, Gumenica mban vendin e katërt. Vjen pas Janinës, Artës dhe Prevezës. Siç kam thënë edhe më parë, qyteti mezi i kalon të 10.000 banorët. Zhvillimi, rritja lidhet ngushtë me detin, turizmin. Për nga bukuria Gumenica nuk shquhet. Natyrisht me Pargën s'mund të krahasohet kurrsesi. As me Prevezën, që mbetet një

qytet i mirëmbajtur, tipik shqiptar. Nëse do e pranësonim me Sarandën, vemë re, se kjo e fundit shquhet për bregun e thyer, por edhe pse është më e madhe. Saranda ndoshta ka diçka të përbashkët me Pargën e vogël. Të dy këto qytete që zbresin shkallë-shkallë në det, pasqyrohen aq bukur mbi sipërfaqen e tij. Sidoqoftë, Gumenica mbetet një qytet i këndshëm. Apo nuk është edhe porti më i rëndësishëm i Epirit të jugut. Për pasojë ka edhe një trafik të dendur traqetesh. Linjat detar e lidhin Gumenicën në Veri me Korfuzin e më tej me Sarandën. Në jug komunikon me Prevezën, Artën, ishujt e njohur të Leukadës, Qefalonisë e deri në kryeqendrën e Peloponezit, Patrën. Në këtë mënyrë Gumenica shihet si një port me prespektivë.

Përsa i takon tharmit shqiptar, si kudo në Greqi çfaqet i ndrydhur, i shtypur, i trembur. Nuk ka kënd të Gumenicës që të mos rastisësh çamërit e krishterë. Janë pronarë lokalesh, dyqanesh të mëdha e të vogla. Pra, kryesisht merren me punë tregëtie duke ndjekur traditën, gjurmët e të parëve. Çamërit i gjen edhe si shoferë, punëtorë, etj. Theksojmë se diktatura nacionaliste shovene greke ushtron presion të fortë mbi ta. Gumenicasit, nuk mund të përdorin gjuhën e nënës lirshëm nëpër ambientet publike. Kështu shqipja flitet nën zë.

Kishim gati një orë që ecejakeshim nëpër qytet. Me synimin që të blenim një film fotografik Shëtitëm përgjatë bregut të detit. Na pëlqente të bënim disa poza edhe në Gumenicë. Por duke qenë se ishte kohë dreke, të gjitha dyqanet ishin mbyllur. U kthyem sërish tek stacioni i autobusëve. Në lokalin ngjitur me të, që për

fat ishte hapur u ulëm për të ngrënë diçka. Banakierja, njëkohësisht edhe e zonja e dyqanit ishte prej fshatrave tona të Jugut. Qe martuar qysh në fillimet e demokracisë me pronarin e lokalit. Tepër e sjellshme veçanërisht me Arbërin. Në fund pasi paguam i kërkuam të na krijonte mundësinë për një lidhje telefonike me Filatin. Duhet të njoftonim për ardhjen tonë Agronin, kushëririn e Mirelës. Me të ishim marrë vesh nga Athina. E zonja e dyqanit na ndihmoi. Me Agronin u lidhëm menjëherë. Ai tha të prisnim tek stacioni përreth një gjysmë ore. Do të vinte për të na marrë shpejt. Pas kësaj u gjendëm të ulur në hollin e jashtëm të stacionit, i thashë Mirelës të mos lëviznin, sa të hidhesha në krahun tjetër të rrugës me qëllim që të blija filmin fotografik.

-Mirë - tha ajo. – Veç të lutem mos u vono.

Karshi stacionit ndodhej një kioskë e kuqe, njësoj si ato që shesin “Malboro” në krah të hotel “Dajtit” në Tiranë. Shitësja, një plakë trupmadhe e veshur me të zeza më pyeti në greqisht se ç`dëshiroja. Por unë bëra sikur nuk kuptoja dhe i fola vetëm në shqip. Parandjeva se ajo ishte çame. Paçka se nuk foli, mimika iu tërhoq menjëherë. Mori një shprehje të paqartë. Më bëri përshtypje mënyra se si e lidhte shaminë e zezë në kokë. Me një rrip qarkues në ballë. Dija se ky rrip përdorej prej grave çame të krishtera, një shenjë zie për vdekjen e heroit të tyre kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeut. Kurse burrat në festet (qeleshet) e tyre të bardha patën krijuar një si përrua, që të pranësonte idenë e varrit.

-Oj, nu, - këmbëngula këtë herë në dialektin çam.

-U kërkoj një film për aparatin. Dua të krej djalën

në fotografi.

Plaka sërish nuk foli. Veçse këtë herë tundi kokën duke lënë të nënkuptohej se nuk kishte.

- Po mirë aherë, -vazhdova unë. – Nuk më thua se ku ka ndonjë diqan këtej rrotull.

Plaka asnjë fjalë. Më bëri shenjë me dorë për të ecur përpara. La të kuptonte se dyqani ndodhej në atë drejtim. Pasi e falënderova eca. Më vinte keq që plaka nuk ish shprehur në shqip. Kaq shumë trembej vallë?! Për më tepër që unë isha i ardhur. Edhe lokalin në fjalë e gjeta të mbyllur. Si pak syresh ishte modern. Apostafat për shitje aparatësh filmikë. Gumenicasit zbatonin me përpikmëri orarin e pushimit. Eca edhe 100m më tej. Më kot. Kyçur të gjithë. U ktheva tek stacioni i trishtuar.

-Ç‘u bëre kështu mor burrë? – pyeti e shqetësuar Mirela.

-Nuk gjeta film – u përgjigja shkurt.

-Mos u mërzit – u shpreh ajo. – Do të gjejmë tek Agroni në Filat.

-Mirë, mirë, - thashë unë. – Veç do më pëlqente të kishim edhe prej Gumenicës ndonjë kujtim.

Disa metra më tej punëtori i stacionit, një mesoburrë topolak, i foli Arbërit në greqisht për të liruar udhën. Shtynte një karrocë metalike tip rrjete, në të cilën shiheshin gazeta të shumta. Mbi to disa letra postare. Arbëri u spostua mënjanë. Topolaku hyri në hollin e brendshëm të stacionit. Në këtë çast arritën urbanët e Prevezës dhe Artës. Prej tyre zbritën pak pasagjerë. U ulën gjithashtu edhe dy shoferat. Trupgjatë. Në moshë mesatare. Njëri prej tyre nxorri

prej xhepit paketën e pasi i dha një shokut, tymosi edhe vetë. Pranë tyre u afrua topolaku. Nuk ishin as edhe 3 metra larg nesh. Agroni sikur po vonohej. Mirela dukej e mërzitur. Kur për çudi, mes një çamçe të pastër foli topolaku. Befasia që e këndshme. Ai i pyeti shokët se si venin e në se ishin lodhur. Arbëri duke parë nga ne buzëqeshi. Sytë e Mirelës sikur më thonin: “Çamër përsëri”. Nuk di përse nxitova e nuk i lashë të flisnin më tej. Ndërhyra. E ndoshta gabova.

- Më falni – thashë. – Dua të shkoj në Filat, por nuk di se kur niset urbani. A mund të na thoni ju?

Heshtje e menjëhershme. Nuk po më përgjigjej as topolaku, as dy shoferët. U preka. U ngrita në këmbë dhe iu drejtova topolakut. Mirela më tërhoqi pa rënë në sy cepin e palltos.

- Më falni zotëri. Pak më parë ju dëgjova që folët shqip. Unë gjithashtu jam shqiptar. Gjuhën greke nuk e njoh. Më duhet të shkoj në Filat, por nuk di në çfarë ore niset urbani i linjës.

Këtë herë topolaku reagoi shkurt.

- Nukë di u, nukë di,...

U kthye prej miqve dhe zuri të fliste përsëri. Natyrisht këtë herë në greqisht. Mbeta në këmbë. Mirela më kujtoi të ulesha. Vura re se dy shoferët po më vështronin. M'u bë sikur shikimi i tyre shprehte veç kureshtjes, keqardhje. Bile njëri prej tyre, ngriti lehtë supet sikur donte të thoshte: "Mos u hatërmbet. Nuk është se s' duam të flasim, por s' kemi ç' të bëjmë... E keqja qëndron gjetiu...".

Tek po ndizja cigaren e dytë erdhi Agroni. Flokëgjatë dhe simpatik. Nuk e njihja, por kisha dëgjuar

për të. I martuar më një minoritare dhe kishte 3 fëmijë. Më të voglën vajzën, sa Arbëri në moshë. Tok u përshëndetëm e u përqaftuam, Agroni tha:

-Të nxitojmë pak. Në makinë po na pret, gruaja Anthulla.

-Ashtu – u shpreh Mirela që shtoi. – Unë e mbaj mend Anthullën, Agron.

Ai buzëqeshi. E mori Arbërin nga dora dhe bëri përpara. Ne e ndoqëm nga pas. Topolakut nuk mund të rrija pa i thënë dy fjalë në shqip. Rrinte me kurriz mbështetur në parvazin e sportelit. Ju gjenda pranë. I rashë lehtë me dorë në shpatullën e djathtë. Tek ktheu kokën i folta:

-Dhe fol shqip. Mos ki frikë se pse je shqiptar.

-Nukë di u. Nukë di... - reagoi sërish ai në dialektin çam.

Anthulla, e shoqja e Agronit na takoi me shumë përzemërsi. Shqipja e saj ishte me theks të veçantë. Pati sjellë me vete edhe vajzën e vogël, një bjonde e bukur me sy të shkruar. Ishte tepër e shkathët dhe e gëzuar. Fatkeqësisht, vogëlushja nuk fliste as edhe një fjalë shqip. Agroni jetonte prej 9 vjetësh si emigrant. E bija pati lindur këtej. Më bëri përshtypje edhe diçka tjetër. Targa e makinës së tij, një Golf në ngjyrë gri mbante ende inicialet e Shqipërisë. E pyeta se ç'punë bënte. Murator m'u përgjigj dhe dilte gjithnjë mirë.

-Këtu ka shumë që flasin shqip dhe më marrin në punë thuajse të gjithë.

-Shumë mirë – thashë unë.

-Faleminderit, - u shpreh Anthulla.

Dolëm në periferi të Gumenicës. Kudo blerim.

Pak nga pak terreni zuri të lartohej. Tutje nisën të çfaqeshin kodrat me ullinj. Mes tyre fshatrat çame. Pjesërisht gërmadha. Do të më mjaftonte kaq që të më kthehej sërish trishtimi. Punëtori topolak i stacionit të Gumenicës nuk më hiqej prej sysh. Ndërkohë m'u kujtua një ndodhi paksa e vjetër që kishte të bënte me Gumenicën. Ngjarja ka ndodhur në vitin 1991, kur unë bashkë me Çimin, nga Preveza vija për herë të parë këtu. Pasi kishim shëtitur anembanë qytetit, qemë ulur në një lokal buzë detit për të pirë nga një birra.

Ishte e diel. Ditë pushimi. Në berrari nuk kishte shumë njerëz. Dëgjohej vetëm greqisht. Kurse ne të dy, flisnim në gjuhën tonë. Qe dimër dhe bënte ftohtë. Prej erës së fortë, deti dallgëzonte. Sikur rënkonte. Kërkonte të nxirrte prej shpirtit të thellë, një maraz të madh. Kur papritur, para tavolinës sonë, behu një djalosh i ri, jo më shumë se 30 vjeçar. I veshur civil. I rreptë, i prerë në fytyrë. Duke u shprehur në greqisht u paraqit si punonjës i Astronomisë.

- Kam urdhër që ju të dy të vini me mua në polici.

U befasuam jo vetëm ne, por të gjithë klientët e atij lokali. Nuk pipëtinte më askush. Veçse ekspresi i kafesë që fërshëllente nervoz. Çimi e mblodhi veten shpejt dhe reagoi në greqisht.

- Përse?!? Çfarë të keqe kemi bërë?

Unë mundohesha të ruaja qetësinë. Tek e fundit me dokumenta ishim në rregull. Vizat ende s'na kishin mbaruar në pasaportë. Por polici civil nuk po na i kërkonte ato. Mes kufirit të një sekonde në njërën prej

këndeve të lokalit, syri mundi të kapte një burrë të moshuar. Rrinte i vetmuar në tavolinë. Mbi të qe vendosur një bastun. Dora e tij e rreshkur e plot me damarë, si e një bujku të regjur rrëshqiti mbi shkopin e drunjtë. Punonjësi i policisë, që gjithashtu e ndiqte plakun me bisht të syrit përsëdyti fjalën e thënë pak më parë. Këtë herë toni i tij shprehu hapur nuanca kërcënimi. Pikërisht në këtë çast ndodhi mrekullia. Plaku i ngritur në këmbë brifi fort në shqip.

-Lëri rehat ata more lanet! Jua shpure pas shpine atë çikë birrë.

Të shtangur ne qemë ngritur në këmbë. Si të hutuar, herë shihnim plakun e herë policin civil. Ky i fundit dridhej i tëri. Nuk kuptohej, nga e britura e plakut apo prej inatit. M'u bë se në lokal u pëshpërit në shqip.

- Zburru të thashë, - briti sërish plaku duke kërcënuar me shkopin e drunjtë në dorë. - Haramsëz... Gjakprishur.

Polici nuk e desh më veten. Qe bërë prush në fytyrë. U largua nxitimthi. Të gjithë në lokal mbetën gjuhëprerë. Veçse kamarieri dhe banakieri seç mëmërisnin kokë më kokë.

-Ikim – tha Çimi. – Ndryshe do të përfundojmë në polici.

Pranë gotave të pazbrazura të birrave lamë disa të holla. Çimi u drejtua nga dera. Unë rrija në këmbë si i ngrirë. Sytë ia kisha mbërthyer plakut që foli përsëri.

- Ç'prisni more djelm? Nxitoni! Në daçi të mos përfundoni në birucat e policisë. Për mua mos bëni hiç merak. S'më gjen gjë. Ai sojsëz është djali i vëllait tim. Ikni pra. Gjeni ndonjë taksi!

Iu afrova pranë. Dora ime u mbështet mbi damarët e tij të rreshkur. Ndjeva gjakun t'i rrihte. Prej gjoksit një si afsh i zjarrtë m'u ngrit lart në grykë. Ikëm. U larguam. Sytë e përлотur të atij plaku 80-vjeçar edhe sot e kësaj dite më ndjekin vazhdimisht nga pas. Qenë të kaltër, apo ngjyrimin në ato çaste ia kishte dhënë deti.

Megjithëse në të përpjetë e në kthesa Agroni nxitonte. Sikur kërkonin të na fshiheshin, shtëpizat gërmadha vraponin në kah të kundërt. Po i afroheshim lumit të Kalamait (Thiamit të vjetër). Gjatë shekujve, tok me ujët e tij sa e sa gjak çam pat rrjedhur. Pas kishte mbetur edhe Galbaqi, Vërsela etj. Tashmë udha ishte krejtësisht e përpjetë. Peisazhi i blertë të qetësonte ca shpirtin. Të sillte ndër mend udhën që të shpinte nga Fushë-Kruja për në Krujën e famshme të Gjergj Kastriotit. Gjarpëruese, e ngushtë, me plot pisha të larta në dy anët e saj. Më sipër masive ullinjsh. Po i afroheshim Filatit, qyteit luftëtar e martir.

FILATI, MES LEGJENDËS DHE HISTORISË

Filati, ndonëse për një shekull vuan në robëri, mbetet jo vetëm kryeqendra e Çamërisë Veriore, por edhe një ndër qytetet më liridashës të Epirit, Shqipërisë Jugore. Gjurmët e tij të para, i gjejmë përtej Thesprotisë Antike, me Elimët e lashtë, për të arritur pastaj tek ditët tona, me familjet e njohura të Sejkatëve, Dematëve, Dojakëve, etj. Veçse portreti i qytetit martir, do mbetet i paplotë, nëse nuk do të përmendnim edhe fshatrat e tij. Në fillim do të kujtonim Koskën e Muharrem Rrushitit, Isa Buletinit të Çamërisë, që zhvilloi mbi njëqind beteja kundër armiqve të Shqipërisë. Pastaj vijnë Spartari, Lopsi, Smartja, Picari,

Versela, Galbaqi, Dolani, Sollopa, Gurrëza, Muzhaqi, etj, që të gjithë vatra të zjarra të qëndresës shqiptare.

Paçka se i vogël, Filati shquhet për një peisazh të bukur, që të sjell ndërmend punimet e shumta rreth qyteteve shqiptare të piktorit të madh anglez Eduard Lir. Në anën e tij veriore, pikërisht atje ku i vunë thikën përgjakshëm nga gjiri i mëmëdheut, si kështjella hyjnore i lartëson Malet e Shqipërisë. Kurse kodrat përreth, me ulli shekullorë (prona të çamërve) i krijojnë me plot dashuri një kurorë mahnitëse. Këtu, Filati, nis të përhumbet në legjendë. Apo nuk ishte përfshirë i tëri gjatë qëndrimit tonë, mes një velloje të trishtë mjegulle. Qenë ditët e para të vitit 2000. Një dimër me pak diell, me fare pak dritë.

Të dhënat e para për filaqotët na i bën të njohura një ndër folkloristët më të mëdhenj shqiptarë, Fatos Mero Rrapaj. Ai tregon për Elimët, për këtë fis kaq të vjetër iliro-epirot, të cilët kanë banuar në Çamëri, Labëri, madje dhe në ishullin e Sicilisë qysh në shekullin XII para Krishtit. Elimët, i përmend edhe poeti i shquar Virgjili, në librin e pestë të Eneadës. Kapaku i librit paraqet në një garë vrapimi dy heronjtë antikë Elimin dhe Penopenë.

Gjithashtu për Eliminët flet edhe Pukëvili. Në shënimet e tij që ia kushton udhëtimeve në More, Shqipëri, Maqedoni, Thesali, etj, në të hyrë të shekullit XIX, ai shpesh përmend rrënojat Elime. Ato janë mbeturina muresh ndërtuar me gurë ciklopik, aspak të ngjashëm me rrënojat antike greke, që ndërtoheshin jo vetëm me gurë të zgjedhur, por edhe të daltuar artistikisht. Le t'i kthehemi tani ndonjë legjende të

rrallë, mbledhur prej gojës së popullsisë Çame nga Fatos M.Rrapaj. Në librin e tij “Rënkimet e çamërisë”, botuar në Tiranë më 1995, ndër të tjera, folkloristi i madh tregon:”...Bënej kalaja në Guman (Filat). Po gurë nuk kish, se vendi atje ishte ips. Elimët e mirrnin gurin kah Malsinica e Fushës së Lopsit (Filat). Një gur ka ata të themi pak, vinte 10 kuintal. Këta gurë, në Kalanë e Gumanit i sillnin në krahë, gratë e Elimëve. Burrat e tyre ndërtonin kalanë...”.

“...Në Shkallë të Zorjanit (Shkalla e Filatit) ishte një kala. Thoshnin të vjetrit se ajo kala ishte bërë në kohë të Venecianëve. Po thonë edhe më parë këtë kala e patën bërë Elimët. Ajo kala, sot, ka një mur 4-5 metra. Pjesa tjetër kishte ratë...”.

Gojëdhëna të tjera që i përkasin fshatarëve lidhen me emrin e Princit të dëgjuar mesjetar, Gjijn Bue Shpata. Në fëmininë time m’i tregonte babai. Princi çam pati luftuar me sukses kundër serbëve në shekullin XIV. Kryeqendra e tij ka qenë qyteti i Artës. Thuhet se Spatari, një fshat luftëtarësh mes Filatit dhe Koskës e ka trashëguar emrin e tij pikërisht prej Princit të Madh, i cili gjatë rrugës për në Lumin e Bisticës, ku shkatërroi përfundimisht forcat kundërshtare kaloi mes tij.

Po kështu edhe fshati Dishat-Dyshpat, pranë Koskës e ruan toponimin e tij qysh prej kohës së Gjijn Bue Shpatës. Legjenda thotë se Princi çam për të arritur sa më shpejt në Lumin e Bisticës, me Shpatën e Tij goditi aq fort, saqë krijoi një të çarë të madhe, një shteg kalimi në mal. Në këtë mënyrë, u doli armiqëve në befasi. E kështu me ikjen e moteve, në këtë qafë

mali, në këtë shteg u krijua Dishat-Dyshpati.

Por legendat nuk mbarojnë këtu. Tok me këngët folklorike, përrallat ato shërbejnë si rrënoja antike për etnicitetin e popujve të lashtë. Kështu, gojdhana tregon se qyteti i Filatit pas shumë luftrave e shkatërrimeve gjatë shekujve, rikrijohet sërish. Thuhet se prej Pllotores së Gumenicës atje, na vijnë e vendosen dy burra. Njëri quhej Demi e tjetri Sejko. Ata, shpejt u shtuan, u shumuan. Në këtë mënyrë u krijuan dy prej fiseve më të mëdha filaqote, që tok me të tjerë ndërtuan qytetin.

Me mendimin se mos u zgjatëm ca si shumë me legendat themi t'i kthehemi historisë. Filatin, pa mëdyshje do ta konsideroja si një ndër qytetet më të rëndësishme në kryengritjet shqiptare të viteve '30-'40 (shekulli XIX) kundër pushtimit osman. Qëndresa e çamërve ndaj mobilizimit ushtarak të Mehmet Reshit Pashës, viti 1829 e pati pikënisjen pikërisht në veri të lumit Kalama. Dështimi i këtij mobilizimi ndikoi më tej në konsolidimin e pavarësisë së Shtetit të ri grek. Natyrisht, që edhe vetë lëvizja shqiptare aspironte për liri. Por shpejt, kryengritësit u gjendën mes dy zjarresh: Në njërën anë ishin forcat osmane, ndërsa në tjetrën shtriheshin e zgjateshin thonjtë e megalidesë që sapo kish nisur të skicohej. Kështu në mes hekurit osman, e pabesisë greke shuhen njëra pas tjetrës vatrata kryengritëse shqiptare përgjatë gjithë Epirit. Kapedanët e njohur si Zylyftar Poda, Islam Pronjo, Lul Çapari, Zenel Gjoleka, Tafil Buzi, Çelo Picari, Hodo Nivica e

të tjerë internohen apo mërgohen.

Në fillim të viteve '50, si pasojë e konsolidimit të shtetit grek dhe përkrahjes së disa fuqive të mëdha evropiane, megaloida në Çamëri thonjtë tentoi t'i kthejë në kthetra. Në të gjitha trevat e Epirit vepronte një agjunkturë e fuqishme konsullatash, shoqërisht të ndryshme helene e mbi të gjitha kisha. Andartët jo vetëm që bëhen si mizat e lisit, por nisin të kryejnë krime të tmerrshme. Ndër qytetet e parë që do të përgjakej ishte Filati. Në prill të vitit 1854, bandat e Tomarit do ta pushtonin përkohësisht qytetin. Shtëpi të shumta plaçkiten, digjen. Gjaku skuq qytetin. Shumë familje si ajo e Xhafer Demit do të vriten barbarisht. Persekutimi ishte i llahtarshëm. Teodor Griva bashkë me Nikolla Zervën (me siguri gjyshi a stërgjyshi i kryekriminelit të Çamërisë Napoleon Zervës) do të kapardiseshin me gradat e kryegjeneralit dhe të gjeneralit. Çamëria do të rrezikohej e gjitha. Revanit të bishave të tërbuara u duhej vënë medoemos freri. Atdheu kërkonte mbrojtje prej bijve të tij. Kapedanë të sprovuar qysh gjatë viteve '30-'40, ndër ta Halit Bej Frashëri (babai i Abdylit, Samiut, Naimit), Çelo Picari, Ahmet Çapari etj., u vunë menjëherë në krye të luftimeve. Gjithashtu u krijua aleancë e detyruar me garnizonet osmane. Në mes të muajit prill të vitit 1854, luftëtarët çamë i shtyn grekët të tërhiqen me turp prej Filatit e krejt Çamërisë së Mesme. Në këtë mënyrë pushtuesve s'ju mbetej gjë tjetër veçse të tërhiqeshin drejt Çamërisë së Jugut.

“...Në kuadër të konflikteve të armatosura, tanimë thjesht në mes shqiptarëve dhe grekëve,

gjenerali i vjetër Kiço Xavella bëri përpjekjet e fundit për të vazhduar rezistencën. Kështu Foto Xhavellën e autorizoi të udhëhiqte trupat e vet drejt kodrës së Shën Ilisë, Dhimitër Karasiskaqin në vendin e quajtur Feneromen, ndërsa Dhimitër Grivën e udhëzoi të ruante pozitat në fshatin Bani. Por para sulmeve të furishme të Çelo Picarit andartët u thyen keqas edhe në këto pika. Kështu, grekërve ju mbeti në duar vetëm fortesa e Petës... Të ndjekur pa pushuar prej Halit Bej Frashërit, Çelo Picarit, Ahmet Çaparit e krerëve të tjerë çamë, andartët rezistuan për herë të fundit në fshatin Skulikaria të prirë prej Karaiskaqit. Gjatë muajit maj pushtuesit tërhiqen me bisht në shalë drejt Thesalisë e Maqedonisë. Pas këtyre humbjeve në Çamëri, grekët i pushojnë përkohësisht sulmet e tyre. Ju mbetet vetëm të llotosisin nëpërmjet gazetave të Athinës”.⁷

Por populli thotë që “ujku qimen e ndërron veç zakonin s`e harron”. Mbas plot 24 vjetësh e pikërisht në vitin 1878, andartët grekë do ta shkelnin përsëri tokën shqiptare. Në mes të shkurtit do të sulmojnë Lëkurësin. Duke qenë se ky vit shënon krijimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Abdyl Frashëri synonte sërish të bashkëbisedonte me grekët. Dialogu duhej të shmangte zjarret. Por, mirëkuptimi dështoi. Tashmë megaleidea mbizotëronte prej vitesh politikën Helene.

Në rezistencën shqiptare tashmë çfaqet ndjeshëm Abedin Dino (Çami). Duke qenë njeriu më i pasur dhe më autoritar në Çamëri, ai investoi shumë në Lëkurës. Pas sukseseve fillestare të andartëve në Qafë të

⁷ Shkëlzen Raça “Marrëdhëniet shqiptaro-greke 1829-1881, Prishtinë 1990.

Gjashtës bije dhe Saranda. Vriten dhe masakrohen dhjetra e qindra shqiptarë të pafajshëm. Athina mendon se çasti i shumëpritur për realizimin e “ëndrrës së madhe”, më së fundi pat ardhur. Shtypi, propaganda greke gjëmonte me të madhe. Por i bënë hesapet pa hanxhinë. E gjithë popullata shqiptare do të ngrihej në këmbë. Lufta do të bëhej për jetë a vdekje. Porta gjithashtu do të dërgonte përforcime të reja si dhe armatime moderne për kohën. Luftëtarët çamër të drejtuar prej Abedin Dinos, tok me himariotët e leberit e Myslim Gjolekës do të shquheshin në luftime. Shkatërrimi grek do të kryhej si një reaksion zinxhir. Çlirohet Saranda, Qafa e Gjashtës, Delvina etj. Andartët u detyruan të tërhiqen e të vendosen në Lëkurës. Por edhe kjo fortesë e tyre e fundit ra menjëherë. Gjaku i tyre përsquqi detin. Pas shuplakës së vitit 1854 në Lëkurës, Athina do të merrte një grusht të rëndë. Koka iu var poshtë. Veç shovenët nuk heqin dorë kurrë prej synimeve të tyre ogurzeza. A mund të jetojnë hijenat pa gjak? Asnjëherë! Kështu, Greqia tentoi të pushtojë toka shqiptare edhe njëherë në vitin 1897. Por, përsëri theu hundët.

Kurse Filati, tok me rrethinat e tij do vazhdojë të derdhë gjak për lirinë e Kombit. Në luftën për pavarësi ngrihet monumentale figura e Muharrem Rushitit. Bashkë me luftëtarë të tjerë të parisë çame, ai do të kryente aktin historik të pjesëmarrjes në ngritjen e Flamurit prej Ismail Qemalit në Vlorë. Ky fakt konfirmohet prej diplomatësh të huaj pjesëmarrës në ngjarjen e madhe. Muharrem Rushiti tërë jetën e shkriu për Çamëri-Shqipëri. Të paharruara do të mbeten lufrat

e shumta të udhëhequra prej tij. A harrohet beteja e Qeramicës, ku kryetrimi mori tri plagë në trup. Si thotë kënga popullore për Muharrem Rushitin, kur bashkë me luftëtarë çamër i shkoi në ndihmë Kurveleshit:

*“...Prite, prite Kurvelesh
Se të vjen ndihmë petriti,
Vjen mbi grekun shesh më shesh
Trimi Muharrem Rushiti...”*

Kryekriminelë si Deli Janaqi, Kromidha, etj, tmerroheshin prej emrit të tij. Bandat e tyre, sa herë do ndesheshin me trimat e Muharrem Rushitit do linin kockat. Malet, grykat, vetë lumi Kalama janë bërë varre për kërmat e tyre.

Kështu mes gjakut të derdhur Çamëria e Mesme dhe e Sipërme do mbetj e papushtuar edhe pas vetë rënies së Janinës (mars 1913). U desh një marrëveshje e detyruar, që forcat greke ta pushtonin Çamërinë. Muharrem Rushiti kurrsesi nuk mund të pajtohej me këtë gjëmë. Tok me Ahmet Bej Margëllecin, Alush Takën, Asaf Ajdonatin, etj, do të hidhen në Labëri. Për Çamërinë martire do nisnin ditët e pushtimit. Në Londër, Konferenca e Ambasadorëve vendoste vulën e turpit mbi robërinë. Shpejt Çamëria do shndërrohej në viktimë. Në Selan të Paramithisë, andartët brenda një dite do vrisnin afro njëqind burra. E njëjta tragjedi desh u përsërit edhe në Filat, nëse si vëllezërit e krishterë të qytetit nuk do t'i kishin detyruar kriminelët të largoheshin. Por vitet 1944-1945 ende ishin larg. Megjithatë, Çamëria sapo pat nisur të lëngonte rëndë.

FILATI SOT

Ndryshe nga Gumenica, Filati është një qytet i pandryshuar, i vjetër, tipik shqiptar. Diçka mes Konispolit e Delvinës, me 5-6 mijë banorë. Ndërtesa të ulta, një-dy e jo më shumë se tre kate. Përgjithësisht të mirëmbajtura. Me gërmadha aty këtu, plagë të pambyllura, dëshmi e genocidit antiçam. Qyteti në qendër të tij ka një lulishte të vogël jo më të madhe se një fushë basketbolli. Me plot pemë të shkurtra dekorative. Këtu mblidhen të gjitha udhët, ku njëra prej tyre, ajo më kryesorja e përshkon Filatin prej lindjes në perëndim. Në njërin kënd të lulishtes gjendet një kioskë e vogël. Pranë qendrës ka dyqane të shumtë

ku spikasin kafenetë. Paradite në to vrasin kohën të moshuarit, ndërsa mbrëmjeve të vona zhurmojnë të rinjtë. Në pjesën jugore të lulishtes, në katin përdhes të një ndërtese të ulët ndodhet restoranti kryesor i qytetit. I madh sa një fushë volejboli. Atje më bëri përshtypje njëri prej pronarëve që njëkohësisht shërbente edhe si kamarier. Tepër i shëndoshë, i gjatë, mesatar në moshë. Shërbente mes një shkathësie që të habiste.

Në qytet hymë me ditë. Ora nuk duhej të kishte vajtur ende katër. Njëpër udhë kishte fare pak njerëz. Si gumeniciotët, filaqotët patjetër pushonin pas pune. Agroni banonte me qira në periferi të qytetit. Shtëpia e tij, një vilë tri katëshe ishte pronë e një plake greke. Qe ndërtuar në një arkitekturë bashkëkohore. Përpara kishte një oborr të madh, të lënë djerrë. Në krah të majtë përsëri shtëpi çame. Gërmadha. Në të djathtë, një tjetër shtëpi e re nga ku lehte kërcënueshëm një qen i madh. Nga pas, atje ku bregorja merrte të përpjetë, ullinj të shumtë.

Tek po hynim brenda, njëpër shkallët e katit të dytë ngjitej e zonja e shtëpisë. Në moshë të shkuar. E përshëndetëm në shqip. Ajo jo vetëm që nuk u përgjigj, por na shihte sa me habi e po aq me kërshtëri. Me dorën e djathtë të mbërthyer fort mbi parvazin e shkallëve ngjasonte me një statujë të zezë.

- Ajo nuk di shqip, - foli Agroni tek hapi derën e shtëpisë. – Në Filat ka zbritur prej IROMERIT, një fshat malor grek.

Unë nuk reagoja, megjithëse e dija fare mirë që IROMERI, FAROMERI, KSEROMERI dhe një fshat tjetër të cilit nuk po ja kujtoj dot emrin, dikur ishin

çifliqe të çamit të kamur Omer aga. Këto fshatra janë kufi me Shqipërinë, pranë Janjarit. Fshatra të tillë që thirreshin me emrat e pronarëve të tyre kanë qenë të njohur në Shqipërinë e Jugut. Me këtë rast përmendim edhe disa të tjerë përgjatë fushës së Vurgut si p.sh.: Omerefendi Memushbe, Kalivepasha, Karalibe, Hoxhë, Aliko, etj. Është pikërisht ky fakt që ka shtyrë një pjesë të studiuesve shqiptarë të mbrojnë tezën e njohur, se minoritarët grekë në Shqipëri kanë ardhur për të punuar si argatë në tokat e bejlerëve apo agallarëve shqiptarë, si gjatë kohës së Ali Pashë Tepelenës apo edhe përpara tij.

Agroni hyri Brenda. E shoqja me të bijën hiqnin këpucët në verandë. Po kështu veproi edhe Mirela me Arbërin.

- Kalipsera (Mirë mbrëma), - i thashë plakës në greqisht.

Asaj menjëherë ju tjetërsua fytyra. I qeshën sytë. Trupi iu zhdërvjelltësua sikur të ishte e re.

-Kalipsera, kalipsera, - tha ajo duke folur më tej.

Por unë nuk mund të dëgjoja gjatë. Të gjithë kishin hyrë brenda. Dera kish mbetur e hapur. Pasi hoqa këpucët u futa edhe unë. Jashtë sapo pat nisur të binte muzgu. Moti po ftohej edhe më. Ndërsa e lehura kërcënuese e qenit fqinj dëgjohej ende.

Duke qënë se para dy orësh pata ngrënë në Gumenicë pimë vetëm një kafe. U hapën muhabetet nga më të ndryshme. Ne treguam për udhëtimin tonë,

ata folën për jetën, punën e tyre. Kujtuam edhe Myfitin, babain e Mirelës, të cilin ata e respektonin aq shumë. Po kështu përmendëm edhe Lutfiun, babain e Agronit. Arbëri që nuk para afrohet me vajza, për çudi me të bijën e Agronit lozte mirë. Veç nuk fjaloseshin me njëri-tjetrin. E vogla nuk dinte shqip. Në një çast trokiti dera. Ishte vëllai i Anthullës që gjithashtu punonte dhe jetonte familjarisht në Filat. Pat ardhur të merrte kunatin, por Agroni i la të kuptonte se sonte do të angazhohej me kushërirën dhe familjen e saj. Pasi piu diçka, vëllai i Anthullës u largua. Ndërkohë Arbëri me vajzën ndiqnin në televizor "Tomin dhe Xherrin". Hera herës shpërthenin në të qeshura. Më vinte keq që nuk komuniknin. E pyeta Agronin nëse e shihnin dot në Filat TV Shqiptar. Jo ishte përgjigja e tij. Radio Tiranën dëgjojme ndonjëherë. Megjithatë edhe valët e saj nuk janë aq të pastra. Më pas u hap edhe biseda e luftës në Kosovë. Si Agroni e po ashtu edhe Anthulla u shprehën se stacionet televizive greke patën transmetuar shumë biseda lidhur me këtë çështje. Theksuan se grekërit nuk i donin kosovarët. Përkundrazi mbronin serbët, Sllobodanin ... Bile shanin Klintonin, Amerikën, Naton.

Nuk thuhet kot fjala se muhabeti e tret fare pa u ndjer kohën. Kështu, minutë pas minuti patën kaluar plot dy orë.

- Me që keni vendosur të ikni nesër në Margëllëç
- tha Agroni, - ne menduam që sonte të dalim ca nëpër Filat. Ta shihni e ta njihni pak më mirë qytetin.

- Sa mirë, - u shpreh Arbëri dhe shtoi: - Të blejmë edhe një film se na është mbaruar.

-Shumë mirë – tha Mirela. – Do të bëjmë edhe fotografi së toku.

-Bukur – foli Anthulla. – T'i kemi si kujtime.

E vogla na ndiqte pa kuptuar asgjë. Për një çast, kurioze i kërkoi në greqisht shpjegime të jatit. Kur mori vesh se çfarë kishim thënë, nga gëzimi nisi të hidhej në vend. Ju afrua Arbërit dhe e puthi në faqe. Arbëri, sado që u përsquq ca në fytyrë, buzëqeshi.

U veshëm dhe dolëm shpejt. Bënte vërtetë ftohtë. Mirela i mbërtheu xhupin Arbërit deri në grykë. Këtu edhe moti është ndryshe. Ndërkohë që në mbarë Greqinë mesdhetare patëm ndjerë edhe vapë. Klima e Filatit është e njëllajtë me atë të Konispolit, e rrethinave të tij. Pjesa e Çamërisë Veriore që i largohet detit ruan jo vetëm gjuhën e përbashkët, por edhe relievin e klimën e njëjtë.

Rrugët e Filatit pothuaj qenë të zbrazëta. Tek tuk shihej ndonjë kalimtar i rrallë që neve të panjohurve na vështronte kurioz. Kafenetë zhurmonin. Të hapur ishin edhe dyqanet që tregtonin artikuj nga më të shumëllojshmit. Tek lulishtja në qendër të qytetit takuam djalin e Agronit. Ai ishte me shokë. Ndërkohë kujtova se duhej të blenim filmin. Që të fiksonim në celuloid kujtimet e Filatit, medoemos duhej bërë disa fotografi. U drejtova për nga dyqanet. Pata bërë pak hapa. Ndodhesha pikërisht tek kioska e vogël, kur ma pret udhën një mesoburrë, me ca mjekër në fytyrë. I panjohuri më foli në shqip:

- Më jep një duhan, - më tha.

Ndonëse u befasova e ruajta qetësinë. Nga xhepi nxorra paketën. E hapa ngadalë. Hoqa dy cigare prej

saj. Një ja dhashë të panjohurit, tjetrën e vura në buzë. Ja ndeza më parë atij, pastaj vehtes.

- Kah je ti – më pyeti çami, - kah Markati?

Shtanga. Nëna ime ishte pikërisht nga Markati, fshat çam në Shqipëri. E vështrova në fytyrë. Tepër i hequr. Brenda sekondës m'u ngritën në tru disa mendime. Mos ndoshta po më provokonte? Asfalia greke i trazon së tepërmi shqiptarët. Por për të qenë i sinqertë duhet thënë, se ky njeri nuk të krijonte ide të keqe. Pastaj ajo mjekra e tij e parruar, e parregullt. Më pati bërë përshtypje çamçja e tij. "Kah je ti, çam nga Markati"?

- Po ti kah je, - e pyeta.

- Këtej jam u, - tha. – Kah Filati...

Pranë nesh u gjend Agroni. Më futi krahun dhe ecëm përpara. Erdhën edhe Mirela me Anthullën.

- Mos ja vë re atij, - tha Agroni. – Është i marrë.

Ka qenë agronom më parë. Prej studimeve të tepërta ka lajthitur. Veç është nga një familje e mirë filaqote.

Mirela dukej e shqetësuar. Ndërsa Arbëri lozte në lulishte me vajzën e Agronit. Për tek dyqani më shoqëroi Anthulla. Kur u kthyem i panjohuri ishte ende aty. Na përshëndeti me dorë. Nisëm të pozonim. Më parë të vegjëlit, pastaj ne të rriturit. Arbëri vetëm qeshte. Ishte tepër i gëzuar. I tillë ka dalë edhe në fotografi. Unë si asnjëherë tjetër në çdo fotografi pata pozuar me cigare në dorë. I panjohuri i çuditshëm nuk po më shqitej nga sytë.

- Tani do të vemi të hamë darkë në lokal, - foli Anthulla me shqipen e saj prej minoritareje.

Në fillim Arbëri, pastaj edhe e vogla përplasën

duart të gëzuar. Nxituan të parët. Nga pas i ndoqëm ne. Lokali ishte më i miri i Filatit. Komod. Siç kam thënë edhe më lart, i madh sa një fushë voleybolli. Nuk kish edhe aq njerëz. Të mbajtur e të veshur mirë. Sigurisht këtu mblidhej elita e qytetit. Me njëherë ra në sy kamarieri trup madh, për të cilin Agroni kish thënë se qe njëkohësisht edhe njëri prej pronarëve. Me atë të ecurën e tij tipike, si të një fokeje që vetëm nxitonte na u gjend pranë.

- Çfarë do të pish Beni? – pyeti Agroni. – Raki, verë apo birrë?

- Më mirë një gotë verë, - I thashë unë.

Pas kësaj pyeti edhe Mirelën dhe dha porosinë. Disa minuta më vonë, trashaluqi i këndshëm solli pijet, picat, paidhaqet dhe bukën. Fëmijët gëzonin haptazi. Tek po tërhiqej kamarieri përshëndeti miqësisht.

-Gëzuar, gëzuar, - tha në fillim Anthulla. E mirëse na erdhët.

- Gëzuar, gëzuar, - thanë në fillim fëmijët e bashkë me ta edhe ne.

Darka ish e këndshme, sado që fëmijët lëviznin paksa. Megjithë këtë, vihej re lehtë se kurioziteti i vendasve ndaj nesh shtohet në lokal. Kjo jo thjeshtë për shkak të shkathësisë së fëmijëve por pasi tashmë qe marrë vesh që ne ishim shqiptarë të Shqipërisë. Ndërkaq Anthulla po i tregonte Mirelës, një pjesë të klientëve. Shefi i policisë, Prokurori, Gjykatësi, Avokati, Doktor, etj. Për një çast sytë tek këta i hodha edhe unë. Veçse secila fytyrë më shëmbëllente me të panjohurin e çuditshëm mjekrosh. Sidoqoftë kaluam një mbrëmje të bukur.

Më së fundi dolëm. Djali i pat sjellë Agronit makinën. Kur hipëm në të ai tha se duhej të shkonte diku për të lajmëruar dikë. Po kalonim mes një pjese të panjohur të Filatit. Me sa kuptova ishim në ekstremin tjetër të qytetit. Në këtë zonë shtëpitë gërmadhë shumoheshin. Në makinë ndiheshin vetëm të qeshurat e fëmijëve. Kur u kthyem në shtëpi ndihesha i pa qetë. Si pasojë nuk hyra brenda por qëndrova në verandë. Bënte ftohtë. Ndeza një duhan. Kërkova edhe një kafe. Anthulla e solli menjëherë.

- Do ftohesh, - tha ajo. – Më mirë futu Brenda.

- Faleminderit, - thashë. – Po rri ca jashtë pasi më dhemb koka.

Në të vërtetë ajo më shtrëngonte. Më rrihnin tëmthat. Për një çast ngrita sytë lart. Qielli ishte tepër i pastër. M'u bë se yjet nuk ndriçonin në të, po veç pikonin gjak. Masakrat e mëdha të Filatit m'u ringjallën sërish. Ato janë ndër më tragjiket e kryera në Çamëri.

Më 24 Shtator 1944 pasi kishin përgjakur Vërselën e Galbaqin, andartët e Kranjait hynë në Filat. Ai urdhëroi prerë: “Bëni kërdrinë...” Qyteti do të përjetonte natën e zezë të Shën Bartolomeut. Pleq, plaka, burra, gra, të rinj, fëmijë, do thereshin si bagëtia, si brenda e po ashtu edhe jashtë shtëpive të tyre. Të rejat u përdhunuan. Rrugëve të Filatit si ujët e shiut shkiste gjaku. U arrit deri atje, sa t'u hapej me bajonetë barku nënave shtatzëna dhe t'u nxirreshin foshnjat. Pastaj, kerthitë i vendosnin majë bajonetave dhe i ngrinin lart. Gjëma e madhe do vazhdonte për disa ditë.

Përsa u takon vjedhjeve, grabitjeve, qenë bërë më se të zakonshme. Si punëtorë të zotë, çamërit njiheshin për kamjen e tyre. Andartët rrëmbyen edhe flori. Barbaria nuk po njihte kufi. U arrit deri atje sa të këputeshin gishtërinjtë e të vrarëve për t'u marrë unazën. Të gjallëve iu shkuleshin me darë gozhdësh dhëmbët e florinjte. Xhamisë së madhe në qendër të Filatit iu vu zjarri. Të njëjtin fat pësuan edhe ato më të vogla në lagjet e tjera të qytetit. Zinxhiri i masakrave të llahtarshme shpejt arriti edhe në fshatrat rrotull. Mbi të gjithë e pësoi Spatari, që shquhet për një ndodhi sa të veçantë po aq edhe heroike. Një oficer zervist i vret babanë një vajze. Pas kësaj e merr me vete, me synimin për ta kthyer në skllave. E reja le të kuptojë se nuk do të kudërshtonte. Ky reagim e bën grekun të shkujdesur. Tek zhvishej, armën e lë pa kujdes. Çamja e re përfiton dhe e rrëmben menjëherë. Breshëron mbi kriminelin duke e lënë thes në vend. Shpejt del jashtë. Duke përfituar nga rrëmuja, arrin në kufi pa pësuar gjë.

Flakët e djegieve, krimeve me shpejtësi shpërhapen edhe në Smartë, Lopëz, etj... Ripërsëritet i njëjti skenar. Vrasje plaçkitje, djegie shtëpish. Çamërve të pambrojtur ju pat rënë mbi kokë gjëma e madhe. Sipas urdhërit të Athinës, zbatuar me përpikmëri prej kryekriminelit Napoleon Zerva, përdrejtë Shqipërisë përzihen me dhunë mbi 20.000 vetë. Qindra mijëra të tjerë vriten, masakrohen, në udhë e sipër. Megjithëse kërkohen 3 brigada partizane si ndihmë, Enver Hoxha nuk reagon aspak. Ndërkaq minoritarëve grekë në Shqipëri nuk ju preket as edhe

një qime floku. Kobi i zi vetëm Filatit i kushton 1286 të vrarë. Kujtimet m'i ndërpreu një zhurmë.

Nga pas shpatullave të mia u hap dera e shtëpisë. Ishte Agroni që më ftonte të hyja brenda pasi bënte ftohtë. U ngrita. Tek hodha cigaren në oborr, vura re se plaka greke lëvizi nëpër shkallë. Atë natë gjumi do më zinte tepër vonë. Kënga e gjelave të Filatit më zgjoi shumë herët, menatë siç thonë çamërit dhe arbëreshët e Italisë së Jugut.

NË MARGËLLËÇ

Filati është qyteti më i afërt me Shqipërinë. Prej Qafës së Botës, ku viteve të fundit është hapur një pikë e re doganore, ai nuk ndodhet më larg se 10-15 km. Në qoftë se rruga automobilistike do ishte pa kthesa, qyteti mbetet tej kufirit vetëm 15 minuta. Por ne, nuk po ngjiteshim drejt veriut. Zbrisnim drejt Margëllëçit, Paramithisë-Çamërisë së Mesme. Agroni na shoqëroi deri në Gumenicë. Pas gjarpërimit të këndshëm mes pishave poshtë Filatit, po i afroheshim urës së Kalamait. Në të dalë të saj, i thashë Agronit të mbante pak makinën për të bërë disa fotografi. Zbritëm të katër.

- Bërr, sa ftohtë, - bëri Arbëri.

U mbështeta në parmakët e urës mbi të dy brrylet. Pëllëmbët mbledhur grushte mbanin mjekrën. Poshtë, Kalamai i Vjetër (Thjamisi – Çamesi) nxitonte me revan drejt detit. Tek përplasej nëpër shkëmbinj dallgëzonte, shkumëzonte i tëri. Pa më thënë, Mirela më fotografoi në atë pozicion. Patjetër do të kem dalë tepër i menduar. Befasia e së ëmës e bëri të qeshë Arbërin. Ai pozoj me dy gishtat lart në shenjë lirie, në shenjë demokracie. Natyrisht, pozuam edhe me Agronin.

Dua të theksoj se kurdoherë që pozonim brenda territorit të Çamërisë, nuk ndiheshim të qetë. Një si ankth të përfshinte vetiu. Kjo ndjesi bëhej edhe më e fuqishme sa herë që udhëtohej në pjesën veriperëndimore të Filatit. Këtej, malet qenë mbushur me tabela, ku shënohej se nuk lejohej përdorimi i aparatit fotografik e i kamerave. Gjatë kthesave të forta, më shumë se një marramendje, më kapi një si shtrëngim në gjoks. Po ndjeja siklet. Ula fare pak xhamin në krah. Mirela reagoi menjëherë:

- Do na sëmuresh djalin. Bën ftohtë.

Nuk ndihesha vërtetë mirë. Një fasho e lehtë djerse, më mbuloi ballin. Natyrisht nuk u dëgjova. Veçse zërtheva kopsën e parë të këmishës dhe lirova ca gravatën. Shpejt, hymë në Gumenicë. Agroni devijoi për nga bregu i detit. Rrugën kryesore të qytetit, që të shpinte tek stacioni i autobusave e shmangëm.

- Marrim ndonjë kafe, - tha Agroni. – Urbani për në Margëllëç do kohë të niset.

U ulëm në lokalin më të afërt. Menjëherë, më erdhi në mend incidenti i para nëntë vjetëve me plakun

çam dhe nipin e tij polic. Mirela me Arbërin shëtisnin në njërën prej lulishteve buzë detit. U kthyen shpejt pa ardhur ende kafetë.

- E kreu amanetin e nënës së Edit. Mora një grusht dhe prej tokës së Gumenicës. E kam fshehur në këllëfin e aparatit fotografik.

Punëtorin bullafiq në stacionin e autobusave, i cili dje nuk kish dashur të komunikonte me ne në shqip e rastisëm përsëri. Qëlluam ballëpërballë dhe bëmë sikur s'ishim parë asnjëherë. Për të qenë i sinqertë, duhet të them se ai njeri më pat acaruar. Nisja e urbanit bëri të harrohej shpejt.

Grikohori mbeti pas, ndërsa e shkuara erdhi pranë. Ai nuk është më larg se tre kilometra me Gumenicën. Kam lexuar e dëgjuar shumë për të. Njihet si një ndër fshatrat çame më të mëdha. Në prag të Luftës së dytë Botërore, ka pasur afër 450 shtëpi. Mbi të gjitha, është shquar për një harmoni të plotë fetare. Çamërit e të dy besimeve, shkonin e vinin me njëri-tjetrin si vëllezër të një gjaku. Grikohori ka qenë një fshat i bukur. Prej grykës së malit ku u ndërtua mori dhe emrin. Në mes i shkonte lumi. Por, bishat zerviste nuk e lanë të trashëgonte. Si qindra fshatra të tjera çame u shndërrua në gërmadhë. Tani nëpër të jetojnë pak vllahë, që si gjithnjë, merren me blektori. Fare pranë Grikohorit ka qenë edhe fshati Ledhez. Deri në vitet e gjëmës së madhe (1944-1945) me 20-30 shtëpi. Ndonëse një fshat i vogël, Ledheza, ka një legjendë të madhe: Në gojëdhënat e tij populli thotë se atje ka lindur Pirrua

i Madh – mbreti i Epirit të lashtë, një ndër ushtarakët më të shquar të kohërave.

Në urban pak pasagjerë. Po t'i numëroje nuk bëheshin as dhjetë. Qysh në fillim më pat tërhequr vëmendjen një djalë mbi të tridhjetat, si dhe një grua në moshë që me sa shihej duhej të ishte nëna e tij. Të heshtur. Nuk ndërronin asnjë fjalë. Ç'mendonin vallë? Më shumë se vendas, ngjanin me vizitorë. I biri e ndiqte të ëmën hera-herës me cep të syrit. Pastaj vështronte tej dritares.

Njëri pas tjetrit, gërmadha ose pjesërisht të tilla patën kaluar Nista, Arbënica, Arpica, Arila, etj. Margëllëçi po bëhej më i ndjeshëm. Në këtë qytet të njohur të Çamërisë së mesme, vija për herë të dytë. Nëntë vjet më parë, tok me Çimin, patëm pirë një kafe. Kurse drekën e patëm kaluar në Paramithi. Suli, mbetesh i anashkaluar. Veç malet e tij nervoz, dukeshin sikur ngriheshin me qiellin. E gërvishnin, e bënë të lotonin.

Fqinjët para nesh flisnin me zë të ulët. Tek u kthye prej djalit, profili i hequr i gruas m'u duk i përlotur. M'u duk sikur shpatullat i tundeshin ritmikisht. Për një çast, duke ndier instiktivisht vështrimin tim ktheu kokën prapa. Nuk pata gabuar. Kish sy të përlotur. Bëri përpara sërish. U mundua të mblidhte veten. Me një shami të bardhë, mbledhur në dorë rrotullam fshiu sytë. Diç i tha të birit për ne, përderisa ai na vështroi. Duke i buzëqeshur lehtë, e pyeta:

- Shqiptarë të Shqipërisë?

- Po, - u përgjigj ai shkurt.

E ëma sërish ktheu kokën mbrapa. Vështronte si me frikë. Me sa dukej, nuk po kuptonte ende se çfarë ishim ne, shqiptarë të përtej apo të këtej kufirit. Për çudi prej pasqyrës së vogël të urbanit, shoferi po na survejonte.

- Ajo grua – foli Mirela, - patjetër është çame që kthehet në vend të saj për t'u çmallur.

- Ashtu mendoj edhe unë, - thashë.

- Përse qante, babi? – Pyeti Arbëri.

- Sepse e ka marrë malli shumë për Çamërinë, vendlindjen e saj, - shpjegoi Mirela. – Ka, mbi pesëdhjetë vjet pa e parë. E la foshnjë, kthehet plakë. Ka hakë të qajë.

- Sa gjynah, - u shpreh Arbëri.

- Po shtëpinë, si do e gjejë vallë, - foli unë – Gërmadhë!

Në kthesë të rrugës për në Margëllëç rrënoja e parë. Dukej si një kult fetar. E djegur e shkatërruar e tërë. Para nesh, gruaja që ngritur në këmbë. Gërmadhën në fjalë e ndoqi me kokën prapa derisa i humbi nga sytë. Po i afrohemishim qytetit, pasi papritur u çfaqën rrepet e mëdha të Margëllëçit. Mes tyre xhamia e prishur. Këtë herë fqinja jonë, kaloi shaminë nëpër sy. U çfaqën edhe shtëpitë periferike. Në sfond Mali i Margëllëçit. Dikur, qyteti, kishte pesëmijë banorë. Si muslimanë e po kështu të krishterë. Njësoj si Filati, Margëllëçi nuk ka ndryshuar. Natyrisht është mirëmbajtur. Pusi i vjetër, në qendër të pazarit ruhet ende. Atë nuk e kanë dëmtuar. Gjithashtu edhe godina e policisë. Ka mbetur siç ka qenë gjatë viteve të masakrave.

Zbritëm nga autobusi. Gruaja menjëherë i futi krahun djalit. Siç ndodh rëndom nëpër qytetet e vogla u bënë viktimat të kuriozitetit të tepruar. Unë, Mirela dhe Arbëri, si lamë pas pusin, morëm të përpjetën e qytetit. Gruaja dhe djali mbetën prapa. Vështrimet e shumta po më shqetësonin. Për t'u ndjerë më i sigurt, ndeza një cigare. Pak më tej u ulëm në një pijetore. Vura re se përballë, në krahun tjetër të udhës, kishim një thertore. Erdhi kamarieri.

- Dy kafe, - thashë.

Porosia erdhi shpejt. Kafetë shoqëroheshin me dy gota ujë. Kërkova edhe një hamburger për Arbërin. Pa mbaruar ende cigaren e parë ndeza të dytën. Rrufisnim në heshtje kafetë. Qe pikërisht ky ambient i rëndë që bëri të më vinte ndër mend, tregimi i Ilirit, shoferit të linjës Sarandë – Qafë Botë. Për më tepër nuk po dëgjonim as edhe një fjalë të vetme shqip. Si zgjua bletësh pas shpatullave tona, lokali gumëzhinte në greqisht. Pranë këmbëve si pa u ndjerë rrëshqiti një prift. I ri në moshë. Me sy të ftohtë, të qelqtë.

Ngjarja me Ilirin, shoferin e linjës Sarandë-Qafë Botë ka ndodhur fill mbas mbarimit të luftës në Kosovë, kur forcat serbe u detyruan të thyenin zverkun. Duke qenë një djalë trim e i shkathët, allçak siç i thonë fjalës, Iliri pat shkuar në Margëllëç. Kishte uri të madhe. Vinte nga Patra dhe do të udhëtonte për në Qafë Botë. Qe ulur në një lokal me njerëz të shumtë. Si të panjohur e pritën ftohtë. Të gjithë flisnin greqisht. Ju paraqit kamarieri, një djalosh i ri. Iliri porositi në shqip.

Kamarieri heshti mes një shprehje si të pakuptimtë në fytyrë. Iliri porositi për së dyti në shqip. Kërkoj verë dhe mish të pjekur. Për çudi, tashmë nuk heshtte vetëm kamarieri por i gjithë lokali. Pas kësaj, në tavolinë u paraqit vetë pronari. Ai gjithashtu foli në greqisht. Iliri sërish në shqip.

- Kërkova një shishe verë dhe një qingj të pjekur.

Heshtja në lokal ishte e plotë. Pronari u largua pa thënë as edhe një fjalë. Iliri ndezi qetë një duhan. Fjollat e tymit, spirale-spirale ngjiteshin lart. Në tavolinë erdhi prapë i zoti i lokalit. Mbi mbulesën e bardhë vendosi një shishe të errët vere si dhe një gotë të bukur, tip krikëlle.

- Shpejt vjen edhe mishtë, - foli këtë herë në shqip.

- Faleminderit, - tha Iliri.

Pronari pasi i hapi tapën shishes, hodhi disa gllënka në krikëll. Më së fundi erdhi edhe qingji i pjekur. Në trupin e vogël, koka binte në sy. Dhëmbët e vegjël skërmisnin. Mbi tavolinë u vendos edhe pak bukë.

- Kah të kemi zotrote, - pyeti në shqip pronari.

- Këtej jam, kah Margëllëçi, - u përgjigj shkurt Iliri.

- Vërtetazi, - u shpreh i befasuar tjetri.

- Me të vërtetë, - pohoi Iliri që vazhdoi edhe më serbes. - Kam ardhur të shoh vendlindjen e prindërve të mi.

- Po ç'mbiemër mban zotrote, - pyeti pronari.

Iliri e pa vëngër. Nuk iu përgjigj pyetjes por vazhdoi edhe më.

- Një pjesë e atyre ulla të atje te jantë të babait tim, ai i pat trashëguar nga i ati e kështu brez pas brezi.

Lokalin e pat pllakosur një heshtje varri. Dukej sikur nuk merrte askush frymë. Dhjetra sy lëviznin ping-pong sa tek Iliri e sa tek i zoti i dyqanit. Vështtrimet e patën humbur ftohtësinë. Qenë si të përhumbur, si të trembur. Pronari kish mbetur në këmbë si i ngrirë. Iliri duke përfituar prej mpirjes së tyre vazhdoi më tej. Zuri të lozë me ta.

- Pas luftës së Kosovës, ne shqiptarëve të Shqipërisë, Amerika na ka pajisur të gjithëve me pasaporta amerikane. Na ka bërë qytetarë të saj.

- Jo more, - u dëgjua për herë të parë një zë në shqip prej klientëve. – Nuk është e mundur.

- Po na flet të rreme, - foli një tjetër.

- Jo more jo, - vazhdoi me guxim lojën Iliri. – Nuk po ju them të rreme, por të vërteta. A doni t'ju tregoj edhe pasaportën amerikane?

Çamërit margalliçiotë kishin mbetur pa gojë. Iliri nxorri nga xhepi vërtetë një pasaportë amerikane. E ngriti lart. Ndikimi ishte i jashtëzakonshëm. Të gjithë u bënë meit në fytyrë. Iliri vazhdoi më tej.

- Kështu që unë do të marr të gjitha pronat e mia dhe do të investoj në to.

Bomba qe hedhur. Iliri pat prekur në pikën më delikate. Papritur gati gjithë lokali brofi në këmbë. Greqishtja qe harruar. Flitej me zë të lartë vetëm në shqip.

- Jo more djalë është punë që s' bëhet kjo, - u shprehën 3-4 vetë njëherësh.

Iliri e pat lënë pasaportën mbi tavolinë. Përsëri

heshtje varri. 2-3 klientë u ngritën e dolën nga lokali. Iliri iu bëri gëzuar me gotë. Një pjesë prej tyre, e shihnin të hutuar. Të tjerët, vështronin shoqi-shoqin. Prej lokalit, u largua personi i katërt. Ndërkaq, pronari theu heshtjen, duke pyetur:

- Ku do veç tania, more djalë?

- Në Prevezë, - u përgjigj Iliri. – Jam me makinën time dhe arrij shpejt.

Realisht, nuk po tregonte të vërtetën. Do të kthehej në Filat, tek një miku i tij, ku do të linte edhe makinën, pastaj do ikte për Qaf Botë. Veptoi kështu, pasi dyshonte se ata, mund t'i vinin nga pas astronominë. Mbaroi së ngrëni dhe pagoi. U ngrit. Si përhëndeti në shqip, doli prej lokali. Makinën e pat parkuar aty pranë. Shpejt u gjet në udhë.

Pasi mbaruam kafetë kaluam në trotuarin tjetër. Pikërisht tek dyqani i mishit u bëmë dëshmitarë të një skene të pahijshme. Personazhe kryesore ngeleshin gruaja çame që shoqërohej prej të birit në Margëllëç. Ajo, seç po llafoste më kasapin, një burrë në moshë të saj. Për të mos thënë i ftohtë, reagimi i tij qe indiferent. Aty pranë, ne të tre vetvetiu u bëmë kuriozë. Ngadalësuam çapin duke qëndruar ballë vitrinës së vogël të një kinkalerie.

- Po si nuk më kujtoke, mor Kristo, - thoshte gruaja. – kemi lozur tok, axhami. Bashkë shkonim edhe në shkollë. Baballarët tanë shkonin mirë me njëri-tjetrin.

- Nuk thaç, moj Myrvete, se nuk të mbaj mend,

- tha kasapi. – E di që fëmi, kemi qenë shokë. Por kan shkuar vitera. Kohët ndërruan...

Më vinte rëndë dyfish. Sepse dashur pa dashur po përgjoja, pastaj ajo grua po më dhimbsej. Doja të lëvizja po Mirela më frenoi duke më mbajtur nga krahu. Bëri sikur po tregonte diçka në vitrinë. Ndërkaq, gruaja foli prapë:

- Po nuk më the, ç' fëmi ke more Kristo?!

- Dy djelm të rritur, - u përgjigj pa ngritur sytë kasapi.

Vazhdonte të grinte me makinë ca si mish të bardhë, që më krijoi idenë se ishte prej derri. Nuk denjoi fare ta pyeste shoqen e fëminisë për familjen e saj. Madje të birin e saj në krah nuk e përshëndeti aspak. Ky u ndje ngushtë bëri të largohej, por e ëma foli përsëri:

- Po shtëpinë tonë, more Kristo, cili e ka zënë vallë? Lufta, nuk e pati dëmtuar edhe aq. E pushë nga përjashta. Mbahej mirë.

Këtë herë, Kristua nuk foli asnjë fjalë. Përkundrazi. Mblodhi në një enë mishin e grirë dhe duke kthyer shpinën u fut në pjesën e pasme të thertores. Për çudi nuk u duk më.

- Eja nënë të ikim, - tha djali. - Nuk ka përse të rrimë më.

Gruaja nuk u dëgjua. Ndoqi të birin heshturazi. Ne mbetëm pas. Kur parakaluam thertoren, vumë re se Kristoja ende nuk qe kthyer. Vendin ia kishte zënë një djalë i ri. Ndoshta i biri. Ndiqja në shpatulla gruan margallëçate. E mpakur edhe më. M'u dhimbs një me nënën time. Nuk doja të bëhesha edhe më dëshmitar i

mundimit të saj. Ju thashë Mirelës dhe Arbërit, të kalonim në trotuarin tjetër. Bile i lashë qëllimisht që të shkëputeshin ca.

Po i afrohem qendrës. Në krah të godinës së policisë qenë parkuar dy xhipa gri. Aty pranë një hotel. Nuk kishim vendosur në se do të iknim apo do të qëndronim në Margëllëç. Megjithatë menduam të hynim një herë në hotel. Kur ç'të shihnim! Në hollin e vogël nënë e bir. Me sa dukej prisnin, përderisa në banak nuk kishte njeri. Ne i përshëndetëm duke kaluar në restorantin në krah. Më së fundi, nëpër shkallë zbriti një vajzë e rë. E zeshkët. Aspak simpatike. Me flokë të mbledhur.

- Urdhëroni, - foli tek kaloi në sportel.

- Do donim një dhomë, - foli në greqisht djali, që tashmë i qe afruar banakut.

- Pasaportat, - tha vajza.

Në fillim shfletoi të djalit, pastaj të nënës së tij. Këtu vajza qëndroi. Një tjetërsim të beftë pësoi në fytyrë. Me siguri do i kishte bërë përshtypje vendlindja e gruas, Margëllëçi. Kërkoi ndjesë për një çast dhe u ngjit lart. Nuk vonoi as tri katër minuta.

- Për ju ka një problem. Do të prisni pak sa ta sqarojmë.

Nënë e bir, u shqetësuan. Diç thanë me njëri-tjetrin. Pasaportat qëndronin mbi suprinën e zezë të banakut. Pas pak në hotel behu policia. Dy vetë gjithësej. Jo vetëm gruaja, por edhe djali qe bërë limon në fytyrë. Pa përshëndetur askënd, policët iu drejtuan sportelit. Seç biseduan me vajzën e re. Njëri prej tyre, ai më i moshuari, shfletonte me kujdes pasaportat. Me

atë të margëlliçotës nëpër gishtërinj u afrua.

- Si do të bëni? Do të ktheheni në Shipëri, apo doni t'ju mbajmë këtu?

Nuk qe vështirë të kapej nënteksti. I moshuari godiste kurrizin e pasaportës në shputën e dorës së majtë.

- Ç' duan këta? – pyeti e trembur gruaja të birin.

- Na thonë të kthehemi në Shqipëri, - sqaroi djaloshi që tërhoqi nga dora e policit pasaportën e nënës.

Pastaj mori dhe pasaportën e tij prej banakut dhe të dy tok iu drejtuan derës. Në holl mbetën policët me sportelisten. Seç folën përsëri! Pastaj u larguan dhe ata. Pak më vonë dolëm dhe ne të tre. Kur u gjet përballë sportelit, Mirela më shumë se një buzëqeshje i fali një ngërdheshje vajzës së re. Tek zbrisnim nëpër shkallë tha:

- Të ikim edhe në Beni. Margëllëçin e pamë. E shuam kureshtjen.

Unë nuk reagoval. Ndiqja gruan çame që bashkë me të birin po kërkonin taksi. Nga hutimi cigaren e ndeza së prapthi. Nuk po e thithja dot.

- Babi, e ke ndezur keq, - tha Arbëri.

- Unë nuk vi në Paramithi, - u shpreh Mirela. – Nuk kemi nge të përfundojmë astronomive tok me djalin.

Nuk fola. Po ç'mund të thoja! Më ishte prerë gjuha. Patëm kaluar një ndër ditët më të rënda të udhëtimit tonë.

PARAMITHIA

Për në Pargë morëm një taksi. Në udhë e sipër, mendoja vetëm për dimrin që patëm lënë në njërin prej qyteteve kryesore të Çamërisë së Mesme. Ndihesha aq shumë i trishtuar sa që fshatrat mes Margëllëçit dhe Pargës si Shënedjella, Shanëca, Qafa e minit etj. parakalonin pa i parë me vëmendje. Nxitimthi linin pas njëri-tjetrit. Po i afroheshim detit. Parga si një ballkon i bukur përmbi Jon. Tok me Çimin, nëntë vjet më parë Pargën e pata vizituar dy herë. Çuditërisht, kujtimet nuk po më zgjoheshin. Mbeteshin të përgjumura brenda shpirtit të lënduar. Kurioziteti që fashitur edhe ndaj shtëpive gërmadha që shquheshin aty-

këtu. Nuk po më bënin përshtypje as sytë e shplara të taksistit që gjatë tërë rrugës na ndiqnin nëpërmjet pasqyrës së vogël. Në krah, Mirela nuk dëgjohej. M'u duk e drobitur. Ndërsa me Arbërin ndodhte krejt ndyshe. Duke qenë në ndenjësën e parë, përcillte peisazhin e bukur i kënaqur. Kur pa të thinjurin, madhështorin briti:

- O ma, o ba, deti, deti...

Por mua, ende më mbante të ngërthyer mërzia. Në heshtje, mundohesha të gjeja arsyet e vërteta të ftohtësirës të Margëllëçit. Përse të ndodhte kështu? Në Margëllëç, edhe sot e kësaj dite, pjesa dërmuese e banorëve janë shqiptarë. Ardhasakët e Anadollit (1923-1926), nuk janë veçse minoritet. Përse ai qëndrim ndaj gruas çame me emrin Myrvete? Mos ndoshta çamërit e krishterë iu tremben pronave të çamërve myslimanë? Natyrisht, shfrytëzimi i tyre, për më se gjysëm shekulli realisht duhet t'ju rëndojë në ndërgjegje. Mes erërave të reja që fryjnë sot në glob, kur Europa e vjetër shkon drejt shkrirjes së kufijve edhe rikthimi i çamërve myslimanë në trojet e tyre amëtare nuk mund të konsiderohet më thjesht si një utopi. Tek e fundit, çamërit ortodoksë duhet të kujtojnë që edhe ata vetë janë viktimë. Politika djallëzore e shtetit grek ka synuar që nëpërmjet tokës, t'i instrumentalizojnë e aq më keq t'i armiqësojnë me sivëllëzërit e tyre myslimanë. Një taktikë e tillë është sa e vjetër dhe aq e njohur. A nuk është vepruar po me të njëjtat forma nga ana e qeverisë greke edhe me tokat në Maqedoni, Thrakë, etj.

Pastaj është edhe kisha greke. Helmi i saj gjatë

shumë shekujsh ka synuar të përçajë, t'i armiqësojë vëllezërit e një gjaku në Çamëri e, kudo në Epir. Madje aty ku si ka ecur, ajo e ka vrrarë. A mund të harrohet Papa Kristo Negovani, Petro Nini Luarasi, At Stath Melani etj. Për sa u takon shqiptarëve, Patriarkana gjithmonë ka vënë fenë mbi kombin. Për të, shqiptarët myslimanë kanë qenë thjesht turq, kurse shqiptarët ortodoksë thjeshtë grekë. A mund të heqë dorë patriarkana prej ëndrrës së saj të vjetër për ç'kombtarizimin e shqiptarëve. A mund të hiqet dorë prej idesë së marrë të rikrijimit të Perandorisë Bizantine. Paradoksi qëndron në atë që harrohet fakti domethënës i mosasimilimit të shqiptarëve, mbijetesës së tyre mijëra vjeçare.

Por jo vetëm kaq. Kisha greke po punon intensivisht edhe sot e kësaj dite. Metastazat e saj kanceroze i ka shtrirë edhe përgjatë Shqipërisë së Jugut (Epirit të Veriut). Të mos harrojmë, helmi i saj vepron... Apo mos, ndoshta, padashur e teprova! Rashë në grackën e një fanatiku. Në se është kështu, të më falni! Për mua, feja e shqiptarit siç ka thënë Pashko Vasë Shkodrani, është Shqiptaria...

Tek largohesh prej Margëllëçit, trishtimi dyfishohet edhe për diçka tjetër. Paramithisë kësaj qendre kaq të rëndësishme të Çamërisë qemë detyruar t'i kthenim shpinën. Me sa duket, për këtë arsye po ndjeja një si të dhembur në gjoks. Për fat të keq Paramithia po bëhej qyteti i parë çam të cilin nuk po mundeshim ta vizitonim. Dija se Paramithia, si edhe

Margëllëçi nuk kishte ndryshuar. Siç kam theksuar edhe më parë, atë e kisha shikuar nëntë vjet më parë, bashkë me Çimin – shokun tim të ngushtë.

Nëse do të përshkruaj, kujtoj se Paramithia është pak më e madhe se Margëllëçi. Qyteti të sjell ndërmend diçka edhe Filatin. Vetëm se nuk është ngritur në kodër por në shpat mali. Më shumë përngjan me Krujën e Skënderbeut. Ka edhe një kështjellë të bukur. Natyrisht jo aq e madhe sa ajo e kryetrimt shqiptar – epirot. Paramithia më pat krijuar emocion të veçantë. Apo nuk binte atëherë një shi i shtruar vjeshte, që i falte qytetit një tis prrallor. Jo më kot piktorët e huaj janë frymëzuar nga peisazhi i bukur i Paramithisë dhe maleve të lartë që ka për sfond. Në këtë këndvështrim, qyteti pranëson legjendën. Elimët, çamërit e lashtë, kanë lënë gjurmë të rëndësishme në këtë hapësirë.

Në të vërtetë, Paramithia është fortuna që shpërndan mjergullën që pat rënë sot në Margëllëç. Historia e 150 vjetëve të fundit dëshmon për këtë. Theksoj se Paramithia, tok me rrethinat e saj është ndër vendet më të përgjakura të Çamërisë. Beteja të shumta janë zhvilluar këtu. Ndërkohë që malet e Sulit kanë shërbyer për fat të keq, si vatra zjarri ku vazhdimisht janë mbledhur e organizuar sulmet e andartëve grekë. Qysh me krijimin e tij shteti grek, prej këndeje i ka vënë zjarrin Çamërisë dhe mbarë Epirit. Në këto anë, robëria ka peshuar rëndë.

A mund të harrohet tragjedia e marsit të vitit 1913, ku tek përroi pranë fshatit Selan, kriminelët e Deli Janaqit, masakruan rreth 100 burra. Ata ishin ndër ardhetarët më të shquar të fshatrave Nihur, Mininë,

Dramës, Rrezan, Shënmëri etj. Në fillim i gënjyen duke ju thënë se do i çonin në Paramithi, për një takim mirëkuptimi. Por shpejt i prangosën dhe i vunë përpara. Atëherë ata kuptuan rrezikun e madh që u kanosej. Në udhë e sipër ju thanë se nuk do i shpinin në Paramithi, por në Janinë. U ndryshua urdhëri. Të gjithë e ndjenin se ç'farë po i priste. Qe thjesht çështje kohe a vëndi. E ç'mund të bënin? Tashmë, ishin thjesht robër.

Tek një përrua, mes malesh, grykash, rrëpirash, fare pranë fshatit Selan, u ndaluan. Terren tepër i përshtatshëm për të kryer krimin e madh. Pabesisht i qëlluan pas shpine. Breshëri të pafundme. Ndonjëri që kish mbetur i paasgjësuar u qëllua sërish. Po përse i vranë? Thjesht sepse ishin çamër, sepse ishin shqiptarë. Donin të jetonin të lirë.

Në vitet e mëvonshme asgjë nuk ndryshoi. Krimi ndoqi krimin. Në qarqet e larta shovene greke ishte projektuar, që fara çame të shkulej me rrënjë prej Çamërisë, Epirit. Megalaidea mbetej në rend të ditës. Për ta realizuar objektivin barbar, Athina zgjodhi si më të përshtatshëm, renegatin shqiptar prej fshatit Zervë të Prevezës, Napoleon Zervën. Ky gjak kutërbuar mblodhi nga ishin e nga nuk ishin një numër të madh andartësh, që arritën në 20.000 vetë. Ata në dorë mbanin pushkën në gojë thikën. Ishin vërtetë të hurit e litarit.

Më 27 qershor 1944, Napoleon Zerva dha urdhër të sulmohej Paramithia. Asnjë çam mysliman të mos mbetej i gjallë. Të shkoheshin në thikë të gjithë: fëmijë, pleq, burra e gra. Ndryshe në Margëllëç, Pargë, Gumenicë etj., këtu me përjashtim të vendit të quajtur

Gallata, çamërit nuk arritën të organizoheshin mirë. Këshilli i Përgjithshëm i Mbrojtjes çame, nuk mundi të rezistonte siç duhej. Në këtë mes ndikuan edhe mosmarrëveshjet e panevojshme të çamërve. Për pasojë, gjaku do të derdhej lumë. Masakra mori përmasa të papara. Krimi i Përroit të Selanit, 31 vjet më parë ishte i papërfillshëm. Viktima të genocidit zervist do bëheshin mbi 800 njerëz. Urdhri i kryekriminelit Napoleon Zerva gjeti zbatim. Gjatë barbarisë nuk u kursyen as fëmijët e djepit e as pleq ulokë. U përdhunuan gratë dhe vajzat çame. Qyteti dhe rrethinat e tij u gjakosën rëndë. Shtëpitë u dogjën. U vodhën sende nga më të çmueshmet. Ja si e përshkruan gjëmën e madhe Zoti Sali Bullati, një prej dëshmitarëve që mundi të mbetej i gjallë.

“Trokitjet e rënda vazhduan dhe babai doli vetëm me çorape, për të mos u kthyer më. Atë e rrëmbyen Zervistët, bandat famëkeqe që pllakosën qytetin tonë. Babain nuk do ta shihja më kurrë. Ne mbetëm jetimë. Në një çast, në oborin e shtëpisë hynë 4-5 zervistë që ngrehin një mitroloz. Nëna e shkretë na mblodhi si ajo klloçka përreth vetes. Një oficer grek e rrëmbeu edhe atë. Ajo u lut që të më merrte me vete edhe mua. Vëllai i madh Ferhati, 14 vjeç se nga ishte zhdukur. Të nesërmen mësuam se e kishin vrarë rrugës pranë shtëpisë së hallës. Pastaj, mësuam se edhe nënën e kishin pushkatuar brenda xhamisë së Bollatëve”⁸.

Dua të theksoj këtu, se shumë të krishterë, të cilët

⁸ Sali Bullati, “Tregime që nuk harrohen”. Gazeta “Çamëria” - Vatra amtare” 26.6.1991

kishin dëgjuar për planet barbare të Napoleon Zervës, jo vetëm që njoftuan si vëllezërit e tyre myslimanë, por edhe i mbrojtën ata si në shtëpitë e tyre e po ashtu edhe i shoqëruan deri përtej lumit Kalama, që kosiderohej si zonë e qetë. Kështu marrëdhëniet mes çamërve myslimanë e të krishterë mbetën të qëndrueshme. Pa përmendur këtu krerë të tillë të krishterë siç është rasti i avokatit të nderuar Spiro Çollaku (anëtar i Këshillit të Përgjithshëm për mbrojtjen e Çamërisë) i cili, gjithashtu u masakrua duke u shndërruar në një martir të kombit Shqiptar.

Tamam për këtë mirëkuptim tregon edhe ngjarja e Çimit, shokut tim të ngushtë që në fillimet e demokracisë shqiptare, për herë të parë si emigrant u vendos në fshatin Nemicë të Fushës së Frarit.

Ishte fillimi i vitit 1991. Çimi punonte në një familje të moshuarish, të cilët i ndihmonte për gjithçka. Si gjithmonë punonte mirë e pa fjalë. Kjo iu ra në sy edhe të zotërve të shtëpisë, që zunë të flisnin me të edhe në shqip. Një ditë Çimi (që nënën e ka nga Margëllëçi) ju foli atyre në dialektin çam. Të moshuarit qenë habitur.

- More bir, - e pyeti një ditë plaku. – Kah je ti që flet gluhën tonë?

Çimi nuk reagoi menjëherë. Nuk ndihej plotësisht i qetë, sado që ata e patën afruar. Ishte ende fillimi i emigrimit. Por, pasi plaku këmbënguli disa herë, ai vendosi të hapej:

- Kah këto anë jam edhe u. – Nana ime është kah

Margëllëçi.

- Po përse nuk thua more djalë që edhe tinë si ne je çam! – tha plaku.

Çimi buzëqeshi në mirësinë e tij. Pas kësaj, ata e mbanin si djalë e tyre. Ca muaj më vonë, kur Çimi do largohej për t'u vendosur në Prevezë ishte krijuar një skenë rrëqethëse. Plaka i qe hedhur në krahë e nuk i hiqej. Kurse plaku i pat thënë:

- Rri me ne, more bir! Ne, nuk kemi djelm. Bënu djali jonë. Kemi një gjak. As kisha as xhamia nuk bën dëm.

Çimi, mbeti i befasuar. I shkanë lotë nga sytë. Tek u nda, ju premtoi se do t'i shihte përsëri. Dhe besa e shqiptarit kthehet gjithnjë në këngë.

NË PARGË

Nëse ka vend, ka pikë, ka lartësi nga ku mund të shohësh gjithë Çamërinë; detin, malet, fushat, kodrat, ullinjtë, limonët, portokajtë e saj është kalaja e Pargës. Këtu dhimbja për humbjen e tokës mëmë shndërrohet në torturë.

“Parga është një mrekulli. Duhet ta vizitoni patjetër – pat sygjëruar oficerja e Asfalisë”.

Tepër e rëndë. Më keq nuk ka ku të vejë. Ardhasakët të urdhërojnë të shohësh vendin tënd. Cinizmi nuk njih cak. Pa as më të voglin problem Parga, perla e Çamërisë konsiderohet si pronë e tyre. Madje me qetësi e me mburrje të thotë se qenka edhe

më e bukur se Saranda, Himara të cilat ajo i paskësh vizituar.

Por ç'ne një punonjëse e sigurimit grek në Jug të Shqipërisë? Sigurisht për të punuar edhe më tej në drejtim të Megalaidesë. Pastaj jo më kot filohelenët kanë ngritur veshët. Tashmë veprojnë haptaz. Po përse të mos zgjohen, derisa shteti shqiptar qëndron indiferent?!

Mirela me Arbërin sodisnin mrekullinë. Kalaja e qytetit ruan ende fizionominë mesjetare. Unë tymosja i tëri. Nuk po arrija të qartësoja nëse kreshpat e maleve, tej në horizont i përkisnin Shqipërisë së tej kufirit apo mos ishin malet mes Konispolit e Filatit. Përsa u takon lartësive mes trekëndëshit Gumenicë, Margëllëç, Paramithi ato shquheshin pa vështirësi pasi janë më pranë. Në juglindje ngrihen malet e Sulit që ndonëse përjetësisht kanë folur shqip kurrizin ja kanë kthyer mëmëdheut, kurse gjoksin Greqisë. Poshtë, në fushën e Frarit, përdrejt Prevezës, Çamëria është fushë. Tek-tuk sa për të thënë, lartohen kodra të shumta që diku arrijnë e diku e jo të bëhen male të vërtetë.

Kalaja dëshmon për krime nga më të llahtarshmet kundër çamërve martirë në verën e 1944. Aty janë pushkatuar dhjetra burra. Mehmet Kanali nga Parga tregon me hollësi masakrat. "Robërit i mblodhën në kala, ku zervistët kishin ngritur gjykatën ushtarake dhe i shpinin 5 e nga 5 para saj. Të gjithë dënoheshin me vdekje. Një skuadër e posaçme i pushkatonte pak më tej. Kufomat i hidhinin në një pus". Krimi paska të njëjtën fytyrë. A nuk vepruan në të njëjtën mënyrë kundër shqiptarëve të Kosovës edhe kriminelët serbë?!

Po Çamërit edhe në Pargë rezistuan, derdhën gjak. Ja se si e përshkruan qëndresën e tyre luftëtari dhe studiuesi i njohur konispolat Ibrahim D. Hoxha: “Rreth 3500 luftëtarë, të nisur nga Arpica, Margëllëçi e Vola mësyjnë njëherazi rregjimentin, që në korrik të 1944-ës kishte pushtuar Pargën. Mbi 1000 zervistë të përqendruar atje u bënë çep e këmbë. Ikën tutje detit me lundra, për në ujëdhezat jonike. Me qëllim që të 50 e ca familjet myslimane të zëna në Pargë, të mos pësonin gjëmën e Paramithisë, komanda e luftëtarëve arpicas e arilas mbajtën si pengje 40 familje të krishtera anadollite të vendosura atje në vitet 1923-1926. Komanda çame çoi fjalë në Pargë që të shkëmbeheshin myslimanët shqiptarë me grekërit anadollit. Zervistët ndoqën taktikën e Uliksit. Mashtruan me dinakëri se gjoja robërit nuk do të prekeshin aspak, veçse të lireshin të lirë grekërit. Duke i zënë besë çamërit gabuan. Kërkesa e tyre u pranua. Të krishterët anadollit u liruan. Kurse mbi çamërit e Pargës shkoi fshesa e hekurt. 47 prej tyre u grinë me breshëri plumbash. 2 të rinj detarë të mirënjohur u hodhën në det, njëri u vra në ajër, tjetri shpëtoi dhe u fsheli. Qytetin e mbyti gjëma. Vetëm Ibrahim Xhelo Mylazimin nuk e zunë dot të gjallë. Brenda shtëpisë së tij luftoi heroikisht për disa orë. Pasi vrau 7-8 zervistë ra dhe vetë. Trupit dhe shtëpisë së tij i vunë zjarrin...”.

Njësoj si në Gjirokastrë, Berat apo Krujë, nëpër të tatëpjetat e kalldrëmta të Pargës duhet të zbrisje me kujdes. Pasditja ishte plot njerëz. Madje kishte dhe të

huaj. Parga është një qytet turisti. Veçanërisht gjatë stinës së verës, qyteti dyfishon dhe trefishon popullsinë e tij. Arrin tek 20.000 banorë. Thuaje të gjitha shtëpitë, qofshin këto të vjetra apo të reja shndërrohen në hotele. Pargiotët, turizmin e kanë burim të rëndësishëm jetese. Megjithatë edhe stina e dimrit, ndonëse më të pakta i ka përfitimet e saj. Paksa më i kufizuar turizmi vazhdon të ketë rrjedhën e tij. Gjatë dimrit vizitorët qëndrojnë me orë. Thjeshtë shuajnë kureshtjen në qytetin piktoresk. Kështu që kafenetë janë gjithmonë plot. Kurse dyqanet mbeten të hapura deri vonë. Nëpër udhë nuk mungojnë as edhe shitësit ambulante, që gjatë stinës së verës shumojnë kudo po si milingonat. Pargiotët, si burrat po ashtu edhe gratë janë njerëz punëtorë. Në krah na shkuan dy vajza.

- Po më bëjnë përshtypje të rejat, - u shpreh me admirim Mirela. – Janë shumë simpatike, shumë të bukura.

- Ashtu është, - thashë unë. – Jo më kot të huajt, prej shekujsh i kanë përcaktuar pargiotet si femrat më të hijshme të Çamërisë.

Dhe nuk paskan gabuar, - foli sërish Mirela. – Me tamam qenkan shumë të bukura.

Ne, sapo kishim zbritur në qendër të qytetit me mendimin që të zinin ndonjë taksì për në Prevezë. Na duhej t'i telefononim edhe Çimit, sido që për vizitën tonë në Greqi e në Çamëri e pata njoftuar që nga Tirana. Ora shënonte 4. Zgjatimi i ditës ishte në hapat e saj të para. Kurse dielli si një lëmsh i zjarrtë, ngrihej mbi qytet. Zhytja e tij në det do të bëhej pas më pak se një ore. Për një çast Arbëri u shkëput ca nga ne. E tërhoqën

disa topa futbollit të nxjerra në trotuar jashtë një dyqani të vogël.

-Arbër, - i foli Mirela. – Të lutem mos u largo.

Djali jo vetëm që po i shihte po edhe po i prekte një e nga një me dorë. Pranë menjëherë u gjend e zonja e dyqanit që ndonëse nuk i foli e pa më përkëdheli.

-Eja tani se do të ikim. Po na vonon, - tha Mirela dhe e zuri nga dora.

-Lëre moj djalën, mos e nga, - foli në shqip e zonja e dyqanit që shtoi. – Ka sevda me topin dhe don ta marrë.

Ajo i shkoi dorën mbi flokë dhe e ledhatoi. Arbëri buzëqeshi. Pastaj sytë i kaloi sa tek unë e tek gruaja. Foli duke prekur njërin prej topave me dorë.

-O ba! Ky më duket origjinal. Është i bukur. E marrim?

I bukur i nanës, - tha shitësja që dorën prej flokëve ja shkoi në faqe.

-Po mirë more bir, - i thashë unë. – Meqë të pëlqen merre.

E zonja e dyqanit e ndau nga të tjerët menjëherë. E vendosi në një rrjetë dhe ja afroi Arbërit.

-Faleminderit, - u shpreh djali i gëzuar.

Pargiotja u ul në gjunjë dhe e puthi në të dyja faqet. Profili i saj ishte tërheqës. Flokë të prera shkurt, hundë e drejtë, vetulla e hequr me kujdes. Pak bjonde. Tek u ngrit në këmbë na buzëqeshi miqësisht. Një gropëz e vogël ju krijua në mes të mjekrës. Paguam dhe e përshëndetëm.

-Faleminderit dhe mirupafshim, - u shpreh ajo sërish në shqip.

-Zonjë grua, - tha Mirela tek iknim.

Arbëri, në çast bëri ta nxirrte topin nga rrjeta, por nuk mundi pasi ishte lidhur fort.

-Përse kërkon ta hapësh? – Mirë është, - i thashë unë.

Duke qenë se pranë këmbëve frenoi një taksi e verdhë na u desh që prej Pargës të largoheshim shpejt. Në fakt do të dëshiroja të pija edhe një kafe, por shqetësimi i Mirelës për të mos u vonuar na nxitoi. Shoferi qe në moshën time. I folta në shqip por nuk u përgjigj. Ndoshta është grek mendova. Pavarësisht nga kjo kuptoi në çast që ne do të udhëtonim për në Prevezë. Me sa mbaja mend prej vizitës sime të parë prej Prevezës në Pargë (bashkë me Çimin) arrihej brenda një ore. Pra, dy qytetet çame nuk janë më shumë se 40 km larg njëri-tjetrit. Sa rruga Tiranë-Durrës. Në ndenjësën e parë këtë herë rrija unë. Mirela më preku lehtë në sup dhe foli:

-Beni, mos u mërzit. Kafënë e pimë gjatë rrugës. Lë të presë ca shoferi. Nuk bëhet qameti.

Heshta. Kujtoja se jo shumë larg Pargës ndodhet Kanali, fshat i madh, të cilin grekët ju pëlqejnë ta quajnë Kanalaq. Qytetthi i bukur nuk ndodhet më larg se 10 km me Pargën. I thashë shoferit që në klubin më të afërt do të qëndronte për të pirë një kafe. Poho! me kokë. Pas afro 15 minutash u çfaqën dritat e para të Kanalit. Tashmë muzgu qe i plotë. Zbritëm. I thashë shoferit që nuk do të vonoheshim. Do të kryenim një telefonatë. Shoferi përsëri nuk reagoi. Tek e fundit përse

të fliste, përderisa aparati llogaritës punonte.

Në lokal nuk kishte asnjeri. Me sa kuptohej klientela niste të dukej në mbrëmje. Në banak qëndronte një djalë fare i ri, që po ta shihje me kujdes nuk kishte vënë ende brisk në faqe. Medoemos duhet të kryente edhe detyrën e kamarierit. Ndërkohë që në edhe Mirela u ulëm në tavolinë. Arbëri bëri drejt banakut. Kërkoj ujë në italisht por nuk duhet të ishte shprehur saktë përderisa adoleshenti i bëri vërejtje në shqip.

-Ç' më thua more dua acqua, - tha ai. – Thuamë shqip, dua ujë të pi.

Dhe buzëqeshte lehtë. Arbëri u zu ngushtë. Qe befasuar diçka. Si për t'u ndjerë më lehtë vështroi nga ne. Ne i buzëqeshëm gjithashtu. Pasi piu gotën me ujë, tok me banakierin u gjend tek ne.

-Urdhëroni, - tha djaloshi.

-Kafe, - thashë unë duke e ndjekur me admirim.

-Kahavetë i doni ekspres apo greke?

-Ekspres, - thashë unë.

-Tjatër gjë doni?

-Jo, - thashë dhe shtova. – Por duam të lidhemi me telefon me Prevezën.

-Lepe, - tha djaloshi.

U ngrita dhe e ndoqa nga pas. Telefoni ishte në kënd të banakut. Për fat, me Çimin u lidha shpejt. Aq shumë u gëzua, saqë nuk po kuptonte se nga po i flisja. Kur i përsërita se po i telefonoja nga Kanali, pranë Prevezës u entuziazmuva. Madje shtoi se në shtëpi kishte marrë edhe Vajen me Fëmijët.

-Aherë për punë 30 minutash do të jesh në qytet, - foli.

-Po.

-Unë po dal e të pres në qendër.

-Faleminderit, - thashë unë.

-Mirupafshim.

-Mirupafshim.

Në tavolinë u ktheva përpara se djaloshi të sillte kafetë ekspres. Sqarova Mirelën për çka bisedova me Çimin. U qetësua pasi kish shprehur shqetësimin se mos nuk gjendej në shtëpi. Ndërkohë djaloshi solli dy kafe dhe tri gota ujë. Arbërit i shkeli syrin miqësisht.

-Sa vjeç je – e pyeta unë.

-Të 15 i bëj në behar – u përgjigj ai.

-100 të bëhesh, - thashë unë.

-100 të bëhet edhe i iti, - tha ai.

-Faleminderit, - thamë në një gojë Mirela dhe unë.

Pas kësaj shkoi në banak. Kafetë i pimë aq nxitimthi, saqë nuk arrita të mbaroja as cigaren e ndezur. U ngritëm. U afruam pranë banakut. Adoleshenti sërish buzëqeshi. Lashë një kartmonedhë 2000 dhrahmishe mbi suprinë dhe pasi i rashë lehtë në shpatulla dola. Pa hyrë ende në makinë behu djaloshi. Në dorë mbante një qeskë me patetina. Ja dha Arbërit duke i shkarë dorën nëpër flokë. Na përshëndeti përsëri dhe u kthye në lokal. Makina u vu në udhë.

-Nuk i mësuam as emrin tha Mirela.

-E pra, - tha Arbëri. – Ishte çun shumë i mirë.

-Harruam nga nxitimi, - thashë unë.

Taksisti si përherë i pagojë. Sidoqoftë njohja me djaloshin sikur na pat lehtësuar ca. Dija se përpara kishim Agjinë, këtë qytezë të vogël që flet thjesht shqip.

Afrimi i saj më solli pranë kujtimin e një tjetri martir çam të krishterë. Është fjala për Vangjel Agjinë që u vra duke u tërhequr zvarrë prej grekërve, vetëm sepse ju mësonte gjuhën e nënës fëmijëve shqiptarë. Pastaj vinte Mitika, qendra e njohur e rezistencës çame, për mbrojtjen e Prevezës më 1912.

PREVEZA NË HISTORI

Nëse do t'ju thoja se mbi 120 vjet më parë, Preveza ka qenë kryeqendra e atdhetarizmit shqiptar, ju të çuditur paksa, do më pyesni: Po Prizrenin, qytetin e Lidhjes Shqiptare e harruat?! Natyrisht, jo. Veçse këtu, nuk bëhet fjalë për 10 qershorin e 1878, ditëlindjen e Lidhjes së Madhe. As për fundin e 1879, apo fillimin e 1880, kur forcat ushtarake të Lidhjes luftuan kundër ushtrisë malazeze për të mbrojtur Plavën, Gucinë e të tjera krahina thjesht shqiptare. Është fjala për mbylljen e vitit 1878 dhe fillimin e 1879, kur Preveza, në shtëpinë e Abedin Dinos mblidhte gjithë parinë e Shqipërisë, prej Jugut e deri në Kosovë

për mbrojtjen e Trojeve Etnike.

Atëherë, qyteti kryesor i Çamërisë ishte shumëfishuar. Shqiptarët, të irrituar prej prapaskenave që kërkonte të ngrinte Evropa mbi shpinë të tyre, (a thua se nuk qe pjesë e saj) patën vërshuar nëpër udhë si lumenj të papërmbajtshëm. Afro 20.000 luftëtarë gjendeshin nën armë. Në rast të një mobilizimi të domosdoshëm, numri i tyre do arrinte menjëherë në mbi 30.000 vetë. Preveza në një çast kyç të kombit shpaloste madhëri të botën, shpirtin e saj tërësisht shqiptar. Njerëzit më lotë në sy gëzonin fuqinë e tyre. Siguria e çamërve për mos'humbljen e qytetit, viseve amtare ishte e mahnitshme. Më së fundi pas mbi 400 vjetësh, Lidhja Shqiptare e Prizrenit pat mundur të përsëriste Besëlidhjen e famshme të Lezhës, me Gjergj Kastriot – Skënderbeun në krye.

Ja, si përshkruhet Preveza e asaj kohe nga konsulli francez i Janinës, Moro në një raport që i dërgonte shefit të tij në Paris – Ministrit të Jashtëm Vandington, më 7 shkurt 1879: “Në këto momente, Preveza është përplot me pashallarë, bejlerë dhe agallarë. Ky qytet është caktuar si qendra e veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare. Pikërisht sot kam pasur rastin të shoh një kërkesë të shqiptarëve drejtuar të gjithë ministrave të punëve të jashtme të qeverive të përfaqësuesve në Kongresin e Berlinit. Ata edhe me shkrim po deklarohen se, në qoftë se Epiri do t'i aneksohej Greqisë, atëherë kjo krahinë do të mbrohej deri në pikën e fundit të gjakut. Një forcë prej 30.000 njerëzish, thuhet se janë të gatshëm t'i kundërshtojnë çdo përparësie greke”.

Falë këtij entuziazmi, përballë rezistencës së fuqishme të shqiptarëve, thonjtë, kthetrat e bishës megalideiste zunë të mblidheshin, të tkurrreshin, të tërhiqeshin. Preveza, kryeqyteti i Çamërisë shpëtoi. Fatkeqësisht në vend të saj e pësoi qyteti i Artës, që historia e njeh si kryeqendër të princit mesjetar çam, Gjini Bue Shpata. Arta tok me rrethinat e saj, u bë viktimë e pazarllëqeve të Portës me Fuqitë e Mëdha, të cilat vazhdonin ta trajtonin me përkëdheli Greqinë. Po të njëjtin fat pësonte edhe Toplica, krahina më Veriore e Kosovës, që i dhurohej Serbisë. Shtatit të Mëmëdheut iu shkëputën dhunshëm toka vitale.

Le ta zbulojmë më tej historinë. Të ndjekim çastet kulmike të saj. Në shekullin XIX, kur ideonte udhët e hekurta të Shqipërisë, Sami Frashëri theksonte se Preveza përbënte stacionin e fundit të lokomotivës shqiptare. Është pikërisht rilindasi ynë i madh, i cili kryeqendrën e Çamërisë e lidh me familjen mbretërore të Pirros së Epirit antik. Ai thotë se në kohë të lashta, Preveza quhej Berenika për nder të emrit të vjehrrës të Pirro-Burrit. Pra, qyteti i Berenikës i ndërtuar për herë të parë nga Pirrua i madh ka qenë i ngritur ose në vendin ku sot ndodhet Preveza, ose në Nikopolin e vjetër të Agostinit – perandorit të njohur romak, rreth dhjetë kilometra në veri të saj.

Në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Preveza nuk i arrinte dot të 10.000 banorët. Ishte dhe mbetet porta hyrëse në Gjirin e Ambrakisë. E bukur. Plot me ullishte, portokaj e limona. Me dy xhami, tyrbe, teq

dhe tri shkolla, dy nga të cilat fillore. Kështjella e qytetit që e shkatërruan qysh para kohës së Ali Pashë Tepelenës, paçka se pashai shqiptar u përpoq ta fortifikonte diçka. Për pasojë Preveza mbetej vazhdimisht e pambrojtur kundrejt lakmive të huaj. Ky realitet ndikoi shumë edhe në pushtimin grek të 1912. Preveza është shquar gjithmonë përse i takon transportit detar. Anijet e saj kanë zhvilluar tregëti përgjatë Jonit, Adriatikut e deri sipër në gjirin e Venecias. Mëndafshi i Prevezës ka qenë veçanërisht i preferuar për tregjet e huaja. Duke qenë një pikë strategjike ajo përherë është lakmuar prej të fuqishmëve. Ndër të tjera ka njohur pushtimin venecian etj.

Në shekullin XVIII e patën pushtuar edhe francezët. Por, ky fakt binte ndesh me interesat e Ali Pashë Tepelenës. Ai, vuante që të huajt mbanin të pushtuar limane shqiptare, sado që politika ia desh që edhe të kishte marrëdhënie me ta. Megjithkëtë, kjo situatë nuk mund të pranohej të vazhdonte gjatë. Kështu, Ali Pasha vendosi të merrte Prevezën me luftë. Më 27 tetor 1798, shqiptarët vërshuan prej maleve për rreth. Në krye të mbi 10.000 luftëtarëve qëndronte vetë Ali Pasha me dy djemtë e tij, Veliun dhe Myftarin. Më kot ushtarakët e lartë francez u munduan të krijonin një front të shtrirë mbrojtës. Para furrisë së papërmbajtur të kalorësve të sprovuar shqiptarë, rezistenca e ushtarëve francezë ishte e papërfillshme. Në këtë mënyrë francezët pësuan disfatë dhe komandanti i tyre ra rob në duar të Vezirit të Janinës. Megjithatë, sundimtari i Epirit këtë herë u tregua zemërgjerë. Fali duke shpëtuar nga vdekja e sigurtë

një numër të konsiderueshëm ushtarësh francezë. Veç, tirania e tij nuk mund të rrinte pa ngritur krye. Tek po vizitonte qytetin pas betejës, urdhëroi prerazi që të gjithë pjestarët e minoritetit grek të Prevezës të cilët patën luftuar në krah të pushtuesve francezë të pushkatoheshin menjëherë.

Por viti më i kobshëm për kryeqendrën e Çamërisë, do të jetë fundi i 1912. Është periudha kur perandoria osmane gjendet në grahmat e saj të fundit. Madje, as edhe i ashtuquajtur i Revolucionit Xhonturk, (korrik 1908) që shpalli edhe kushtetutën, nuk mundi t'i zgjaste jetën. Mustafa Qemali (Ataturku) do të shfaqej më vonë. Në këtë kuadër, të gjitha shtetet ballkanike, fqinjë me Shqipërinë, u morën vesh që të gllabëronin kush të mundte më shumë troje shqiptare. Si inisiator, shteti Grek qëndronte në pararojë të kësaj aleance. Ai që i bindur, se më së fundi i erdhi rasti i përshtatshëm për të pushtuar Epirin. U vendos që sulmi të niste pikërisht me Prevezën, në Çamëri.

Në dhjetë ditëshin e tretë të tetorit, anije të shumta luftarake greke e vunë në mes gadishullin në formë thike të Prevezës, ku ngrihej edhe vetë qyteti. Goditjet artillerike zunë fuqishëm në të dy krahët e tij. Prej zjarrit të pandërprerë, netët nuk shquheshin nga ditët. Kryeqendra e Çamërisë po shkatërrohej, po digjej barbarisht. Të njëmijë mbrojtësit e saj, rezistonin heroikisht. Gjatë luftimeve shquhet për organizim dhe vendosmëri të madhe komandanti i artillerisë të qytetit, Bajram Gega prej Shqipërisë së Mesme. Qindra çamër

derdhën gjakun. Ndërkohë që humbjet e armikut qenë shumë më të mëdha. Po ç'farë mund të bënin ata njëmijë mbrojtës përpara një ushtrie të tërë e pajisur me armatimin më modern të kohës. Pastaj, siç kemi theksuar edhe më lart fortifikimi i qytetit linte për të dëshiruar. Kalaja e vjetër që lënë mbas dore. Lëre më pastaj që Porta të mendonte për t'ju lënë mbrojtësve ndonjë nga anijet e saj luftarake.

Mes kësaj situate, luftëtarët shqiptarë, detyrohen të tërhiqen. U mendua që rezistenca të vazhdonte disa kilometra në veri të Prevezës, pikërisht pranë Nikopolit antik, në fshatin e madh të Mitikës. Këtu u morën edhe disa masa përforcuese. U hapën disa llogore apo u meremetua paksa kalaja. Por edhe në këtë vend të Çamërisë, qëndresa nuk mund të vazhdonte gjatë. Më e keqja ishte se në ndihmë të mbrojtësve nuk u dërguan luftëtarë të rinj. Kështu në të hyrë të nëntorit edhe Mitika ra. Pas betejash të përgjakshme dy javore Preveza bije. Këmba mizore e pushtuesit e shkeli atë. Në këtë mënyrë, grekërve po iu hapej rruga për të sulmuar Çamërinë Qëndrore. Robërit ishin të shumtë. Të vrarët me qindra. Retë e zeza, po e mbulonin nxitimthi gjithë Çamërinë.

ABEDIN DINO

Pa diskutim, figura më e rëndësishme, më e madhe e historisë së Çamërisë, si dhe një ndër personalitetet më të shquar të kombit tonë është Abedin Dino. Fatkeqësisht Ai ka qenë përgojuar së tepërmi si nga histografia e politizuar shqiptare e po ashtu edhe prej dashakeqësve të huaj të popullit tonë. Do dëshiroja, që figurën e Abedin Dinos, ta shihja mes një këndvështrimi të ri, i cili në këto vitet e demokracisë shqiptare ka filluar të ndihet. Ja, si e vlerëson atë, në librin, “Ylli i Çamërisë – Hasan Tahsini”, studiuesi çam Sejdi Kondi.

“... Ishte Abedin Pashë Dino ai, që Greqia nuk e

pushtoi dot Çamërinë – Epirin në vitin 1878, por 35 vjet më vonë, pra më 1913. Me të njëjtën gatishmëri e vendosmëri Abedin Pashë Dino (ministër i jashtëm i Perandorisë Osmane), mbrojti edhe Kosovën, Iliriadën (Maqedoninë shqiptare) e gjithë trojet tona amtare. Me lot në sy e zemërdrobitur u detyrua të nënshkruante për një pjesë shumë të vogël të trojeve kombëtare, (në Mal të Zi) që mbetën jashtë Atdheut. Dhe këtë e bëri jo për indiferentizëm ndaj çështjes së shenjtë Kombëtare, siç shprehen disa... por për të mirën e Atdheut, për të evituar një katastrofë të përgjithshme, që do të vinte në pikëpyetje vetë ekzistencën tonë si Komb. Pra, duke qenë një politikan i kalibrit, Abedin Dino kreu një veprim aq të njohur taktik për politikën ndërkombëtare...”⁹

Po kush është Abedin Dino? Cila është gjeneza e familjes së tij që populli martir çam e ngriti në kufijtë e legjendës?

Dinenjtë, sefte kanë klenë një famile e varfër ka Lopsi i Filatit. Djeltë e plakës Sako Dine punonin bujq në fushë. Kësaj plake, një ditë na i vjen një fukara dhe i lyp bukë. Plaka e mori brenda, i dha kahave, pastaj i dha dhe buk të hajë. Fukarai iku i kënaqur nga pritëla që i bëri plaka dhe kur doli ka dera dha këtë urim:

-Dino thofshin në botë që më prite mua sot!

Në darkë, kur ra të flërë plaka pa një ëndërr të gëzuar. Ju bë sikur në një sterrë aty pranë gjeti para të florinjta. Menatë shkon në sterrë dhe i gjen me të vërtetë florinjte. Me ato para, Dinejtë ndërruan sarajet e tyre

⁹ Sejdi Kondi: Hasan Tahsini - "Ylli i Çamërisë", fq. 4. Tiranë 1998.

në Lopës. Me këto para mësuan shkollave. Ka zotësia që kishnë tri ka Dinejtë duall pashallarë të mëdhenj. Këta ishin Abedini, Veseli dhe Hyseni.

Vendlindja e Abedin Dinos është Preveza, qyteti më jugor i Çamërisë. Në fillim të prillit 1843, atë e solli në jetë Saliha Çapari, që rridhte nga një prej familjeve më të shquara e më atdhetare çame, në Luarat të Margëllëçit. Çaparenjtë janë të dëgjuar si gjatë kryengritjeve të Tanzimatit e po ashtu edhe në mbrojtjen që i bënë Çamërisë gjatë pranverës të vitit 1854. Ndërsa babai i Abedin Dinos, ishte Ahmet Dino. Ai gjithashtu qe një emër i shquar i kryengritjeve anti-greke dhe anti-osmane. Për shkak të aktivitetit të tij luftarak, Porta e burgosi larg, në Anadoll ku dhe vdiq. Fëmijëve ju la një pasuri të madhe e, mbi të gjitha dashurinë e madhe për Çamërinë dhe gjithë Shqipërinë. Mes fëmijëve shquhet Abedini i vogël, i cili pasi mori një studim të plotë u vendos në Stamboll. Ai zotëronte gjuhët kryesore si të perëndimit ashtu dhe të lindjes. Mes tyre italishten, frëngjishten, greqishten si dhe turqishten, persishten, arabishten etj. Natyrisht mbi të gjitha, atdhetari, diplomati i shquar, njihte gjuhën e nënës, shqipen e bukur. Por, Abedin Dino, do spikasë edhe si krijues e përkthyes. Ai do të vlerësohet prej shtypit evropian. Gazetat franceze, turke, greke etj. do të shkruajnë për talentin e Tij. Në vitet e para të karrierës së Tij diplomatike, Ai do të kthehej në vendlindje e do punonte si nënprefekt në qytetet e Prevezës e të Artës. Kulmi i shkëlqimit të Tij politik mbetet viti 1904, kur pasi pati punuar në detyra tepër të larta në Selanik, Ishujt e Egjeut etj., thirret nga Sulltan Abdyl Hamiti

në Stamboll për të marrë ofiqin e lartë të kryevezirit (kryeministrit) të Perandorisë. Por, krejtësisht papritur vdes në oborrin e madh. Thuhet, se u helmua nga një agjente ruse, kamariere në pallatin Perandorak.

Emri i Abedin Dinos lidhet ngushtë me një nga castet më të lavdishme e më dramatike të historisë së Kombit tonë. Në kuadër të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Ai, shpejt, do të bëhet udhëheqësi kryesor i saj për pjesën e poshtme të Shqipërisë, (Epirin, Çamërinë). Ndërkohë, Greqia e mbështetur edhe prej fuqive të mëdha (Kongresi i Berlinit pat siguruar ratifikimin e kufijve mes Perandorisë Osmane dhe Greqisë) i kërkonte me ngulm Portës që t'i lëshonte Epirin e në këtë kuadër edhe Çamërinë. Pikërisht këtu determinon personaliteti i Abedin Dinos. Në shtëpinë e Tij, në Prevezë organizohet një kuvend i madh ku merr pjesë e gjithë paria shqiptare e jugut dhe e veriut. Si gjithnjë Abdyl Frashëri mbetet në krye të Lidhjes Shqiptare. Në këtë mbledhje (janar 1879) deklarohet vendosmëria për mbrojtjen e Epirit dhe të Çamërisë. Mbi 20.000 luftëtarë shqiptarë qenë në gatishmëri të plotë ushtarake. Kështu, Perandoria Osmane detyrohet të mos i bëjë asnjë konçesion Greqisë.

Nënshkrimin përfundimtar mbi mosaneksimin e Çamërisë, Janinës, Meçovës etj. nga ana e shtetit shoven grek do ta vendosë sërish Abedin Dino në fund të korrikut të vitit 1880. Këtë herë me përgjegjësinë e ministrit të jashtëm të Perandorisë Osmane, në letrën përgjigje që u dërgon ambasadorëve të fuqive të mëdha lidhur me rishikimin e kufirit shqiptaro-grek, ndër të tjera, shkruan:

“...A do të ishte e mundur që Porta e Lartë t’u hiqte shqiptarëve zotërimet e disa vendeve të tjera që u përkasin racës (kombësisë) së tyre, veçanërisht atë të Çamërisë, krahinë kjo e banuar kryekëput me shqiptarë?!... Si mund të pranojë të lëshojë Janinën, po të merret parasysh që shqiptarët... e kanë quajtur gjithmonë atë si kryeqytetin e Shqipërisë së Poshtme dhe mbrojnë zotërimin e saj, siç dihet, me aq këmbëngulje?!...”¹⁰

Atëherë pse është denigruar vazhdimisht prej histografisë shqiptare figura e Abedin Dinos? Mos ndoshta ai, si dhe shumë personalitete të tjerë të shquar shqiptar u bë viktimë e egoizmit kultist Komunist? Apo mos ndoshta e pësoi thjesht për shkak të manizmit antiçam të diktatorit të Shqipërisë!

Përse atëherë edhe pas mbi dhjetë vjet të shembjes së Komunizmit, figura e Abedin Dinos çfaqet mes dritëhijesh? Për më tepër kur ende dëgjohen zëra se ai u përket atyre pronarëve të mëdhenj shqiptarë, të cilët përmbi Atdheun vinin interesat e çifliqeve të tyre? Ky lloj avazi i vjetër, përsëri bie erë marrëzi komuniste. Po a mund të duhet Atdheu pa dashur vetveten, familjen, pronën tënde?!

Sidoqoftë Abedin Dino (Çami) mbetet një ndër udhëheqësit kryesorë të Lidhjes Shqiptare për Jugun, i cili më 26 korrik 1880, me notën e Tij dërguar përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha, vuri veton ose e thënë shqip vulën në drejtim të mos aneksimit të Çamërisë, Janinës, etj. prej Greqisë.

¹⁰⁾ Ahmet Mehmeti: “Abedin Dino”, Onufri 1998.

PREVEZA SOT

Emocionet në Prevezë do të ishin të shumta. Çimi nuk kishte ndryshuar banesë. Rrinte ende me qera në lagjen e Kallamishtes, tek shtëpia e vjetër përdhese e Nikos, mësuesit pensionist grek, i cili në oborrin e tij kishte ndërtuar një shtëpi të re dykatëshe. Kujtoj se ai ishte një i moshuar i qetë, i kulturuar, dashamirës ndaj shqiptarëve qofshin këta të rinj emigrantë, aq më tepër me ata të hershmit, preveziotët vendas. Madje miku i tij më i mirë qe xha Jorgo, fqinj i tij, pensionist gjithashtu i cili vazhdimisht mes nesh, pranonte të qenurit çam me krenari. Dhe jo vetëm kaq. Xha Jorgo shpesh herë, kur qëllonim të tre tok, me duar të lidhura

në gjoks (zakon tipik i tij) e me vështrim nga deti shprehej mes një hamolloqeshje të dhimbshme.

“Eh more djelm, a e dini se ku po banoni ju sot? Në dheun shqiptar. Këtu njëherë e njëkohë, shumë vitera të shkuara ka qenë Shqipëri. Po ç'ish t'i bësh? Motet bën të tyren...”

Një e papritur e këndshme veçanërisht për Mirelën e Arbërin ishte se Çimi pati tërhequr në Prevezë edhe të shoqen Vajen, bashkë me dy fëmijët, Ralfin dhe Natalien. Tashmë ai është bërë një mjeshtër i vërtetë ndërtimi, i cili nuk e ka më problem gjetjen e punës. Përkundrazi, në lagjen e Kallamishtes dhe në mbarë Prevezën e kërkonin gjithnjë. Sigurisht fitonte mirë, përderisa prej thujtse 3 vitesh pat marrë edhe familjen.

Ne të dy patëm dalë në qytet vetëm. Mirela qëndroi në shtëpi me Vajen. Ndërsa Arbëri, tepër i kënaqur lozte në oborr me Ralfin, pak më i vogël se ai në moshë. Pasi u ecejakëm për mbi 1 orë gjatë bregut të detit, si për t'u çlodhur diçka u ulëm diku në bordurën e betonit që ndan detin me shëtitoren e qytetit. Fundjavë e ftohtë mes janari, e cila kushtëzonte edhe lëvizjen e paktë të njerëzve në këtë qytet. Deti ishte i qetë, i përvajshëm. Valëzat e tij të përhimta mezi arrinin të përplaseshin përgjatë bordurës së betonit.

Preveza është një qytet i këndshëm. Me një popullsi prej 15-20 mijë banorë. Natyrisht, gjatë stinës së verës, si edhe Parga, për shkak të vizitorëve të shumtë shtohet. Për nga madhësia është qyteti i tretë i gjithë Epirit të Jugut. Renditet menjëherë pas Janinës dhe Artës. Megjithëse është më e madhe se Gumenica,

nuk përngjan me të. Preveza si të gjithë qytetet e Çamërisë ka mbetur e pandryshuar. Me godina të ulta, kryesisht dy-tri katëshe. Të mirëmbajtura. Gjithashtu edhe rrugët apo rrugicëzat e saj shquhen për një rregullsi të veçantë. Duke qenë e shtrirë në një pllajë të butë, Preveza më shumë nga të gjithë qytetet shqiptare të sjell ndërmend Pogradecin, paçka se ky i fundit pjesërisht përfaqëson liqenin dhe jo detin. Por është diçka më e madhe.

Me sy të rënë mbi sipërfaqe të detit, më shumë mendoja se bisedoja me Çimin. Shkëmbenim shpesh cigare me njëri-tjetrin. Vura re se shoku im i ngushtë që zbardhur së tepërmi. Porse përherë simpatik, ndonëse i hequr në fytyrë. Shikimi sërish shkau mbi kurriz të detit. Nëse do të ishte verë me siguri do të kridheshave thellësive të tij. Por ishte e pamundur. Bënte ftohtë e si pa u ndjerë pati zënë të frynte një erë e mprehtë. Madje kishin nisur të krijoheshin edhe ca dallgë kreshpëbardha. I gjëri, fisniku, madhështori pat nisur të zhurmonte. Sikur donte të na thonte ca fjalë me atë çamërishten e tij të ëmbël. Diçka më vonë, kur zhurmimi u bë më i ndjeshëm mes nesh u arrit një kod mirëkuptimi. Më shumë se fjalë ato ishin rënkime të thella. Vinin që larg prej shekujve, prej mijëvjeçarëve. Po ndjeja të rrahurat e shpeshta të zemrës. Për një çast sipërfaqja e përhimtë u bë krejt e përgjakur...

-Ikim, - i thashë Çimit.

-Po, - tha ai, që pat kapur shqetësimin tim. - Fëmijët na presin. Vaja dhe Mirela duhet të kenë përgatitur drekën.

Të heshtur, të pafjalë ktheheshim. Ndërruam

përsëri cigare. Ndërkohë vetiu më erdhi ndër mend, një debat i para nëntë vjetësh në mes të xha Jorgos dhe Nikos, fqinjit dhe mikut të tij grek.

Ishte mbrëmje e vonë. Fund tetori i vitit 1991. Muaj ku nata i rrëmbente ndjeshëm minutat, orët ditës. Në shtëpinë e Çimit, si zakonisht kishin ardhur të shtynin kohën me muhabet e kafe xha Jorgo me xha Nikon. Në njërën prej këtyre vizitave rastisa edhe unë. Një javë më parë në Pire, më pat vizituar edhe Çimi. Qyteti i dytë i Greqisë, pas Athinës i pëlqeu. Tek rrufisnim kafetë shtruar e të kënaqur, mes dy fqinjëve miq lindi një debat. Shkak ishte bërë një emision televiziv që ato çaste i kushtohej Epirit. Ishin paraqitur të gjitha qytetet e tij bile edhe disa të Epirit të Veriut (Shqipërisë së Jugut). Natyrisht, synimi për ta paraqitur trevën e lashtë shqiptare si tokë helene, ndihej qartë. Madje u dhanë disa pamje të Prevezës së sotme. Në mbarim të emisionit, mësuesi i vjetër i gjuhës greke u shpreh:

-Megjithatë mua ende më mundon fakti që në qytetin tonë e fshatrat rreth tij edhe sot e kësaj dite jetojnë afro 50% shqiptarë, të cilët ruajnë jo vetëm gjuhën por edhe zakonet, traditat e tyre. Ndërkohë që sipas këtij emisioni interesant del qartë se ne grekët këtu jemi autoktonë.

-Po mirë ore Niko, - reagoi xha Jorgo. – Po ne ç'jemi? Po unë ç'jam? Nuk qenkam autokton?! Babai, gjyshi, atërgjyshi, katragjyshi im a nuk kanë lindur e banuar këtu? Ti Niko i di mirë këto gjëra, paçka se

emisioni që pamë nuk tha kurrgjë për ne shqiptarët.

-E çuditshme, e çuditshme, - bëri mësuesi grek.

-Edhe unë autokton jam në Epir, - vazhdoi Jorgo.

- Të parët tanë janë me shekuj, me mijëvjeçarë këtu.

Greku e vështronte pa shprehje në fytyrë mikun e tij të vjetër. Luhati lehtë kokën dhe u shpreh:

-Është punë e ngatërruar shumë kjo, more Jorgo.

Më mirë e lëmë këtë bisedë.

-E lëmë, e lëmë, - tha xha Jorgo...

Në shtëpi u kthyer ndërkohë që gratë po shtronin drekën. Vaja pati bërë përgatitje të veçanta. Veç unë nuk kisha aspak uri. Mëngjesin e pata ngrënë vonë. Shto që nuk ndihesha i qetë. Ndërsa Arbëri, Ralfi e Natalia karriget i zunë të parët. Ishin të lumturuar. Kur u ulëm për të ngrënë, Çimi më tha se pasdite do t'i bënim një vizitë edhe xha Enverit, për të cilin më pati folur shumë herë.

Takimi me Enver Hoxhën shënonte surprizën më të madhe jo vetëm gjatë vizitës në Prevezë, por në mbarë Çamërinë. Duke qenë se me Çimin ishte mik i vjetër pranoi me kënaqësi për të dalë me ne. Xha Enveri banon jashtë Prevezës. Por ky fakt nuk përbënte shqetësim, pasi Çimi me makinë e mori në shtëpi e po ashtu edhe do ta kthente. Sidoqoftë kur i folëm, ai këmbënguli që të ktheheshim atje qoftë edhe për një kafe. Shprehej i gëzuar që takohej me një mik tjetër nga Shqipëria. Madje, kur Çimi i tha me zë të ulët se isha çam prej tej kufirit, u mallëngjye. Natyrisht me xha Enverin ne bëmë edhe disa fotografi, të cilat unë i

ruaj me shumë përmallim. Ai duhej t'i kishte kaluar të shtatëdhjetat. Dukej i mbajtur. Me flokë të thinjur, e të prera shkurt. Në kokë mbante një kapele të zezë me pak strehë përpara. Kur u ulëm në një lokal buzë detit e me pak njerëz, xha Enveri më pyeti:

-Mirë, more bir që të kemi kah Çamëria e përtejme, po tamam-tamam nga cili vend je? Kah Konispoli, Mursia, Shalësi, Sopiku, Verva, Markati, Njanjari...

Jo vetëm që më befasoi por edhe po më pëlqente e folura e tij. E vështrova me plot adhurim e pastaj u përgjigja:

-Baban e kam kah Shalësi, kurse nanën e kam kah Markati.

-Janë vende të mira ato, - tha xha Enveri.

Ndërkohë pranë nesh pat ardhur kamarieri. Çimi e pyeti plakun se çfarë do të pinte. Birrë apo verë? Verë të kuqe qe përgjigja e tij.

-Po ti? – më pyeti mua.

-Po ashtu edhe unë, - i thashë.

-Atëherë na sill tri shishe verë të kuqe si dhe nga një pjatë me paidhaqe, - porositi Çimi.

Kamarieri u largua. Xha Enveri nxorri nga xhepi i xhakëtës së zezë kadife e me viza të trasha një kuti duhani në ngjyrë të floringjtë. E vendosi mbi tavolinë. E hapi dhe ngadalë-ngadalë zuri të dridhte tri syresh. Edhe unë e Çimi vendosëm paketat e çakmakët mbi mbulesë.

-U nukë i vë dot në golë ato. Janë toidhjo kashtë, - tha plaku.

Dy cigaret e para të bëra gati na i vuri përpara.

Të tretën e vuri në gojën e tij. Në shenjë respekti unë ja ndeza me çakmakun tim. Tymosi thellë e rëndë.

-O xha Enver, - foli Çimi. Dëftohi ca këtij miku taftonë (pasaportën), se i duket habi që zotrote ke emrin e Enver Hoxhës. Thotë se unë bëj gojallëk.

-Nuk thotë të rrema, - u shpreh plaku. – U vërtet e kam emrin Enver Hoxha. Po të duaç të dëftoj edhe taftonë (pasaportën). Po a din të lëçitësh shkronja greke?

Pasaportën e nxorri nga xhepi i brendshëm i xhakëtës. E shtyu prej meje. Unë e shfletoja kurioz. Kur në faqet e para të saj lexova: ENBEP HOXA.

- E çuditshme! – u shpreha dhe shtova. – Si është e mundur? Si të kanë vënë këtë emër?

- Nuk ka ndonjë habi të madhe këtu, - u shpreh qetë xha Enveri. – Mbiemri i fëmilës sonë kështu ka klënë kah moti. Nuk është se babai ka klënë komunist e ma ka vënë për të nderuar Enver Hoxhën. Kur leva u, ai nuk njihej fare. Kjo punë është një rastësi.

Dëgjoja buzagaz ndonëse ende paksa i habitur. Tashmë jo thjesht për këtë koinçidencë por edhe për diçka tjetër. Emri dhe mbiemri i lartpërmendur është krejtësisht mysliman. Për rrjedhojë familja e xha Enverit i përkiste këtij riti fetar. Atëherë si pat ndodhur që autoritetet greke të mos ushtronin presion mbi këtë familje për ndërrimin e këtij emri e mbiemri. Kur sot është i njohur botërisht fakti që shteti grek kryen një presion të jashtëzakonshëm mbi shqiptarët emigrantë myslimanë për tjetërsimin e emrave të tyre. Emrin fjala vjen Shaqir e bën Andon. Ilirin e bën Lefter, etj, etj. Sidoqoftë unë nuk ja shfaqta këto mendime xha Enverit.

Megjithatë e pyeta:

- Po nuk të kanë nxjerrë telashe për këtë emër e mbiemër o xhixho Enver?

- E ç' do më bëjnë mua këta more djalë i xhixhos. Gjithmonë kam punuar me djersën e ballit. Pastaj nuk është se jam ndonjë i njohur. U jam vetëm një fshatar plak. Si unë po ashtu edhe Çimi qeshëm lehtë. Ndërkohë erdhi kamarieri. Ai në fillim mbi tavolinë vendosi tre shishet e verës pastaj solli pjatat me mish. Me mirësjellje hapi edhe një tërë prej shisheve. Më parë mbushi gjysmë gotën e xha Enverit pastaj tonën.

- Gëzuar more djelm, - uroi plaku.

- Gëzuar, gëzuar, - thamë thuajse në një gojë si unë e po ashtu edhe Çimi.

Vera dhe mishi ishin vërtetë të shijshme. Të tre bisedonim edhe hanim këndshëm. Si dhe xha Jorgo, xha Enveri e pranonte pa problem të qenurit çam, shqiptar. Në një çast unë përmenda luftën, Napoleon Zervën. "Derr i egër, - u shpreh prerazi plaku i motshëm". Në muhabet e sipër tregoi se njërit prej djemve të tij ja kishte vënë emrin Gjergj ose Jorgo siç e thërrasin grekët. Pasi mbaruam e dolëm jashtë afshoi rëndë.

- Ah moj Çamëri... Moj e mjera Shqipëri...

Ishte një psherëtimë e thellë që u trazua natyrshëm me rënkimet e zhurmshme të detit.

NGA KOSKA NË QAFË BOTË

Në kthim, prej Prevezës në Filat (Koskë), Çamëria u përshkrua me ndjesinë e gërvishjes së cipëzës së hollë të zemrës nga poshtë lart. Pa dyshim një currilëz gjaku ka lënë gjurmë në të. Deri në Gumenicë, tok me Vajen dhe fëmijët na shoqëroi Çimi. Atje, si pak ditë më parë na priste sërish Agroni, bashkë me Anthullën dhe të bijën. Duke ditur se prej Koskës legjendare të Muharrem Rushitit mund të shihej edhe Verva, fshati i babait të Mirelës, ajo i kërkoi kushëritit që përpara se të na çonte në Qafë Botë, të na shpinte edhe atje. Udha nuk paraqiste vështirësi pasi pak kohë më parë qe asfaltuar. Ndonëse e ndaluar, në rrugë e

sipër qëndruam dhe bëmë fotografi. Ndër to më e bukura mbetet ajo ku Mirela ka pozuar duke treguar me dorë Vervën, e cila mbi Saraqin përngjante si një mjegull.

500 metra poshtë Vervës, Koska historike e tëra gjërmadhë. Këtu Kosova me qindra fshatra të djegur, të vjen menjëherë pranë. Historia e përgjakur e kombit tonë nis të belbëzojë. Nëse ka fshat në Çamërinë martire, që mbetet dëshmia më tipike, më e gjallë e genocidit të llahtarshëm zervist është Koska. Shtëpitë të gjitha të shkatërruara. Vende-vende gurët e mbetur humbin mes shkëmbinjve, ose shkëmbinjte e shumtë hera-herës përngajnë me shtëpi të gurta. Gjysmë gjërmadhë ka mbetur edhe xhamia e vjetër të cilës i shquhen vetëm harqet e dritareve si dhe minareja e këputur në mes. Të pashkatërruara janë vetëm disa shtëpira rrëzë malit, ku ende jetojnë vllahët të cilët kanë atje stanet e bagëtive. Qentë e tyre të egër u bënë shkak për të mos zbritur nga makina. Tre katër prej tyre na rrethuan duke lehur paprerë.

Megjithkëtë dua të them se me njërin prej vllahëve e pikërisht me atë më të moshuarin, familjen tonë të Kondajve e lidh një fill i vjetër njohjeje i cili mbahet gallë sot e kësaj dite. Kjo miqësi zë fill në të hyrë të viteve '50, kur njëri prej kushërirëve të parë të babait (Hamdi Kondi), bashkë me dy motrat e tij arratisen prej skëterrës komuniste për t'u hedhur në Perëndim. Ikja që bërë natën, nga Verva. Agimi i ri i pat gjetur në këto stane. Vllahu në fjalë jo vetëm i mirëpriti por edhe i ndihmoi. Në vitin 1991 me demokratizimin e Shqipërisë, Hamdiu i përmallshëm,

prej Australisë së largët rivjen në Atdhe. Rikthehet pas 40 vjetësh përsëri nga Koska e Qafë Bota. E për çudi atë e njeh vllahu, tashmë i moshuar. Bile e fton edhe në shtëpi. Kështu rindizen urat e miqësisë së hershme, të cilët i mbajnë ende të ndezura djemtë e të afërmit e tyre.

Siç thashë, për shkak të qenëve s'mundëm të zbrisnim në Koskë. Madje edhe fotografitë i bëmë nga brenda makinës. Pastaj u kthyem. Shpejt, në një qafë mali u shfaq Pleshavica, fshat çam i paprishur ku jetohet ende. Populli në vargjet e tij e portretizon kështu atë:

*“Pleshavicë moj Pleshavicë,
gjisma shqip, gjisma greqisht.
Ta prishën gluhën skolitë...”*

Komenti është i tepërt. Shto këtu edhe gjendjen e trishtë shpirtërore. Na pat përfshirë një si ankth. Pasi kishim lënë pas Qafën e Smartës, vumë re se nga prapa na vinte një xhip gri i policisë kufitare. Mirela qe shqetësuar së tepërmi. Po kështu edhe Anthulla, ndonëse mudohej ta ruante qetësinë. Nuk fliste askush. Kur Smartja e bukur, humbi mes ullish, deti shpalosi kaltërsinë e tij. Peisazh mahnitës si e gjithë Çamëria. Përgatita aparatën. E vura në sy dhe u bëra gati të fotografoja. Por nuk më la Mirela. Bllokoi objektivin me dorë dhe tërhoqi aparatën. E fshehu nën pallto.

- Edhe fotografitë na janë mangut tani, - u shpreh e shqetësuar.

- Edhe ti o ba, - foli Arbëri. – Tani e gjete për të bërë fotografi. Sikur nuk e shikon që na është vënë nga pas makina e policisë.

Nuk reagoja, sado që u nevríkosa. I hodha një vështrim Agronit. Profili i tij m'u duk i shqetësuar paçka se mundahej të përmbahej. Ktheva kokën pas. Xhipi i policisë po na afrohej. Në anë të kundërt me detin bëri shenjë një tjetër tabelë treguese. Mbi drejtkëndëshin e saj blu, një kryq i zi mbulonte një kamer filmimi si dhe një aparat fotografik. Për të qenë i sigurtë duhet të pranoj se shqetësimi pat kaluar edhe tek unë. Ishte fundi i udhëtimit tonë. Mos vërtetë po rrezikonim? Sërish hodha sytë tek pasqyra e vogël. Xhipi gri na qe afruar edhe më pranë. Mes kësaj gjendjeje hymë edhe në Sajadhë. Me shtëpi të reja në të dy krahët e udhës. Po i afrohem kufirit.

- E vogël, por e bukur Sajadha, - thashë unë për të thyer paksa edhe heshtjen.

Agroni pohoi me kokë. Rruga sa vinte e bëhej më malore. Këtë e tregonte edhe makina që zuri të sforcohej edhe më. Kthesat gjithashtu u bënë më të shpeshta.

- Makinën e policisë nuk e kemi më nga pas, - foli e lehtësuar Mirela.

- Shyqyr, - tha Arbëri.

- Nuk e kanë patur me ne, - foli Anthulla. – Do kenë qëlluar rastësisht.

- Unë u tremba, - tha Mirela. – Kisha frikë se mos na patën parë kur fotografuam Vervën, Pleshavicën.

- Apo nuk i kanë edhe tabelat që tregojnë se

filmimet dhe fotografimet janë të ndaluara, - tha Arbëri.
- Është zonë kufitare, - foli Agroni.

Një re pluhuri u ngrit në dy anët e makinës. Anthulla uli menjëherë xhamin në krah të saj. Agroni ngadalësoi shpejtësinë. Në këtë pikë asfalti i udhës mbaronte. Po arrinim në kufi. Pas një kthese u shfaq dogana greke. Në radhë njerëz të shumtë. Agroni frenoi. Zbritëm. Ora shënonte 11 e 30 minuta. Dinim se plot në orën 12, prej Qafës së Botës nisej urbani për në Sarandë. Na takonte të nxitonim, pasi duheshin kryer edhe formalitetet në pikën e doganës greke. Me Agronin, Anthullën dhe vajzën e tyre të bukur e të shkathët u ndamë me keqardhje. Me ta patëm kaluar shumë mirë. Natyrisht, ju thamë se në rastin më të parë që do të vinin në Tiranë, duhej patjetër të kalonin edhe nga ne. Patjetër thanë ata. Më së fundi u ndamë. Arbëri dhe e vogla u puthën. Agroni dhe Anthulla në mënyrë të veçantë përshëndetën nënën e Mirelës, si dhe Adin, kunatin. Ndërkohë që po ecnim drejt doganës u bëmë dëshmitarë të një skene të dhimbshme. Do na kujtohej ngjarja e rëndë e paradyjavshme në pikën doganore të Kakavijës, kur një oficer grek rrihte për vdekje një adoleshent shqiptar.

Këtë herë një fat të tillë e kishte një çift i ri. Njëri prej të dy policëve të pikës së vogël doganore, po tërhiqte zvarrë prej flokësh djalin. E fejuara e tij e llahtaritur kaloi me vrap përtej kufirit. Ndërkohë u afrua dhe polici tjetër. Ku nuk e goditnin të pambrojturin. Në çdo pjesë të trupit, pa pikën e mëshirës. Një rrëkezë gjaku i

shkiste prej buzës së poshtme. Megjithatë policët nuk ngopeshin. E godisnin e godisnin pa prerë. As edhe sklleverit e kohëve të vjetra nuk do ishin trajtuar kështu. Nga përtej kufirit e fejuara e viktimës gërthiste.

- Kriminelë të ndyrë. Lëreni se i morët shpirtin!

- Ç'të keqe ka bërë babi? – pyeti i trembur Arbëri.

- Me siguri ka qenë me dokumenta të parregullta,

- u shpreh Mirela dhe shtoi. – Kriminelë të vërtetë.

Unë heshtja. Po ç'mund të bëja! Heshtnin gjithashtu mbi pesëdhjetë shqiptarë të vënë në radhë para doganës greke. Të lidhur pas hallit të tyre, askush nuk pati kurajo të ndërhynte. Po të njëjtin qëndrim mbanin edhe dy-tre taksistë, që prisnin për pasagjerë. Më së fundi "spektakli" u mbyll. Siç dukej policët e shtetit fqinj u ngopën. Me idenë për ta bërë të njohur publikisht, atë skenë tragjike, mendova që ta shkrepja fshehtas aparatën. Madje, kërkova me sy një pikë të përshtatshme. Por qe e pamundur. Përreth as edhe një pemë e vetme. Pak metra më tej, përballë derës së doganës rrinin dy policët që patën lënë edhe punën. Me sa kuptohej, shplodheshin pas sforcimit të bërë. Ndërsa shqiptari i dërmuar mezi hidhte këmbët nëpër tokën e ndërmmjetme. Një dorë e mbante në mes e tjetrën në gojë. Gjaku i rridhte prej shamisë e gishtërinjve pikë-pikë. Brenda kufirit shqiptar, e fejuara e tij dridhej. Për një çast rrezikoi. Hyri në tokën e askujt. Arriti të fejuarin. Dorën e djathtë ja hodhi në mes, kurse krahun e tij të majtë ja vendosi mbi shpatullat e saj. Djaloshi rënkonte prej dhimbjeve të shumta. Disa sekonda më vonë, u gjendën brenda kufirit shtetëror shqiptar.

Vështrova orën. Dymbëdhjetë pa njëzetë minuta.

Urbani i linjës Qafë Botë-Sarandë nisej për njëzet minuta. Nuk kishim kohë të humbim. Vendosëm t'i afroshim doganës greke për të kryer formalitetet e duhura në pasaporta. Policët ende rrinin jashtë. Bisedonin dhe qeshnin me shoku-shokun. Më i shkuari në moshë dridhte gishtërinjve një zinxhir të hollë me ngjyrë të florinjte. Dhjetëra shqiptarë pa gojë e pa fjalë në radhë.

Me qëllim që të na krijohej mundësia për të mbaruar punë shpejt me dokumentet, mendova t'ju flisja grekërve në italisht. Efekti i gjuhës së huaj që i menjëhershëm. Ata u tjetërsuan. U bënë seriozë. E humbën qëndrimin prej kapadaish fodullë. Dhëmbët nuk i zbardhnin më. Më i moshuari e vuri në xhepin e xhaketës zinxhirin e hollë. U bënë më të devotshëm në detyrë. I pari, drejt doganës bëri i riu. Ai, me zë të ulët i tha kolegut të tij:

-Italikos, italikos!

Tjetri e ndoqi nxitimthi pas. Disa prej bashkatdhetarëve të mi, vetiu hapën udhë. I njetjetova në shqip. Më i riu nga doganierët grekë, me plot mirësjellje e xhentilesë më mori pasaportat. Por, pa kaluar as tri-katër sekonda ulëriu me të madhe.

-Alvanos, alvanos!

-Po, - thashë unë.

-Në radhë, në fund, - briti ai sërish.

Ambienti u tensionua përsëri. Policët grekë u kthyen në origjinë. Të egër... Paksa dhe për të qeshur. Si mund të ndryshojë burri në pak çaste?! Po ç'të thuash? Grekët përsëri rishfaqën pjesën më negative të karakterit tipik ballkanik. Pa dinjitet, servilë, e në të

njëjtën kohë arrogantë.

Më falni, - u mundova të sqaroja unë. – Fiks në orën dymbëdhjetë niset autobuzi i linjës Qafë Botë-Sarandë. Unë dhe familja ime, nuk do dëshironim ta humbisnim. Për këtë arsye menduam, që zotëria juaj të na ndihmonte në vulosjen e shpejtë të dokumentave.

-Në asnjë mënyrë, në asnjë mënyrë, ulëriti i riu dhe shtoi. – Jo urban, por edhe aeroplan të vijë këtu, ju do kryeni punë veçse në radhë.

Për shkak të nevrikosjes, më cikloi me ca pikëza pështyme në fytyrë. Plaçkat e barkut m'u ngritën përpjetë. Nxorra shaminë dhe e kalova në faqe me kujdes. Ai njeri ishte vërtetë i vështirë, i pështirë. I shëmtuar. I hollë e me një hundë të gjatë. Po ç'mund t'ju thoja? U tërhoqa prej sportelit, për t'ju lënë radhë të tjerëve. Sidoqoftë, ndërhyrja ime e pati një të mirë. Dashur pa dashur, doganierët grekë rifilluan punën. Më vonë mbaruam edhe ne. Gjashtë minuta patën shkuar prej mesdite. Po autobusi do që nisur vallë? Për të arritur në doganën shqiptare, na duhej të ecnim afër pesë minuta në këmbë. Më së fundi kufiri shqiptaro-shqiptar (çamo-çam) u kalua.

Përjetoja një dhimbje të dyfishtë. E para lidhej me keqtrajtimin që u bëhej shqiptarëve nga policia greke, e dyta kishte të bënte me Çamërinë. E coptuar, e prerë si me thikë. Andej kufirit, pjesa më e madhe, më e bukur e saj. Këtej, pjesa më e vogël, më malore. Megjithkëtë e dashur, e shtrenjtë. Në fillim është Konispoli. Pastaj Çifliku, Shkalla, Mursia, Xara, Gryka e Bogazit. Lumi Pavël shket në Grykë. Pastaj vjen Shalsi, Dishati, Verva, Markati, Ninati, Janjari. Tej

lumit Sospiku, Pandalejmoni, fshati më verior i Çamërisë. Kurse Preveza, qyteti më jugor kish mbetur mbi njëqind kilometra larg, mes resh e mjergullash të përhimta.

Tiranë 18.4.2001

Fund

PËRMBAJTJA

Pak fjalë	5
<i>Vitet '60</i>	7
<i>Porta e fatit apo e ferrit</i>	14
<i>Janina. Kryeqendra e Epirit</i>	23
<i>Arta. Skaji i Epirit</i>	34
<i>Nga Ambrakia në Patra</i>	43
<i>Athina. Pireu</i>	52
<i>Në Tripoli</i>	63
<i>Nata e Vitit të Ri</i>	71
<i>Sërish në Athinë</i>	80
<i>Rikthim në Çamëri</i>	86
<i>Në Gumenicë</i>	97
<i>Filati mes legjendës dhe historisë</i>	106
<i>Filati sot</i>	114
<i>Në Margëllëç</i>	124
<i>Paramithia</i>	136
<i>Në Pargë</i>	144
<i>Preveza në histori</i>	153
<i>Abedin Dino</i>	159
<i>Preveza sot</i>	164
<i>Nga Koska në Qafë Botë</i>	172

... Ndërkohë që Kosova përjeton lirinë, ndërkohë që shqiptarët e Maqedonisë dhanë sinjale të qarta për ardhmërinë e tyre, Çamëria mbetet ende plagë që rrjedh gjak prej trupit të kombit. Kjo jo thjesht për faktin e njohur tragjik të 200000 çamëve që jetojnë të përzënë me dhunë larg vatrës së tyre amtare, por edhe të mijëra e mijëra çamëve të krishterë, të cilët edhe sot e kësaj dite, prej Filatit e deri në Prevezë kanë frikë të shprehen hapur në gjuhën e mëmës, pasi grushti i egër i shtetit diktatorial nacionalist grek do të binte mbi ta pa mëshirë.